GAZETA SHQIPTARE

Kryeredaktor: Erl MURATI
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com

Viti XXIV - Nr. 7407 E premte 12 Janar 2018 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

Opinioni i Ditës

Nga ROVENA HOXHA

Barazia gjinore dhe "paketa sociale" në funksion të saj

Gjithandej flitet pa pushim për barazinë gjinore, fenomen që në botë ka disa dekada që ka evoluar më së miri. Gjithsesi elokuenca më e bujshme vjen nga vetë gjinia ... Vijon në faqen 20

Opinioni i Ditës

Nga VALBONA MEZINI

Tregu i kapitalit politik dhe bursa e tulipanëve holandezë

Dikur ekonomia e pas Luftës së Dytë Botërore njohu ritme të zhvillimit të vrullshëm industrial dhe një koncept rishtazi hyri në tregun ekonomik, që siç ... Vijon në faqen 21

Ministrja e Drejtësisë takon të dënuarit politik

Ish-të përndjekurit, Gjonaj: Rivlerësim për dëmshpërblimet e rishikim kërkesave

"Praktikë e re për shqyrtimin e dosjeve që janë në proces shqyrtimi"

Nga ORNELA MANJANI

Ministria e Drejtësisë do të rishikojë të gjitha kërkesat për dëmshpërblimin e ish të dëmuarve politik. Premtimi u bë dje nga Ministra e Drejtësisë Etilda Gjonaj gajtë një takimi për përfaqësues të ish-të përndjekurve poltik ... Në faqen 9

AGJENCIA E TRAJTIMIT TE PRONAVE: SI TE NJIHENI ME ECURINE E DOSJES

ISH-PRONARET, PROCEDURA E RE PER SHQYRTIMIN E KERKESAVE

ATP: Afati për verifikimin e dosjes është 30 ditë dhe pa asnjë kosto. Dokumentet që duhet të dorëzoni në Agjenci për të pasur akses në kontroll

(Në foto) Qytetarë në sportelet e ATP

Në faqen 8

VENDIMI I STRASBURGUT

I shembën hotelin, vjehrri i Bashës fiton betejën me qeverinë, merr 13 milionë euro

Në faqen 7

REAGIMET

Parlamenti maqedon: Shqipja gjuhë zyrtare. Rama dhe Meta: Arritje historike

Në faqen 17

PANIK NE SHQIPERI

Virus vdekjeprurës në paracetamol, Kontrolli i Barnave zbardh të vërtetën, flet mjekja

Në faqen 11

NGJARJA

Tentoi të vrasë një minorene se e refuzoi, i riu: E qëllova për inat të familjes

Në faqen 15

GABIMET NE FTESEN PER VITIN E SKENDERBEUT

Gjuhëtari kryqëzon Ramën: Vaj hallit kur kryeministri nuk ka korrektor

Në faqen 16

Flet 87-vjeçari/ Nga majat e Kinostudios në burgun e Spaçit, mendimi për Fatos Lubonjën

Dhimitër Lala: Porosia e Hrushovit për Enverin

Kineasti: Çu En Lai më befasoi, si iu përgjigj Mehmet Shehut

Nga REZARTA DELISULA

Jeta e tij i përngjan një mali që ka bazë, por dhe majë. Ai e arriti kulmin e tij, sepse Arkiva e Filmit të ish-Kinostudios mban qindra regjistrime të tij, dokumentarë e kino-zhurnale, ndeshje futbolli dhe

reportazhe jashtë shtetit, histori të bujshme në vitet '50-'70. Por preku dhe bazën, kur nga operatori i parë i udhëheqjes u dënua për agjitacion e propagandë e vuajti dënimin 6 muaj në Spaç. Ky është Dhimitër Lala, 87-vjeçari ... Në faqet 12-3

AKSIONI OPOZITAR
PROTESTA

Kreu i PD: Nuk ka Shqipëri në Europë, Edi Rama koka e kupolës mafioze

Basha: Më 27 janar duam në burg Tahirin, Dakon e Sejdinin

"Ministrat e korruptuar para drejtësisë"

Valentina Madani

Kreu i opozitës, Lulzim Basha para demokratëve të Kurbinit apeloi për ndëshkimin e pushtetarëve të korruptuar ndërsa ftoi shqiptarët që t'i bashkohen protestës së 27 janarit për t'i larguar nga qeverisja. Z.Basha akuzoi se pengesa e vetme e moshapjes së negociatave për në BE është krimi i veshur me pushtet. Ndaj Basha u bëri thirrje shqiptarëve të marrin pjesë në protestën e 27 janarit për të dhënë mesazhin se janë kundër kapjes politike të drejtësisë nga Edi Rama. Nga Kurbini ku vijoi turin e takimeve me strukturat drejtuese të PD-së z.Basha vuri në dukje se rruga nga unioni kalon përmes një drejtësie të pavarur që ndëshkon këdo duke nisur nga ajo që ai e cilëson kupolë mafioze. "Nuk ka Shqipëri në Europë dhe nuk mund të ketë një Shqipëri në Europë, pa një drejtësi që nuk i mbron, por i ndëshkon peshqit e mëdhenj të krimit dhe të korrupsionit, duke filluar me kokën e kupolës mafioze Edi Ramën dhe shpurën e tij të ministrave të korruptuar. Pa arrestimin e peshqve të mëdhenj të krimit dhe korrupsionit nuk ka Europë. Dhe se kjo parti ka lindur për ta bërë Shqipërinë si gjithë Europa",-theksoi kreu i PD-së. Emërimi sipas Bashës i një prokurori politik në kundërshtim me kushtetutën dhe pa veting është projekt i Edi Ramës për të mbrojtur ishministrin Tahiri, me të cilin ai thotë se bashkon pakti mafioz i heshtjes për ruajtjen e pushtetit. "I tmerruar nga drejtësia e pakapur politike, Edi Rama po bën gjithçka ta abortojë projektin e drejtësisë për shqiptarët. Kjo është një arsye kryesore dhe një nga arsyet më të mëdha përse do të mblidhemi më 27 janar në orën 12.00 të shtunën, për t'i thënë Edi Ramës, se Partia Demokratike, do drejtësi, se ne duam Sajmir Tahirin në burg, Vangjush Dakon në burg, Qazim Sejdinin në burg. Duam ministrat e tij të korruptuar përpara drejtësisë",-tha Basha. Ndaj dhe shqiptarët i fton që në 27 janar të protestojnë për një drejtësi të pakapur, duke e cilësuar një kusht të panegociueshëm largimin e kryeministrit Rama dhe krijimin e një qeverie antimafia. Kreu i opozitës u kërkoi demo-kratëve të sqarojnë derë më derë shqiptarët se për shkak të aleancës së Edi Ramës me krimin shqiptarët sot nuk zgjedhin dot një qeveri në shërbim të tyre, ata janë më të varfër, paguajnë më shumë taksa, po u përkeqësohet shërbimi shëndetësor dhe po bëhen eksperimente me arsimin e fëmijëve të tyre. "Ndaj objektivi politik i opozitës është i shprehur fare qartë. Largimi i Edi Ramës dhe i kësaj qeverie mafioze, është kusht i panegociueshëm i opozitës, objektiv kryesor i aksionit tonë opozitar, dhe i protestës së 27 janarit dhe i çdo aksioni tjetër qytetar që do të pasojë. Nuk ka qeveri të korruptuar në botë, në Europë dhe as në Shqipëri, t'irezistojë pjesëmarrjes masive qytetare", -tha Basha. Kreu i opozitës u shpreh se një qeveri antimafia do të garantojë zgjedhje legjitime, me parlament dhe qeveri legjitime, që nuk e blen pushtetin, por e përdor atë për zhvillimin e vendit dhe mirëqenien e shqiptarëve.

DREJTËSIA
"Partia Demokratike, do drejtësi, se ne duam Sajmir Tahirin në burg, Vangjush Dakon në burg, Qazim Sejdinin në burg. Duam ministrat e tij të korruptuar përpara drejtësisë", - theksoi z.Basha.

"100 ditët e rekordeve më të zeza"

Berisha: 100 thirrje për ta përmbysur Ramën sa më parë

Ish-Kryeministri Sali Berisha renditi dje "100 ditët e rekordeve më të zeza të Edi Ramës", të cilat i konsideron si "100 thirrje për çdo shqiptar, që të ngrihemi dhe të përmbysim sa më parë regjimin e narko-shtetit të Noriegës së Shqipërisë". "Noriega me narko-qeverinë e tij sapo kaloi 100 ditët e mandatit të tyre të grabitur! Këto 100 ditë ishin dhe ditët e rekordeve më të zeza, më dramatike në historinë e pluralizmit shqiptar. Ato do të mbeten të gdhendura me zift të zi në muret e kohës si ditët e: Aferës Tahiri-Habilaj, në të cilën Antimafia italiane faktoi me regjistrimet e saj se ministri i Brendshëm i narko-shtetit shqiptar, ishte anëtar kryesor i bandës famoze të trafikut të drogës Habilaj dhe se Edivini, pas kërcënimit publik të

Saimir Trafikut, bllokoi drejtësinë dhe nuk lejoi arrestimin e tij duke dëshmuar

ASTRIT PATOZI
Ish-nënkryetari i PD-së, Astrit Patozi shprehet skeptik nëse protesta e 27 janarit do të përmbushi misionin e saj. Sipas tij protesta reale janë ato që shpërthejnë nga revolta qytetare dhe jo ato që mbahen për shkak të partive.

se ishte skllav i dosjeve të veta si ajo e Xibrakës dhe faktoi se në Shqipëri ishte vendosur në mënyrë përfundimtare narko-shteti. Këto 100 dite neo-bllokmeni Edvin Kristaq Rama realizoi më së fundi ëndrrën e tij, që të bëhej në mënyrë antikushtetuese kryeprokuror i vendit dhe, me shpejtësi të rrufeshme nxori Orest Sotën nga burgu e i ktheu pasaportën Tahirit si di dhe mbylli me shpejtësi dosjen e vet dhe të vëlla Olsit, dosjen e Xibrakës pra, dosjen e Tahirit, Gjushit dhe të gjitha dosjet e ministrave të tij",-shprehet z.Berisha. Ai fton shqiptarët: "Këto 100 ditë janë 100 thirrje për çdo shqiptar që të ngrihemi dhe të përmbysim sa më parë regjimin e narkoshtetit të Noriegës së Shqipërisë!".

Policët në fushatë, LSI ridepoziton padinë ndaj Ramës

Vendimi, Vasili: Njësoj sikur të vrasësh dhe të thuash më fal

LSI ridepozitoi dje padinë ndaj kryeministrit Rama në Gjykatën e Lartë për thirrjet e tij gjatë fushatës elektorale, ku i kërkoi policisë të dilte në zgjedhje. Kreu i Grupit Parlamentar të LSI, Petrit Vasili Vasili tha se kërkesa është depozituar sërish, pasi prokuroria thotë se kryeministri është shfajësuar për këtë deklaratë me një falje në "Facebook". "Ne kemi bërë padi ndaj shtetasit Edi Rama ku ai i ka bërë thirrje policisë për të dalë në fushatë. Ne e kemi ridepozituar padinë në Gjykatën e Lartë. Pse e kemi ridepozituar në Gjykatën e Lartë? E kemi bërë, pasi prokuroria e shqyrtoi çështjen në më pak se 2 javë. Prokuroria thotë se lidhur me deklaratën e kryeministrit, ai shfajësohet me një status falje në Facebook. Kjo është njësoj sikur të vrasësh dhe të thuash më fal"- theksoi Vasili. Ndër të tjera, ai konfirmoi se LSI do marrë pjesë në sesionin parlamentar të Kuvendit që nis për këtë vit në 15 janar. Sipas tij LSI ka qenë promovuese e konsensusit për reformën në drejtësi. "Në lidhje me rinisjen e sesionit parlamentar të Kuvendit në datë 15 janar, LSI konfirmon pjesëmarrjen. Kemi dëgjuar një maskaradë të PS lidhur me dëshirën e tyre për reformën në drejtësi. Ju them se e vetmja forcë politike që nuk e do reformën në drejtësi është 'rilindja'. LSI ka qenë promovuese e konsensusit për reformën në drejtësi. Integrimin e pengon kapja e drejtësisë" - theksoi z.Vasili.

REDAKSIA: **Redaktor i Suplementeve dhe Sociales:** Rezarta Delisula, **Redaktor i Rretheve:** Trëndafile VISHA, **Redaktor i Kulturës:** Fatmira Nikolli, ***Art Designer:*** Nevila SAMARXHI,
ADMINISTRATA: **Përgjegjëse e Financës:** Alma Smokthina 0682074397, **Shpërndarja:** Elvis Llaka Cel 0682074416, ***Marketingu:*** Cel:0682074415-***email:marketing@gazetashqiptare.com***, **ADRESA**: Ish-Drejtoria e Uzinës së Autotraktorëve, Tiranë - Tel:(04) 2359-104 Tel&Fax:(04) 2359-116, ***Marketingu:*** Tel:(04) 2359-104/359-123. Tiranë, **Internet**: www.gsh.al, **Email**: gazetashqiptare@hotmail.com; redaksia@gazetashqiptare.com, **SHTYPUR në "Klasik"Shpk**

Debati në Konferencën e Kryetarëve, Paloka i afrohet Ballës, debaton me Ruçin

"Puçi kushtetues", PD kërkon dorëheqjen e kreut të Kuvendit

"Shkeli Kushtetutën me zgjedhjen e Markut"

Valentina Madani

Opozita në të parën mbledhje të Konferencës së Kryetarëve, pas seancës plenare ku u votua kryeprokuroja e përkohshme, kërkoi dje dorëheqjen e Gramoz Ruçit. Sipas demokratëve, në seancën e 18 dhjetorit u realizua "puç kushtetues" me zgjedhjen e kryeprokurores së përkohshme, Arta Marku. Por kërkesa e opozitës duket se nuk u mor parasysh nga mazhoranca. Demokratët e bojkotuan mbledhjen, ndërsa mazhoranca diskutoi kalendarin 3-javor të punimeve të Kuvendit, ku më e rëndësishme duket nisja e shqyrtimit të kandidaturave që zgjidhen nga parlamenti për Këshillin e Lartë Gjyqësor dhe Këshillin e Lartë të Prokurorisë. Kreu i deputetëve socialistë, Taulant Balla përmendi se këto janë pjesë e Reformës në Drejtësi dhe kushte për hapjen e negociatave. Ai përsëriti apelin e kryesocialistit, që të bëhen bashkë me opozitën për të ardhmen europiane të vendit. Nga ana e tij, kreu i grupit parlamentar të PD-së, Edmond Spaho bëri të qartë se opozita do të vijojë marrëdhënien e kushtëzuar me parlamentin, pasi mazhoranca vazhdon të shkelë ligjin dhe Kushtetutën e vendit.

INCIDENTI

Mbledhja e djeshme e Konferencës së Kryetareve u shoqërua me një incident në përfundim të saj. Gjithçka ndodhi kur demokratët po braktisnin sallën. Burime brenda mbledhjes bëjnë me dije se nënkryetari demokrat, Edi Paloka, u kërkoi kolegëve të largohen pasi po hasnin në refuzimin e socialistëve dhe të kryetarit të Kuvendit, i cili nuk dha një përgjigje për kërkesën e opozitës për dorëheqjen e tij. Kryetarit i Kuvendit mësohet t'i jetë drejtuar me fjalët: "Pse po ikni"?. "Ti nuk po reagon. Mos mendoni pse jemi këtu dhe gjithçka mund ta drejtoni si normalisht. Ne vërtet duam t'i kthejmë normalitetin dhe dinjitetin parlamentit. Ty t'u tha se ke shkelur Kushtetutën, që ke shkelur rregulloren dhe ti je përgjegjës direkt", - mësohet t'i ketë thënë Paloka, kryeparlamentarit Ruçi. Taulant Balla mësohet se nuk ka qëndruar indiferent ndaj akuzave të kundërshtarit politik. Fjalët e socialistit nuk janë dëgjuar mirë dhe Paloka ka kërkuar të dijë se çfarë tha. "Ta bësh me shkrim", mësohet t'i ketë thënë Balla, kolegut demokrat. Në këto momente mësohet e Paloka i është afruar kryetarit të grupit socialist dhe e ka sharë dhe më pas është larguar bashkë me kolegët demokratë nga salla. Nga a e tij Kuvendi njoftoi se kreu Gramoz Ruçi kërkoi që në programin e punimeve të Kuvendit të përfshihen me përparësi zbatimi i vendimeve të Gjykatës Kushtetuese, për efektet në legjislacion, duke u shprehur se: "Kemi detyrimin kushtetues që të bëjmë implementimin e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese dhe në momentin e parë që të jenë gati, t'i përfshijmë në kalendarin e punimeve". Z. Ruçi u ndal edhe tek çështja e KLGJ dhe KLP, duke përmendur se Kuvendi ka afate të përcaktuara në ligj dhe do të vijojë me zbatimin e tij për plotësimin e vendeve që përcaktohet nga Kuvendi i Shqipërisë. "Lidhur me KLGJ dhe KLP ka afate precize me ditë, me orë, se çfarë duhet të bëjë Kuvendi. Ne nuk kemi detyrime për ato që i takojnë gjykatës apo prokurorisë, por kemi detyrime për pesë kandidatët që vendos Kuvendi, qoftë për KLGJ, qoftë për KLP. Deri dje (pardje) ka qenë vakumi që Shoqëria Civile nuk kishte plotësuar detyrimin e saj kushtetues. Tashmë nuk ka asnjë pengesë. Ligji shprehet qartë se cilat janë detyrat e sekretarit të përgjithshëm të Kuvendit. Ai ka marrë porositë që të zbatojë në mënyrë rigoroze ligjin dhe brenda datës 15 janar 2018 do t'i paraqesë Komisionit të Ligjeve verdiktin e tij. Atëherë Komisioni i Ligjeve brenda tri ditëve duhet të miratojë rregulloren dhe duhet të përcaktojë komisionin përkatës për KLGJ dhe KLP", - u shpreh z.Ruçi.

Mbledhja e djeshme e Konferencës së Kryetarëve

DEBATI, INCIDENT GJATË MBLEDHJES SË KONFERENCËS SË KRYETARËVE

Gramoz Ruçi: Kemi detyrimin kushtetues që të bëjmë implementimin e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese dhe në momentin e parë që të jenë gati, t'i përfshijmë në kalendarin e punimeve. Lidhur me KLGJ dhe KLP ka afate precize me ditë, me orë, se çfarë duhet të bëjë Kuvendi. Ne nuk kemi detyrime për ato që i takojnë gjykatës apo prokurorisë, por kemi detyrime për pesë kandidatët që vendos Kuvendi, qoftë për KLGJ, qoftë për KLP. Deri dje (pardje) ka qenë vakumi që shoqëria civile nuk kishte plotësuar detyrimin e saj kushtetues. Tashmë nuk ka asnjë pengesë.

Edmond Spaho: Më 18 dhjetor u krye puç kushtetues, i urdhëruar nga Edi Rama, por i zbatuar nga Ruçi. Kryeprokurori duhej të zgjidhej me 3/5, i propozuar nga KLP dhe me veting. U emërua me 69 vota, nga PS dhe pa veting. Qëllimi i emërimit antikushtetues i kryeprokurorit është t'i japë mbrojtje ligjore pushtetit të inkriminuar dhe të korruptuar të Edi Ramës. Opozita nuk mund të lejojë shkeljen e vazhdueshme të Kushtetutës dhe delegjitimimin e institucioneve. Opozita do të qëndrojë fort në mbrojtje të Kushtetutës dhe institucioneve demokratike. Dorëheqja e Ruçit është hapi i parë i kthimit të normalitetit në parlament.

Gramoz Ruçi: Një kërkesë e tillë nuk mund të merret parasysh.

Paloka, deputetëve të PD-së: Ngrihuni të ikim!

Gramoz Ruçi: Pse po ikni?

Edi Paloka: Ti nuk po reagon. Mos mendoni pse jemi këtu dhe gjithçka mund ta drejtoni si normalisht. Ne vërtet duam t'i kthejmë normalitetin dhe dinjitetin parlamentit. Ty t'u tha se ke shkelur Kushtetutën, që ke shkelur rregulloren dhe ti je përgjegjës direkt. Të thashë ti je i përdorur nga Edi Rama dhe nuk po reagon.

Gramoz Ruçi: Ja pra ju nuk po më lini të reagoj.

Edi Paloka: Të kishe reaguar. Të është kapur kryetari i grupit duke vjedhur votat e opozitës dhe t'i hesht…

Ndërhyn Taulant Balla

Edi Paloka: Çfarë the?

Taulant Balla: Ta bësh me shkrim…

Edi Paloka i afrohet Ballës duke e sharë dhe më pas ai dhe deputetët e tjerë të opozitës u larguan nga salla e Konferencës së Kryetarëve.

REAGIMI

Pasi Balla postoi në "Instagram" një foto të karrigeve bosh të demokratëve shoqëruar më mbishkrimin, "Fati i keq për Shqipërinë për këtë opozitë që ka frikë nga drejtësia", Paloka reagoi në 'FB': "T'i bësh replikë Ballës është si të shkelësh me dëshirë mbi bajgë…".

PD, Spaho: Mazhoranca kokëfortë, po mbron krimin

Kryetari i grupit parlamentar të PD-së, Edmond Spaho, deklaroi dje se pozita ka shkelur Kushtetutën për të mbrojtur ish-ministrin e Brendshëm, Tahiri, të akuzuar si pjesë e një grupi për trafik ndërkombëtar droge. "Në këto kushte kur është shkelur Kushtetua, kur institucionet janë deligjitimuar, si hap i parë për të rikthyer Kuvendin në normalitet, duke pasur parasysh edhe rolin e tij në seancën e 18 dhjetorit, ne kërkuam dorëheqjen e kryetarit Ruçi, pasi mënyra se si ka vepruar në raport me detyrat që ka kryetari i Kuvendit janë diametralisht të kundërta", tha z.Spaho. Por, ai përmendi se ata u ndeshën me "një qëndrim kokëfortë, indiferent të mazhorancës". Pas daljes nga Konferenca e Kryetarëve, Spaho sqaroi pse opozita nuk e ankimon në Kushtetuese zgjedhjen e kryeprokurores Arta Marku. "Në ato raste kur i jemi drejtuar Kushtetueses, Kuvendi nuk i ka zbatuar këto vendime. Marrëdhëniet tona me Kuvendin do jenë të kushtëzuara", tha Spaho.

Balla: PD, përpjekje për t'i bërë gropën Shqipërisë

Kreu i grupit parlamentar të PS, Taulant Balla kritikoi largimin e demokratëve nga mbledhja e Konferencës së Kryetarëve, duke thënë se çdo përpjekje për t'i bërë gropën Shqipërisë është për të ardhur keq. "Së pari, me përgatitjen e legjislaturës për implementimin e reformës në drejtësi. Kryetari i Kuvendit kërkoi që menjëherë ditën e hënë të fillojë puna për ngritjen e KLGJ dhe KLP. Në mënyrë të çuditshme ata që thoshin pse po vonohet KLGJ e KLP nuk morën pjesë fare në mbledhje. I përsëris thirrjen Lulzim Bashës dhe opozitës që Shqipëria nis me sesionin parlamentar të datës 15 një axhendë të rëndësishme, që ka të bëjë me një vendimmarrje pozitive për hapjen e negociatave. Në këtë proces jemi të gjithë të domosdoshëm për të mos i prishur punë. Kemi fillu-ar punën për vendimin e Gjykatës Kushtetuese për nenet ku ka rekomanduar ndryshime. Detyra kushtetuese e opozitës të jetë në Kuvend", deklaroi z.Balla.

QEVERIA
MBLEDHJA

Deputetja e PS-së: Javën e ardhshme, rezultatet e para për KLP

Vasilika Hysi: Prokurorët preken nga vetingu, jo nga Arta Marku

Deputetja e Partisë Socialiste, Vasilika Hysi komentoi dje, situatën e krijuar në vend pas lëvizjeve të fundit në radhët e prokurorisë. Pas vendimeve të kryeprokurores së përkohshme, Arta Marku, disa prej tyre kanë reaguar, duke depozituar edhe kallëzime ndaj saj për largim të paligjshëm nga detyra, sipas tyre. Në rubrikën "Opinion" në "News24", deputetja socialiste tha se edhe në rastet kur prokurorët do të preken nga ligji, nuk është për shkak të kryeprokurores, por për shkak të zbatimit të vetingut. "Prokurorët preken nga ligji dhe jo nga kryeprokurorja. Nëse ka prokurorë që do preken atëherë kjo do të ndodhë në kuadër të vetingut. Zbatimi i reformës në drejtësi

Deputetja e Partisë Socialiste, Vasilika Hysi

është i rëndësishëm. Tani prokuroria është e centralizuar. Do të jetë pikërisht profesionalizmi i prokurorëve që do të ndikojë në vlerësimin e tyre. Tani është koha që çdo prokuror duhet ta zbatojë edhe më mirë ligjin, sidomos me hyrjen në fuqi të ligjit të ri të funksionimit të prokurorisë",-u shpreh deputetja Vasilika Hysi. Hysi tha se procesi i krijimit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë ka filluar që në janar të vitit 2017. "Shkak për moskrijimin e KLP është shoqëria civile. Ende nuk ka një kandidat konkret nga shoqëria civile, pasi duhet të theksoj se kriteret janë të forta. Javën e ardhshme priten edhe rezultatet e para për Këshillin e Lartë të Prokurorisë. ONM në bashkëpunim me Sekretarin e Përgjithshëm po bëjnë vlerësimin e kandidaturave të shoqërisë civile. Tashmë është përgatitur programi trejavor i punimeve të Kuvendit, dhe është futur edhe shqyrtimi i kandidaturave për KLP",-tha deputetja Vasilika Hysi.

Mbledhja e qeverisë në Lezhë, diskutohet reforma e ujit e Viti i Skënderbeut

PS riorganizim bazës, Rama delegon Beqajn në Kukës, e zëvendëson me Xhaçkën

Kreu i PS-së mbledh sot deputetët e Korçës e Elbasanit

Kryeministri Edi Rama mbledh sot, në Lezhë qeverinë. Ndërsa të shtunën aktiviteti i kreut të qeverisë dhe ministrave vijon me takime në zona të ndryshme të qarkut. Ashtu siç është bërë zakon, pas Dibrës, mbledhja e kabinetit qeveritar këtë herë bëhet në Lezhë, ku do të merren vendime që i përkasin zonës. Rreth orës 16:30 kryeministri do të prezantojë në një konferencë për shtyp vendimet e marra. Ndërsa më pas do të organizohet një event kushtuar Vitit të Skënderbeut. Në axhendë do të ketë edhe një takim të kryeministrit dhe ministrave me drejtuesit qendrorë e vendorë të qarkut Lezhë. Agjenda e ditës së shtunës vijon me një mëngjes pune i ministrave me drejtues të institucioneve të varësisë. Në orën 09:30 të së shtunës kreu i qeverisë do të takojë drejtues të institucioneve qendrore, kryetarët e bashkive, kryetarët e grupeve të këshillave bashkiakë, kryetarë këshillash bashkiakë, prefekti, kryetar qarku, etj,

Kryeministri Edi Rama

Kokëdhima: Plehrat e Europës po nisen drejt Shqipërisë, të përgatitemi për luftë!

Kreu i partisë "Zgjidhja", njëherësh ish-deputeti i PS-së ka bërë dje, thirrje për luftë, pasi plehrat e Evropës po nisen drejt Shqipërisë. Sipas tij, "Shqipëria e Edi Ramës është piketuar përfundimisht, si një zgjidhje e pjesshme për hallin e madh, që i ka zënë derën vendeve të Europës". Kokëdhima i bën thirrje kryeministrit Rama që të mos tentojë të fusë në programin e Kuvendit, shqyrtimin e dekretit të Presidentit që refuzon dekretimin e amendamenteve që qeveria e tij i bëri ligjit të mbetjeve. "ZGJIDHJA e paralajmëron këtë kryeministër tradhtar, se do jetë në krye të rezistencës së popullit tonë, kundër planit të tij për ta kthyer Shqipërinë në kazanin kanceroz ku shkarkohen plehrat e gjithë Europës. Duhet të bëhemi gati për luftë!", u shpreh Kokëdhima.

për të diskutuar për reformën e ujit, turizmin dhe zhvillimin e agroturizmit, shërbimet si dhe Vitin e Skënderbeut. Të shtunën paradite do të nisin edhe vizitat e ministrave në terren. Kryeministri së bashku me deputetët e zonës, ministren Lindita Nikolla dhe deputetin Pjerin Ndreu do të jenë në një inspektim në Portin e Shëngjinit, për t'u njohur me projektet për zhvillimin e tij. Fundjavën e ministrave do ta mbyllë një event publik për bashkëqeverisjen në Pallatin e Kulturës në Rrëshen.

NDRYSHIMET NË PS

Ndërkohë dje, paradite, kryeministri, në cilësinë e kryetarit të PS-së takoi deputetët e qarqeve Dibër e Kukës. Ai ka bërë edhe lëvizjet e radhës në delegimet e deputetëve. Kështu Mimi Kodheli dhe Ilir Beqaj do të jenë të deleguar në Kukës, ku është kërkuar që të ketë një riorganizim më të mirë në këtë vit, para zgjedhjeve lokale. Ndërsa ministrja e Mbrojt-jes, Olta Xhaçka është deleguar në qarkun e Dibrës, ku zëvendëson Ilir Beqjen. Sot pritet që kryeministri Rama të presë në Kryeministri, para se sa të niset për në Lezhë një takim me deputetët e qarkut të Korçës dhe Elbasanit. Në këtë fillim viti, PS po merret seriozisht me organizimin e degëve të saj, në të gjithë vendin, të cilat, që pas zgjedhjeve të përgjithshme nuk kanë qenë me kapacitet të plotë. Në disa prej degëve ende nuk ka kryetarë, ndaj edhe Rama ka lënë porosi që ata të zgjidhen deri në shkurt.

Xhafaj e Gjonaj presin kreun e Autoritetit Antikorrupsion

Italia, ndihmë Shqipërisë në luftën kundër korrupsionit

Kreu i Autoritetit Antikorrupsion në Itali, Raffaele Cantone vlerësoi dje, legjislacionin që po kërkohet të zbatohet në Shqipëri. Ai u prit dje, nga ministri i Brendshëm Fatmir Xhafaj dhe nga ministrja e Drejtësisë, Etilda Gjonaj. Zoti Xhafaj e njohu bashkëbiseduesin me dokumentin politik të Ministrisë së Brendshme, reformat e fundit që po ndërmerren në Policinë e Shtetit në kuadër të vetingut në polici dhe Policimit në Komunitet, ku veçoi asistencën e misionit evropian PAMECA. Ai e njohu me ecurinë dhe rezultatet e operacionit "Forca e ligjit". Ministri i Brendshëm u ndal, gjithashtu, tek prezantimi i nismës për vetingun në polici, përmes së cilës synohet të shëndoshet organizata dhe promovohen punonjësit me integritet. Kreu i Autoritetit Antikorrupsion në Itali theksoi rëndësinë e bashkërendimit të reformës në gjyqësor dhe reformimit të Policisë së Shtetit. Ai u shpreh i gatshëm për të rritur nivelin e bashkëpunimit me Ministrinë e Brendshme, sidomos për masat pas vënies në zbatim të procesit të vetingut, për sigurimin e mekanizmave parandalues dhe garantimit të integritetit në të ardhmen të punonjësve të policisë. Agjencia italiane e Antikorrupsionit do asistojë qeverinë shqiptare në luftën kundër korrupsionit. Këtë garanci i tha Raffaele Cantone ministres së Drejtësisë Etilda Gjonaj, me të cilën diskutuan mbi përmbajtjen e ndihmës italiane në betejën kundër korrupsionit.

EDI RAMA
Kryeministri Edi Rama e cilësoi miratimin nga parlamenti maqedonas të ligjit të gjuhës shqipe, një arritje historike për shqiptarët, por që demokratizon e forcon edhe vetë Maqedoninë. "Miratimi nga parlamenti në Shkup i ligjit të gjuhës shqipe, një arritje historike për shqiptarët që demokratizon e forcon vetë Maqedoninë", tha ai.

ILIR META
Presidenti i Shqipërisë, Ilir Meta, e vlerësoi ligjin për lejimin e gjuhës shqipe në Maqedoni. "Një akt i rëndësishëm jo vetëm për shqiptarët, por edhe për të ardhmen evropiane të Maqedonisë", u shpreh dje Presidenti Ilir Meta, i cili tha se këtë lajm të mirë e mori sapo zbriti në aeroportin e Lubjanës në Sllloveni.

Ligji u votua nga 69 deputetë, bojkotoi VMRO-DPMNE. Kreu i BDI: Pritet Ivanov

Parlamenti maqedon: Shqipja, gjuhë zyrtare. Rama-Meta: Arritje historike

Gjuha shqipe, për herë të parë do të përdoret edhe në qeveri

Parlamenti i Maqedonisë votoi dje ligjin për përdorimin e gjuhëve të bashkësive etnike, me të cilin avancohet përdorimi zyrtar i gjuhës shqipe në të gjitha organet e pushtetit qendror. Të 69 deputetët e pranishëm në sallën plenare votuan pro ligjit dhe nuk pati asnjë votë kundër dhe asnjë abstenim. Ndërkohë që partia opozitare VMRO-DPMNE, duke e cilësuar ligjin si antikushtetues e bojkotoi votimin, të gjithë deputetët e saj dolën nga salla plenare në kohën e votimit.

Sipas ligjit të miratuar, gjuha shqipe do të përdoret në të gjitha mbishkrimet e institucioneve të nivelit qendror, krahas atyre në pushtetin lokal, ku gjithashtu gjuha shqipe është zyrtare në komunat ku shqiptarët përbëjnë mbi 20 për qind të numrit të përgjithshëm të popullatës. Gjuha shqipe do të përdoret për herë të parë edhe në qeveri, si në të folur edhe në të shkruar. Përdorim të njëjtë të gjuhës shqipe do të ketë edhe në parlament, përfshirë edhe kryesuesin e seancave nëse është shqiptar, por edhe në të gjitha organet e tjera të pushtetit qendror, ndërmarrjet publike, agjencitë dhe drejtoritë. Përdorimi zyrtar i gjuhës shqipe do të zbatohet edhe në të gjitha tabelat udhëzuese të institucioneve shtetërore. Gjuha shqipe nuk do të përdoret në banknota dhe në uniformat e armatës, por partnerët e koalicionit qeverisës kanë arritur marrëveshje që në banknota të përdoren simbole kulti, që do të reflektojnë edhe ato shqiptare. Institucionet detyrohen që në afat prej gjashtë muajsh fillimisht t'i ndryshojnë emrat ose mbishkrimet në hyrje të institucionit dhe t'i shkruajnë ato njëlloj në shqip dhe maqedonisht, me madhësinë e njëjtë dhe pamjen e njëjtë. Përveç kësaj, institucionet dhe njësitet rajonale obligohen t'i bëjnë në dy gjuhë edhe vulat e tyre. Një vit nga hyrja në fuqi e ligjit, institucionet duhet t'i zbatojnë ndryshimet tërësisht dhe për ato institucione që nuk do të zbatojnë këto ndryshime ligjore, do të aplikohen gjoba prej 4 deri në 5 mijë euro. Ndërsa, ndaj zyrtarëve ose administratorëve që nuk e respektojnë këtë parim do t'u zbritet 30 për qind nga rroga.

REAGIMET

Miratimi i ligjit solli reagime të shumta në Maqedoni, Kosovë e Shqipëri. Presidenti i Shqipërisë, Ilir Meta e cilësoi "një akt të rëndësishëm jo vetëm për shqiptarët, por edhe për të ardhmen evropiane të Maqedonisë". Kryeministri Edi Rama u shpreh se kjo është "një arritje historike për shqiptarët, por që demokratizon e forcon edhe vetë Maqedoninë". Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi nga ana e tij tha se "miratimi i këtij ligji është një hap i rëndësishëm i zbatimit të Marrëveshjes së Ohrit". Kreu i opozitës në Shqipëri, Lulzim Basha përshëndeti këtë moment, duke thënë: "Është një hap i rëndësishëm përpara në realizimin e statusit të gjuhës shqipe në Republikën e Maqedonisë". Zëvendëskryeministri maqedonas, Hazbi Lika në emër të ekzekutivit përgëzoi miratimin e Ligjit për Përdorimin e Gjuhëve, i cili u miratua sot në Parlamentin e Republikës së Maqedonisë edhe me shumicë të dyfishtë, me 69 vota pro. Kryetari i Bashkimit Demokratik për Integrim në Maqedoni, Ali Ahmeti, e cilësoi miratimin e ligjit për përdorimin e gjuhëve, një festë të madhe për të gjithë shqiptarët. Kryetari i grupit parlamentar të BDI-së sqaroi se, "nëse Ivanov mban fjalën e thënë në dhjetor të vitit të kaluar, që do të kundërshtojë ligjin për gjuhët, atëherë ky ligj brenda 30 ditëve do të rikthehet në Kuvend në seancë plenare, ku do të rivotohet edhe njëherë me 61 vota pro".

LULZIM BASHA
"Vlerësoj qëndrimin e forcave politike maqedonase, që mbështetën me votën e tyre këtë ligj, i bindur se kjo votë është një kontribut i rëndësishëm për bashkëjetesën etnike dhe konsolidimin e një shoqërie demokratike në Maqedoni", u shpreh Basha.

DITMIR BUSHATI
"Miratimi i ligjit është një investim me rëndësi të veçantë për forcimin e demokracisë, respektit dhe mirëkuptimit ndëretnik. Në të njëjtën kohë, ky akt është një gur themeli për një të ardhme më të mirë e më të sigurt euroatlantike të fqinjit tonë".

KRYEMADHI
"Pas vendimit për shpalljen festë zyrtare të ditës së alfabetit, ditës së Kongresit të Manastirit, miratimi i ligjit të dygjuhësisë në Maqedoni është një hap tjetër emancipues shtetëror. Heqja dorë nga tabutë, duke përfshirë heqjen dorë nga emri historik, siç deklarohet dhe çlirimi nga frika prej gjuhës së tjetrit përbëjnë dukuri evropianizuese të Maqedonisë fqinje, të cilën Shqipëria e njohu e para si shtet të pavarur", tha kryetarja e LSI-së.

Emri i Maqedonisë, takim "sekret" mes ministrave të Jashtëm

Kotzias-Dimitrov: Rol më energjik në negociata, të kapërcejmë mosmarrëveshjet

Ministrat e Jashtëm të Greqisë dhe Maqedonisë, Nikos Kotzias dhe Nikola Dimitrov janë angazhuar që të kenë një rol më energjik të negociatat për zgjidhjen e çështjes së emrit, me qëllim që të kapërcejnë mosmarrëveshjet. Kështu vihet në dukje në një njoftim të Ministrisë së Jashtme greke, menjëherë pas përfundimit të takimit që shefat e diplomacive të Athinës e Shkupit zhvilluan të enjten pasdite, në rrethana tepër konspirative, raporton Robert Goro për "Ora News" nga Greqia. Askush në Greqi nuk e dinte më herët se ku do të mbahej takimi, që përfundimisht, sipas njoftimit, u zhvillua në Selanik. Përpjekjet për zgjidhjen e mosmarrëveshjes mbi çështjen e emrit duket se kanë dominuar bisedën e dy ministrave. Por njoftimi i Ministrisë së Jashtme greke është ndalur vetëm tek pritshmëria e përbashkët e tyre nga rifillimi i bisedimeve dypalëshe, më 17 janar në selinë e OKB-së në Nju Jork. Kotzias e Dimitrov presin nga negociatori Matthew Nimetz, që të "prezantojë një kornizë fillestare brenda së cilës do të avancojë procesi i negociatave". Më tej, njoftimi thotë se dy ministrat diskutuan mbi metodën që do të ndiqet, përafrimit të të dyja palëve dhe kuadër të çështjes së emrit. Pa dhënë detaje të tjera, njoftimi nënvizon se Kotzias e Dimitrov kanë rënë dakord që të ndërmarrin një rol më energjik në negociatat, me qëllim që të kapërcejnë mosmarrëveshjet në çështjen e emrit. Kotzias e takoi Dimitrovin vetëm 72 orë, pasi kishte pritur në Athinë zëvendëskryeministrin e Maqedonisë, Bujar Osmani, që përfaqëson partinë shqiptare Bashkimi Demokratik për Integrim.

INTEGRIMI
INTERVISTA

Presidenti i KE-së: Bullgaria ka bërë mirë kur e ka vënë Ballkanin si prioritet

Juncker: Vendet e rajonit të bëjnë reformat e duhura dhe sa më parë

"Nuk ndodh gjë sa jam unë president, por duhen vënë piketat"

Presidenti i Komisionit Evropian, Jean-Claude Juncker

BULLGARIA
"Qeveria bullgare ka bërë disa hapa të rëndësishëm në këtë drejtim, sepse samiti i vendeve të Ballkanit Perëndimor në Sofje më 17 maj do të jetë një prej zhvillimeve më të rëndësishme. Bullgaria është shumë e përshtatshme për të ndërtuar ura drejt Ballkanit Perëndimor, sepse e njeh këtë rajon, e njeh kulturën, gjuhët dhe ka pasur edhe vetë një proces të suksesshëm të anëtarësimit në BE", - tha Juncker.

Presidenti i Komisionit Evropian, Jean-Claude Juncker, deklaroi dje se Bullgaria, e cila do të jetë kryesuesja e radhës ka bërë mirë që e ka vënë si prioritet perspektivën e Ballkanit Perëndimor. Ai bëri të qartë se vendet e Ballkanit Perëndimor, ku natyrisht bën pjesë edhe Shqipëria nuk do të kenë ndonjë hap përpara drejt anëtarësimit në BE deri në kohën që ai është president, por tashmë duhen vënë piketat. Ndërsa për këto vende, Juncker në një intervistë për "Deutsche Welle", këshilloi që të vijojnë reformat.

Zoti Juncker, a jeni të bindur se Bullgaria do ta kryejë si duhet detyrën e kryesueses së radhës së BE për gjashtë muajt e ardhshëm?

Bullgaria është e përgatitur jashtëzakonisht mirë, sepse ka krijuar madje edhe një ministri të posaçme për presidencën e radhës së BE. Ministrja Lilyana Pavlova është sikur edhe kryeministri Boiko Borissov jashtëzakonisht mirë e përgatitur. Së bashku me Mariya Gabriel, e cila në komisionin tim është duke bërë një punë jashtëzakonisht të mirë, Bullgaria do të shënojë përparime të mëdha për Evropën, jam i bindur për këtë. Bullgaria është përcaktuar në tërësi për agjendën evropiane dhe ka vënë në qendër temat që janë të rëndësishme për evropianët: migracionin, digjitalizimin, një lloj unioni për mbrojtje dhe perspektivë evropiane të vendeve të Ballkanit Perëndimor. Përveç kësaj, me shkronjën "B" fillon jo vetëm emri i Bullgarisë, por edhe fjala bullgare "budeshte", që do të thotë "ardhmëria". Presidenca bullgare do të drejtojë debatin e rëndësishëm për të ardhmen e Evropës dhe viti 2018 do të jetë vendimtar për shumë çështje të Bashkimit Evropian, prej forcimit të ekonomisë dhe politikës monetare të BE, sistemit të ardhshëm të migrimit e deri tek buxheti i BE. Bullgaria do të luajë në këtë drejtim një rol të rëndësishëm ndërmjetësimi për të gjetur konsensusin e të gjitha vendeve anëtare.

Mediat evropiane kanë kritikuar pjesërisht shumë ashpër Bullgarinë. Por më së shumti flitet për vendin më të varfër dhe më të korruptuar në BE. A i meriton Bullgaria këto kritika?

Kur dëgjoj për klishe të këtilla, atëherë do të doja që së pari të shikojmë faktet. E ato duken më ndryshe, jo vetëm nga koha e marrjes së presidencës bullgare. Unë e njoh Bullgarinë shumë mirë, sepse kam qenë Kryeministër i Luksemburgut në kohën kur Bullgaria është anëtarësuar në BE. Asokohe Luksemburgu ka qenë kryesues i radhës i BE. Prej atëherë, Bullgaria ka bërë shumë, ndër tjera edhe në ekonomi. Ekonomia e këtij vendi vitin e kaluar është rritur për 3,9%. Punësimi po zhvillohet pozitivisht, ndërsa buxheti është nën kontroll shumë të mirë. Borxhet e shtetit janë nën 30% të prodhimit bruto, që në krahasim me vendet e tjera anëtare të BE, është shumë pak. Bullgaria është po ashtu një ndër vendet më pro-evropaine. Ndaj pritjet janë shumë pozitive, jo vetëm për kohën e presidencës së radhës, por edhe për luftimin e korrupsionit. Këtu jemi duke punuar së bashku me Bullgarinë në të ashtuquajturin mekanizëm bashkëpunimi për rishikimin e hapave që po bëhen në luftën kudër korrupsionit.

Sofja e ka vënë si prioritet afrimin e Ballkanit Perëndimor me BE. Si e shihni ju perspektivën e anëtarësimit të vendeve të Ballkanit në BE?

Bullgaria ka bërë mirë kur e ka vënë Ballkanin Perëndimor si një prej pikërëndesave të presidencës. Vendet e Ballkanit Perëndimor meritojnë që të kenë një perspektivë për anëtarësim në BE. Kjo nuk do të ndodhë gjatë kohës që jam unë president i Komisionit Evropian, por tani duhet të vihen piketat, ndërsa këto vende duhet të bëjnë reformat e duhura dhe ato sa më parë. Qeveria bullgare ka bërë disa hapa të rëndësishëm në këtë drejtim, sepse samiti i vendeve të Ballkanit Perëndimor në Sofje më 17 maj do të jetë një prej zhvillimeve më të rëndësishme.

Bullgaria është shumë e përshtatshme për të ndërtuar ura drejt Ballkanit Perëndimor, sepse e njeh këtë rajon, e njeh kulturën, gjuhët dhe ka pasur edhe vetë një proces të suksesshëm të anëtarësimit në BE.

A do të ketë Bullgaria gjatë kësaj presidence një rol të rëndësishëm edhe në komunikimin e BE me Ankaranë?

Bullgaria mund të luajë këtu një rol të rëndësishëm për thellimin e këtyre raporteve. Ne jemi të interesuar që të kemi një partneritet të ngushtë me Turqinë. Njëkohësisht Turqia, e cila dukej se është larguar, duket se sërish dëshiron të afrohet me Evropën. Bullgaria si fqinje e Turqisë, mund të angazhohet për thellimin e raporteve me Turqinë, intensifikimin e dialogut dhe mund të shërbejë si një lloj përkthyesi në këto raporte. Gjithmonë është më mirë të bisedohet mes vete dhe jo të flitet për njëri-tjetrin.

Eurodeputetja paralajmëron kryesuesen e re të BE-së, Bullgarinë

Fajon: BE të mbajë premtimin për Ballkanin Perëndimor, mund të humbasim këtë rajon

Deputetja e BE-së, Tanja Fajon

BE të mbajë premtimin për Ballkanin Perëndimor, pasi ato mund të shkojnë gjetiu", deklaroi deputetja e BE-së, Tanja Fajon. Ndërsa, Bullgaria merr presidencën e radhës së Këshillit të BE-së, Fajon ka një paralajmërim se vendet e Ballkanit Perëndimor që shpresojnë të bashkohen me bllokun mund të humbasin durimin. Sofja e ka bërë të qartë se një nga prioritet kyçe të presidencës së saj është rigjallërimi i ofertave për anëtarësi. "Në qoftë se udhëheqësit e BE-së nuk do të jenë të vetëdijshëm për atë që është në rrezik dhe nuk mbajnë premtimin për zgjerimin, atëherë shumë shpejt mund të humbasim rajonin, që mund të bjerë në paqëndrueshmëri ekonomike dhe politike. Ne shohim gjithashtu diku nacionalizëm në rritje dhe diku humbje të brezit të ri", deklaroi Fajon. Komisioni Evropian do të publikojë muajin e ardhshëm një strategji, që pritet të sigurojë themelet bazë për Serbinë dhe Malin e Zi për t'u bërë vendet e para kandidate në BE.

"Ne duhet t'i mundësojmë këtij rajoni një jetë më të mirë, të krijojmë perspektiva për të rinjtë, të hapim kufijtë dhe të jetojmë si fqinjë të mirë. Kjo lidhet me mënyrën se si duhet të rrisim besueshmërinë tonë jo vetëm brenda rajonit dhe Evropës, por kudo në botë", theksoi ajo. Krerët e shtetit dhe të qeverisë do të jenë në Sofje për një samit joformal mbi Ballkanin Perëndimor në maj, pasi Bullgaria duket se kërkon të lërë gjurmë në zgjerimin e BE-së.

Pronarët fitojnë dëmshpërblimin në Strasburg për shembjen e kompleksit "Jon"

Tritoli i qeverisë, pronarët marrin 13 milionë euro

Vjehrri i Bashës, Xhafer Isufi fiton betejën me qeverinë

Ornela Manjani

Gjykata e Strasburgut ka rrezuar qeverinë "Rama" për çështjen e pallatit të shkatërruar në Vlorë në vitin 2013 për ndërtimin e "Lungomares". Qeveria shqiptare duhet të paguajë 13 milionë euro për vendimin e shkatërrimit të një pallati banimi të pajisur me leje të rregullt. Gjykata e Strasburgut ka vendosur në mënyrë unanime se qeveria shqiptare ka shkelur të drejtat e njeriut dhe urdhëron qeverinë shqiptare të dëmshpërbleje familjaret e dëmtuar nga shembja e pallatit.

VENDIMI

Gjykata e Strasburgut ka shpallur fajtor shtetin shqiptar për prishjen në Vlorë më datë 4 dhjetor 2013 të pallatit të ndërtuar nga Xhafer Isufi, vjehrri i kreut të opozitës, Lulzim Basha. Padia e Isufit dhe 18 personave të tjerë që kishin blerë banesa në këtë pallat është pranuar nga gjykata. Gjykata e Strasburgut në vendimin e publikuar paraditen e kësaj të enjteje i dëmshpërblen 19 paditësit me 13 milionë euro në total. Gjyqtarët e Strasburgut kanë arritur në përfundimin se shteti shqiptar është përgjegjës për shkeljen e disa neneve të Konventës Europiane të Drejtave të Njeriut. Sipas vendimit të Strasburgut, shteti shqiptar ka 3 muaj kohë për t'u paguar dëmshpërblimin prej 13 milionë eurosh pronarëve të pallatit. Në dhjetor të vitit 2013 me VKM qeveria i dëmshpërbleu familjet që kishin blerë shtëpi në këtë pallat me me vlerën 462 919 230, por ata nuk e lanë me kaq: Paditën qeverinë "Rama 1" në Strasburg. Gjykata Ndërkombëtare për të Drejtat e Njeriut është shprehur me vendim pro pronarëve dhe kundër qeverisë shqiptare. Strasburgu kërkon që qeveria të dëmshpërblejë me plot 13 milionë euro pronarët. Kosto kjo që rëndon mbi buxhetin e shtetit dhe sigurisht mbi taksapaguesit shqiptarë.

Kompleksi i shembur në vitin 2013

SHEMBJA E PALLATIT

Kompleksi "Jon" në afërsi të "Ujit të Ftohtë" në Vlorë është rrafshuar përfundimisht pas marrjes së pushtetit nga Rama në vitin 2013. Shembja e pallatit me pronar vjehrrin e Lulzim Bashës shkaktoi shumë debate. Qeveria kishte dëmshpërblyer me 11.6 milionë euro pronarët e pallatit, por çështja u dërgua në Strasburg.

KOMPLEKSI

Kompleksi në fjalë "Godinë banimi dhe shërbime 5 kate + 1 kat papafingo + 1 kat nëntokë dyqane", në lagjen "Uji i Ftohtë" ishte ndërtuar nga subjekti "G.B-A KONSTRUKSION", me pronar Xhuvi Sharxhi dhe Xhafer Isufi në bazë të lejes së ndërtimit të miratuar nga KRT-ja e Bashkisë Vlorë në 2010. Pra, leja për këtë pallat ishte dhënë nga Shpëtim Gjika, asokohe kryetari socialist i Bashkisë së Vlorës.

PRONARET DHE SHUMAT E KOMPENSIMIT

1	Ballanca Erinda	191,406.28 euro
2	Basha Arben	191,406.28 euro
3	Calliku Gerti	163,492.86 euro
4	Calliku Valbona	95,703.14 euro
5	Deromemaj Abdul	129,598.00 euro
6	Durolli Eduard	182,909.27 euro
7	Hanxhari Ilonka dhe Mihallaq	114,187.86 euro
8	Kacorri Vullnet	129,598.00 euro
9	Kapidani Klima	200,965.41 euro
10	Mecaj Mimoza	147,486.44 euro
11	Pojani Teri	89,349.02 euro
12	Rakipaj Pano	89,349.02 euro
13	Rakipaj Baki	92,572.66 euro
14	Schenetti Giuliano	98,237.33 euro
15	Sopoti Etnik	113,647.48 euro
16	Dorina Ylli	200,070.99 euro
17	Xhafer Isufi (35 prona)	6,220,296.42 euro
18	Xhuvi Sharxhi (3 pronarë)	867,556.60 euro
19	Xhafer Isufi dhe Xhuvi Sharxhi	7,246,424.23 euro

Pallati, Braçe: Vjehrri i Bashës do u marrë shqiptarëve miliona euro

Deputeti socialist Erjon Braçe ka reaguar pas vendimit të Strasburgut, që detyron qeverinë shqiptare për të dëmshpërblyer vjehrrin e Bashës për shembjen e pallatit në Vlorë. Braçe shprehet se prona mbi të cilën u ngrit pallati u zgjerua në det, në mënyrë të paligjshme e kriminale. "14 milionë dollarë është çmimi i drejtësisë që mungon në këtë vend. Ishte e qartë nga fillimi, prona mbi të cilën u ngrit pallati dyshohej se nuk ishte produkt i trashëgimisë, produkt i një transaksioni të ligjshëm, por prej falsifikimit!

Nuk u hetua, gjykua, ndëshkua. Prona mbi të cilën u ngrit pallati u zgjerua mu brenda në det, në mënyrë të paligjshme e kriminale! Nuk u hetua, gjykua, ndëshkua. Leja për zhvillimin e një prone të tillë, domethënë ndërtimin e këtij pallati, u nxor përmes shantazhit kriminal. PD për këtë qëllim bllokoi këshillin bashkiak të Vlorë ditët kur duhet të miratonte buxhetin, duke shantazhuar një qytet të tërë. Nuk u hetua, gjykua, ndëshkua. Prona e re dyshohej se u regjistrua në kundërshtim të qartë me ligjin, pa lejen e shfrytëzimit-dokument bazë, njësoj si prona në themel të pallatit. Nuk u hetua, gjykua, ndëshkua. Nëse do ishte hetuar, gjykuar, ndëshkuar, por mbi të gjitha nëse do ishte verifikuar origjina e parave që u investuan aty, historia nuk do ishte kjo. 14 milionë dollarë nga paratë e tua dhe kujtdo tjetër në këtë vend janë kostoja e drejtësisë që mungon në këtë vend", shkruan Braçe.

Reagon ish-kryeministri për vendimin e Strasburgut

Berisha: Gjoba e urrejtjes së Ramës, mbi 2 miliardë euro

Pas daljes së vendimit nga Gjykata e Strasburgut, e cila u jep të drejtë banorëve për shpronësim pasi qeveria "Rama" prishi pallatin e tyre për projektin e Lungomares ka reaguar edhe ish-kryeministri Berisha, duke e quajtur këtë vendim të drejtë. Ish-kryeministri Sali Berisha përmes një komenti në rrjetet sociale tregon se gjoba që duhet të paguajë Rama nuk është 13 milionë, por sipas tij 2 miliardë euro. "Pallati ishte ndërtuar në truall privat në përputhje me planin e qytetit, me leje të rregullt të

kryetarit socialist të Bashkisë së Vlorës dhe nuk kishte asnjë lidhje me projektin e Lungomares, por vetëm me urrejtjen kafshërore të pakontrolluar të paranojakut me kartelë klinike të botuar ndaj kundërshtarit politik. Duke përshëndetur këtë vendim të Gjykatës Europiane të Strasburgut informoj shqiptarët se ky është vetëm fillimi, sepse gjobat që Shqipëria po merr e do të marrë nga arbitrazhet ndërkombëtare dhe gjykatat e vendeve të mëdha si dhe gjykata e Strasburgut arrijnë që tani, sipas disa burimeve të besueshme, në mbi 2 miliardë euro. Asokohe qeveria i dëmshpërbleu familjet që kishin blerë shtëpi në këtë pallat, por ata nuk e lanë me kaq, paditën qeverinë 'Rama 1' në Strasburg. Sot, Gjykata Ndërkombëtare për të Drejtat e Njeriut është shprehur me vendim pro pronarëve dhe kundër qeverisë shqiptare. Strasburgu kërkon që qeveria të dëmshpërblejë me plot 13 milionë euro pronarët. Kosto kjo që rëndon mbi buxhetin e shtetit dhe sigurisht mbi taksapaguesit shqiptarë", - shkruan Berisha në "FB".

NJOFTIM ANKANDI
PERMBARUES GJYQESOR PRIVAT ARTAN SIMA
Datë 19/01/2018, ditën e Premte ,ora 16,00 perfundon ankandi i ri (i parë) , për shitjen e pasurisë së paluajtshme lenë garanci nga debitori z. Ramadan Ibrahim Kordallibanues ne Bilisht ,Bashkia"Devoll" për detyrimin ndaj kreditorit : znj.Lindita Bere Kordalli, banuese ne fshatin"Tren",Rrethi Devoll .
"Apartament" me sipërfaqe totale 73.40 m2 e ndodhur në Bilisht, në vlerën 1.440.000 lekë.
Ankandet zhvillohet prane zyres se permbaruesit me seli lagjen nr.3, Rruga « Avni Rustemi », nr.31 ,k.1. Korce.
Kontakt Cel.0674044666, e-mail. simaartan@yahoo.com

NJOFTIM ANKANDI
PERMBARUES GJYQESOR PRIVAT ARTAN SIMA
Datë 19/01/2018, ditën e Premte ,ora 16,00 perfundon ankandi i ri (i parë) , për shitjen e pasurisë së paluajtshme lenë garanci nga debitori z.Artur Dilaver Hasani dhe bashkpronaret z.Dilaver Ramo Hasani , z.Edmond Hasani , znj.Luiza Dilaver (Hasani) Hoxha banues ne,Rr" 28 Nentori" ,L.5,P.2,Shk.B,Nr.9, Korce për detyrimin ndaj kreditorit : z.Rexhep Shaban Furramani,Rr.Hasim Vokshi,L.7,Nr.35,Korce.
"Apartament" me siperfaqe 63.10 m2,ndodhur ne Rr"28-Nentori", pll.2, shk.2, k.5,ap.9, Korce, në vlerën 1.600.000 lekë.
Ankandet zhvillohet prane zyres se permbaruesit me seli lagjen nr.3, Rruga « Avni Rustemi », nr.31 ,k.1. Korce.
Kontakt Cel.0674044666, e-mail. simaartan@yahoo.com

PRONAT KERKESAT

Shqyrtimi i dosjeve në Agjencinë e Trajtimit të Pronave, dokumentet pranohen në "e-Albania"

Ish-pronarët, Agjencia ndryshon procedurat për shqyrtimin e kërkesave

Aplikimi pa kosto, afati për përgjigjen 30 ditë

Ornela Manjani

Agjencia e Trajtimit të Pronave do të shqyrtojë të gjitha ankesat për vlerësimin e pronës dhe kërkesat për statusin e dosjes brenda 30 ditëve nga momenti i aplikimit. Në portën e vetme 'online' të qeverisë mund të gjeni shërbime të Agjencisë së Trajtimit të Pronave kushtuar qytetarëve, të cilët kërkojnë të sqarohen rreth problematikave të tyre apo të marrin një dokumentacion shtesë. Përmes një njoftimi ATP bën të ditur se pret ankesat nga portali qeveritar "e-Albania" dhe shpjegon të gjithë procedurën që duhet të ndjekin pronarët që kanë dosjet në proces shqyrtimi. "Shërbimet e reja elektronike të Agjencisë së Trajtimit të Pronave janë tashmë publike dhe do të ofrohen 'online' në portalin qeveritar 'e-Albania' për ankesë dhe trajtim të dosjes me specialistin përkatës pranë ATP dhe për kërkesat për statusin dhe problematikat e shqyrtimit të dosjes. Çështja e pronave mbetet ende mjaft e ndjeshme dhe në sportelet fizike të Agjencisë së Trajtimit të Pronave mbërrin një numër i konsiderueshëm kërkesash, që kërkojnë të marrin përgjigje. Posaçërisht, 'online' në portalin 'e-Albania' qytetarët e interesuar mund të kryejnë shumë shpejt dërgimin e një kërkese për informacion në lidhje me ecurinë e shqyrtimit të dosjeve të ndjekura nga ATP-ja", - thuhet në njoftimin e ATP-së.

PROCEDURA

Me anë të dërgimit 'online' të kërkesës për marrjen e informacionit, vetë ATP-ja përmes personave përgjegjës kryen shqyrtimin e kërkesës bashkë me dokumentacionin shoqërues. Në rastin kur kërkesa është e rregullt, ajo trajtohet nga specialistët dhe brenda 30 ditësh qytetarit të interesuar i kthehet përgjigjja 'online' përmes e-mail-it si dhe te seksioni "Hapësira ime" në portalin "e-Albania". Në rast se përgjigjja kërkohet edhe në letër, atëherë qytetari duhet të paraqitet fizikisht pranë sporteleve të ATP-së. Edhe kur aplikimi për kërkesën nuk është sipas rregullave të paracaktuara, sërish njoftimi i qytetarit bëhet me e-mail, duke shmangur çdo lloj keqkuptimi të mundshëm. E njëjta procedurë ndiqet edhe nëse qytetari ka ankesa në lidhje me shqyrtimin e dosjeve të ndjekura nga ATP-ja.

DOKUMENTACIONI I NEVOJSHËM

Bazuar në VKM nr. 255/2010 "Për procedurat e mbledhjes, të përpunimit dhe administrimit të kërkesave të subjekteve të shpronësuara gjatë procesit të njohjes, kthimit dhe kompensimit të pronës" subjektet e shpronësuara (trashëgimtarët apo përfaqësuesi me prokurë) paraqesin pranë ATP-së, Tiranë (përveç kërkesës për njohjen, kthimin apo kompensimin e pronës) dhe dokumentacionin e nevojshëm. Bazuar në VKM nr. 255/2010 "Për procedurat e mbledhjes, të përpunimit dhe administrimit të kërkesave të subjekteve të shpronësuara gjatë procesit të njohjes, kthimit dhe kompensimit të pronës" subjektet e shpronësuara (trashëgimtarët apo përfaqësuesi me prokurë) paraqesin pranë ATP-së, Tiranë (përveç kërkesës për njohjen, kthimin apo kompensimin e pronës) dhe dokumentacionin e nevojshëm.

Foto ilustruese

Dosjet në ATP

Në total në ATP janë 26 mijë dosje që kanë një ven dim dhe 11 mijë të tjera që presin vendimin për vlerësimin ekonomik. Dosjet e përfunduara janë të viteve 1993, 1994, 1995 dhe 2016. Pronarët që janë shpronësuar në vitin 1944 dhe që kanë aplikuar në Agjencinë e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, sot Agjencia e Trajtimit Pronës në vitin 1995 dhe 1996 për kthim dhe kompensim prone kanë gati vlerësimin financiar. Lista me pronarët që u është njohur e drejta për kompensim dhe fatura financiare për çdo kërkues do të publikohet javën e ardhshme nga ATP-ja. Për vitin 2015 janë në total 5357 pronarë që kanë gati faturën. Vlerësimet financiare të vendimeve përfundimtare për vitet 1993-1994 janë gjithsej 3925, ndërsa për vitin 2016 janë shqyrtuar 419 kërkesa.

ANKESË DHE TRAJTIM I DOSJES ME SPECIALISTIN PËRKATËS PRANË ATP:

Dokumentacioni i nevojshëm

1. Dokument identifikimi, kartë identiteti ose pasaportë biometrike (i nevojshëm për t'u loguar në portal).
2. Formulari i aplikimit për takime dhe ankesa.
3. Dokumentacion shtesë, nëse është e nevojshme.

Hapat e procedurës

1. Logohuni si qytetar në portalin "e-Albania".
2. Zgjidhni shërbimin "Ankesë dhe trajtim i dosjes me specialistin përkatës pranë ATP".
3. Plotësoni të dhënat e formularit, duke bashkëngjitur edhe dokumente plotësuese nëse është e nevojshme.
4. Klikoni butonin "Dërgo".
5. Specialisti i Zyrës së Marrëdhënieve me Publikun bën shqyrtimin e aplikimit dhe përpilon përgjigjen duke ia dërguar aplikantit të nënshkruar në mënyre dixhitale ose me postë në 'hard copy', në varësi të kërkesës së aplikantit.
   Koha e nevojshme për marrjen e shërbimit, 30 ditë. Pa pagesë

Kërkesë për statusin dhe problematikat e shqyrtimit të dosjes

Dokumentacioni i nevojshëm

1. Dokument identifikimi, kartë identiteti ose pasaportë biometrike (i nevojshëm për t'u loguar në portal).
2. Formulari i aplikimit për informim në lidhje me ecurinë e dosjes.
3. Dokumentacion shtesë, nëse është e nevojshme për hapat e procedurës.

1. Logohuni si qytetar në portalin "e-Albania".
2. Zgjidhni shërbimin "Kërkesë për statusin dhe problematikat e shqyrtimit të dosjes".
3. Plotësoni të dhënat e formularit, duke bashkëngjitur dhe dokumente plotësuese nëse është e nevojshme.
4. Klikoni butonin "Dërgo".
5. Specialisti i Zyrës Juridike bën shqyrtimin e aplikimit dhe përpilon përgjigjen duke ia dërguar aplikantit të nënshkruar në mënyrë dixhitale ose me postë në 'hard copy', në varësi të kërkesës së aplikantit.

Koha e nevojshme për marrjen e shërbimit 30 ditë, pa pagesë.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

NJOFTIM PËR EKSPERTË DHE SPECIALISTË TË PAVARUR

Në zbatim të ligjit Nr.9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 184, neni 8, datë 17.03.2010, Komisioni i Prokurimit Publik shpall konkurrimin për plotësimin e listës vjetore të Ekspertëve dhe Specialistëve të Pavarur në fushat: Ekspert vlerësimi i pasurive të paluajtshme; ekspert kontabël i regjistruar; inxhinjer elektronik/informatik; inxhinjer mekanik; inxhinjer hidrologjik; inxhinjer elektrik; inxhinjer gjeologji-minierash; inxhinjer mjedisi; inxhinjer ndërtimi; inxhinjer tekstile; kimist; specialist në farmaceutikë.

Kandidati duhet të plotësojë kërkesat :
1.Të ketë mbaruar arsimin e lartë në fushën ku ai do të konkurrojë.
2.Të ketë licensë në fushat ku ligji parashikon pajisjen me të.

Pagesa dhe shpenzimet e expertëve apo specialistëve të pavarur do të bëhet me parapagim nga pala ankimuese.

Kandidati duhet të paraqesë **brenda datës 09 Shkurt 2018** në selinë e Komisionit të Prokurimit Publik këto dokumenta: kërkesën për Aplikim, CV-në, fotokopje të diplomës dhe librezës së notave, fotokopje të lincensës si ekspert, të librezës së punës, vërtetimin e gjendjes gjyqësore, fotokopje te kartës së identitetit, një numër telefoni për t'u kontaktuar si dhe adresën e plotë të vendqëndrimit.

REPUBLIKA E SHQIPERISE
BANKA E SHQIPERISE
DEPARTAMENTI I ADMINISTRIMIT
SEKTORI I PROKURIMIT

TENDER I HAPUR KOMBËTAR

Banka e Shqipërisë kërkon të realizojë objektin e prokurimit: **"Shërbimi vjetor i mirëmbajtjes dhe riparimit të motogjeneratorëve dhe stabilizatorëve të Bankës së Shqipërisë"**.

Banka e Shqipërisë fton kandidatët e interesuar, të marrin pjesë në procedurën e prokurimit "Tender i hapur kombëtar", për realizimin e objektit të prokurimit si më sipër, me **fond limit 3,120,000 Lekë"**.

Dokumentet e tenderit mund të tërhiqen pranë Sektorit të Prokurimeve të Departamentit të Administrimit, të Bankës së Shqipërisë, me adresë: Rruga e Dibrës, Kompleksi "Halili", Kulla A, Tiranë, Tel. 042419411(ext. 4251), çdo ditë nga ora 10.00 – 13.00 nga çdo person i autorizuar, me paraqitjen e një kërkese me shkrim. Tërheqja e dokumenteve mund të bëhet vetëm pasi të keni bërë paraprakisht pagesën e pakthyeshme prej 500 Lekë, pranë një banke tregtare në llogarinë e Bankës së Shqipërisë sipas detajeve të mëposhtme:

Përfituesi: Banka e Shqipërisë
BIC: STANALTR
IBAN: AL68 1011 1008 0000 0000 2222 222L; BIC

Përshkrimi: Blerje dokumente tenderi për tenderin me objekt: "**Shërbimi vjetor i mirëmbajtjes dhe riparimit të motogjeneratorëve dhe stabilizatorëve të Bankës së Shqipërisë**"

Oferta duhet të paraqitet në zyrën e Sektorit të Prokurimeve, pranë Departamentit të Administrimit, në Bankën e Shqipërisë, deri më **datë 07 Shkurt 2018, ora 11:00**, kohë në të cilën do të hapet edhe tenderi, ku ftohen të marrin pjesë kandidatët ose përfaqësuesit e autorizuar të tyre.

Prodhuesit shqiptarë shprehen pro unifikimit ekonomik Shqipëri-Kosovë

"Të hapet tregu me Kosovën, duhen subvencione"

Bashkimi i Prodhuesve Shqiptarë, Klubi i Prodhuesve të Kosovës dhe Forumi i Përbashkët të Prodhuesve Shqiptarë, u mblodhën dje për një deklaratë për shtyp në lidhje më hapjen e kufijve tregtarë Shqipëri-Kosovë. Nagip Fejzi, kryetar i Forumit të Përbashkët të Prodhuesve Shqiptarë, në fjalën e tij tha: "Jemi këtu prezent, unë si kryetar i Forumit të Përbashkët të Prodhuesve Shqiptarë, Bardhyl Baltëza si kryetar i Bashkimit të Prodhuesve Shqiptarë dhe Astrit Shabani si kryetar i Klubit të Prodhuesve të Kosovës. Siç e dini, dy ditë para, pati një deklaratë, e cila na shqetëson ne si prodhues të Kosovës dhe Shqipërisë. Ne kemi një bashkëpunim shumë të mirë mes prodhuesve të Shqipërisë dhe Kosovës, por kemi dhe disa pengesa, të cilat pengojnë bashkëpunimin tonë më të mirë. Pas asaj deklarate ne e pamë të arsyeshme të takohemi këtu në Tiranë dhe të jemi të gjithë së bashku të tregojmë, që ne si prodhues jemi të sigurt që ato deklarata nuk janë me qëllim. Jemi këtu për t'iu treguar atyre afaristë apo atyre biznesmenë, të cilët flitet se pengojnë nënshkrimin e marrëveshjeve mes dy qeverive, që shpresojmë se gjithçka që është thënë, nuk është e vërtetë, por, nëse do të ketë diçka të vërtetë ne jemi të gatshëm t'i presim dhe ta diskutojmë. Shpresoj që pas kësaj deklarate çdo person që do të ketë nevojë, të na kontaktojë. Ne jemi këtu për të bërë më të mirën dhe jo për të bërë përçarjen e bizneseve. Keqinterpretimet ndodhin zakonisht në këto vende. Ju falënderoj edhe njëherë për prezencën dhe, nëse do të keni ndonjë pyetje, ne jemi këtu për të dhënë sqarime". Bardhyl Baltëza, president i Bashkimit të Prodhuesve Shqiptarë, në fjalën e tij u shpreh: "Dua të theksoj dy probleme. Ne jemi këtu për t'ju thënë që prodhuesit shqiptarë nga të dy anët e kufirit kanë propozuar prej kohësh qeverive shqiptare për unifikimin ekonomik midis dy vendeve dhe sinqerisht nuk shohim asnjë pengesë midis nesh, nuk ka midis nesh njerëz që janë kundër këtij bashkimi ekonomik.

Prodhuesit shqiptarë e të Kosovës gjatë deklaratës për shtyp

Dhe unë besoj, në frymën e Komunitetit Europian që ekonomitë mund të bashkohen dhe ne nuk bëhemi pengesë për këtë. Jemi ne promotorët përpara qeverive tona për ta shtyrë përpara këtë proces. Kanë mbetur probleme burokratike, të cilat ne shpresojmë, të paktën dy qeveritë, si e Kosovës dhe Shqipërisë, parimisht janë dakord, dhe na habit fakti që mund të ketë disa probleme të vogla, të cilat në thelb janë të parëndësishme, të cilat ne duhet t'i kalojmë shumë shpejt".

Ministrja e Drejtësisë: Praktikë e re për shtyrtimin e dosjeve të ish-të dënuarve politik

Gjonaj: Ish-të përndjekurit, rivlersim për dëmshpërblimet

"Në fokus rishikimin e të gjitha kërkesave"

Ornela Manjani

Ministria e Drejtë sisë do të rishikojë të gjitha kërkesat për dëmshpërblimin e ish të dëmuarve politik. Premtimi u bë dje nga Ministra e Drejtësisë Etilda Gjonaj gajtë një takimi për përfaqësues të ish-të përndjekurve poltik pas kërkesës së tyre për të marrë informacion lidhur me dosjet e tyre për dëmshpërblim. Gjatë takimit, dhe pas ballafaqimit me strukturat përgjegjëse në Ministri, dolën në pah disa problematika dhe vonesa lidhur me trajtimin e mëparshëm disavjeçar të dosjeve të ish të dënuarve. Ministrja Gjonaj mori përsipër ngritjen e një praktike të re pune në Ministrinë e Drejtësisë, që do të ketë në fokus rishikimin e të gjitha kërkesave për dëmshpërblim që janë ende në shqyrtim në Ministrinë e Drejtësisë. Në këtë kuadër, Ministrja u premtoi ish të dënuarve transparencë të plotë dhe përgjigje në afate të shkurtra lidhur me statusin e dosjeve të tyre. Ministrja e Drejtësisë u anagazhua personalisht për trajtimin me objektivitet dhe paanësi të të gjitha kërkesave për shqyrtim. "Prita sot në një takim përfaqësues të një grupi ish të dënuarish politik të regjimit komunist, pas kërkesës së tyre për të marrë informacion lidhur me dosjet e tyre për dëmshpërblim. Gjatë takimit, dhe pas ballafaqimit me strukturat përgjegjëse në Ministri, dolën në pah disa problematika dhe vonesa lidhur me trajtimin e mëparshëm disavjeçar të dosjeve të ish të dënuarve"-shkruan ministraj në faqen e saj zyrare në FB. Ish-të dëmuarit politik të kategorsë parësore presin të marrin këstin e tetë dhe të fundit ndërsa pagesat për trashëgimtarët janë në tre këstet e para.

ETILDA GJONAJ
"Mora përsipër ngritjen e një praktike të re pune në Ministrinë e Drejtësisë, që do të ketë në fokus rishikimin e të gjitha kërkesave për dëmshpërblim që janë ende në shqyrtim në Ministrinë e Drejtësisë. Në këtë kuadër, u premtova ish të dënuarve transparencë të plotë dhe përgjigje në afate të shkurtra lidhur me statusin e dosjeve të tyre".

PROTESATA

Para takimit me ministren ish-të përdjekurit protestuan dje para Ministrisë së Drejtësisë duke akuzuar qeverinë se nuk u ka dhënë dëmshpërblimet. Ata tentuan të hyjnë në ambientet e Ministrisë për të takuar ministren Gjonaj teksa ajo zhvillonte një takim me kreun e Antikorrupsionit italian, Rafaele Cantone, por nuk u lejuan nga policia. Në një deklaratë për mediat, ish-të përndjekurit kërkuan plotësimin e kërkesave të tyre, në të kundërt thanë ata do të përsëritin grevën e vitit 2012, kur ata qendruan per 31 dite ne greve. "Nuk e vë ujin në zjarr asnjë, të gjithë këta janë këlyshët e komunistëve në fuqi. Kemi bërë grevën në 2016, ku u flijua vëllai jonë Lirak Bejko, u dogj në zjarr. Mua më dënoi komunizmi 15 dhe bëra 5 vjet burg. Nga këto asnjë këst, asnjë qindarkë nuk kam marrë. Nuk është puna e lekut, por puna e të drejtës. Ne do të bëhemi gati për një grevë urie si në 2012. Presim këtu, nuk del me na pritë"-deklaruan protestuesit.

DOSJET

23 mijë është numri i ish-të përndjekurve politikë, që përfitojnë dëmshpërblim.
1500 ish-të dënuar politikë të kategorisë parësore kanë marrë këstin e shtatë dhe janë në pritje të këstit të tetë.
500 trashëgimtarë ish-të dënuar politikë kanë marrë deri tani vetëm këstin e parë.
600 trashëgimtarë të ish-të dënuarve polikë kanë marrë më shumë se dy këste dhe janë në pritje të késteve të radhës.

TRASHËGIMTARËT

1. "Për persona ish të dënuar që janë gjallë të cilët pavarësisht moshës në momentin e pagesës kanë fëmijë të mitur nën moshën 18 vjeç"
a. Certifikatë personale jo më e vjetër sesa një javë nga data e dorëzimit;
b. Certifikatë familjare ku të përfshihet fëmija i mitur;
c. Certifikatë personale të fëmijës/fëmijëve të mitur;
d. Nr. Llogarie bankare në Lek në njërën nga bankat e nivelit të dytë që vepron brenda territorit të Republikës së Shqipërisë (të siguroheni që llogaria është ende aktive ose të hapet një llogari e re).
2 "Për persona ish të dënuar që nuk jetojnë, por në momentin e pagesës kanë trashëgimtarë të rradhës së parë në moshë të mitur nën 18 vjeç"
a. Certifikatë vdekje të personit ish të dënuar;
b. Certifikatë personale e të miturit/miturve, trashëgimtarë të rradhës së parë të personit ish të dënuar që nuk jeton më;
c. Certifikatë familjare të ish të dënuarit ku të përfshihen fëmija/fëmijët e mitur;
d. Dëshmi trashëgimie që të vërtetojë se fëmija i mitur është trashëgimtar ligjor;
e. Vendim Gjykate të kujdestarisë mbi të miturin në rastin kur edhe nëna e të miturit nuk jeton më;
f. Nr. Llogarie bankare në Lek në njërën nga bankat e nivelit të dytë që vepron brenda territorit të Republikës së Shqipërisë (të siguroheni që llogaria është ende aktive ose të hapet një llogari e re) në emër të kujdestarit ligjor të të miturit.

NJOFTIM SHITJE ME ANKAND

PASURINË NR. 2/963-ND+1-43 , E LLOJIT 'APARTAMENT' , VOLUMI 55 , FAQJE 73, ZONA KADASTRALE 8513 , ME SIPËRFAQJE 67,81 M2 , NË ADRESËN : RRUGA "K. KËRTUSHA" , SHKALLA 1 , KATI 7 , DURRËS , NË PRONËSI TË SHTETASVE : Z. LUTFI GJYZELI DHE ZNJ. ENKELEJDA GJYZELI .
ÇMIMI 2.800.000 LEKË ", Data e zhvillimit të ankandit do jetë 19.01.2018 .
CEL. 0684026666 ; 0693262866 .

Permbaruesi gjyqesore Genti Bushati nxjerr per shitje ne ankand pasurine :

Permbaruesi gjyqesore **Genti Bushati** nxjerr per shitje ne ankand pasurine :
"Toke Are truall nr pasurie 222/11, vol 4 , faqe 83 ne Zonen Kadastrale 3652 ndodhur ne fshatin Trush , Njesia Administrative Berdice , bashkia Shkoder
2. Çmimi me të cilin do të fillojë shitja në Ankand për pasurinë e siperpershkruar , eshte në vleren 515,200 (peseqind e pesembedhjetemije e dyqind) leke
Shitja e pasurise do te behet (zhvillohet) me date **15.01.2018 ora 16.16** ne Zyren e permbaruesit gjyqesore Genti Bushati me adrese Rruga Don Bosko , Perballe Gjykates se rrethit Gjyqesore Shkoder. Personat e interesuar duhet te derdhin perpara fillimit te ankandit 10 % te vleres si garanci ne Banken BKT dega Shkoder me nr llogarie 41064051, ose ne Tirana Bank me nr IBAN AL74 2065 1017 0000 6

SHOQËRIA PËRMBARUESE PRIVATE "E.P.S.A"
SHPK NJOFTON SHPALLJEN E ANKANDIT PER:

1- "Truall" me sip. 200 m² nga kjo ndretese 114 m2,Nr. pasurie 9/584, Vol. 27, Faqe 87, ZK 8532 i ndodhur ne Sheq i Madh, Fier. Pasuria eshte hipotekuar ne favor te Bankes Alpha sha. Çmimi me të cilin fillon ankandi I është **9.472.000 Leke.** Ankandi per do te zhvillohet **datë 22.01.2018 ora 16.00** në adresen Rr."I. Qemali", Pall."Fratari", K.6,Tirane
2- "Are" me sip. 9.159 m²,Nr. pasurie 117/37, Vol. 10, Faqe 165, ZK 3981, i ndodhur ne Sheq , Fier. Pasuria eshte hipotekuar ne favor te Bankes Alpha sha. Çmimi me të cilin fillon ankandi I është **16.852.160 Leke.** Ankandi per do te zhvillohet **22.01.2018 ora 16.00** në adresen Rr."I. Qemali", Pall."Fratari", K.6,Tirane .
Per cdo informacion kontaktoni ne tel. 04 2262711 ose ne www.epsa.al.

Punonjësit që s'pranojnë t'i nënshtrohen procesit, të japin dorëheqjen

Vetingu në polici, përjashtohen efektivët që japin deklarim të rremë

Largohen automatikisht ata që fshehin pasurinë

TIRANË

Punonjësit e policisë që gjatë procesit të vlerësimit të njohur si vetingu do të japin deklarime apo informacione të rreme, do të përjashtohen nga radhët e uniformave blu. Kështu parashikohet në nenin 60-të të projektligjit të vetingut për policinë, i përgatitur nga Ministria e Brendshme. Sipas TV "Klan", përjashtime nga policia parashikohen edhe në raste të tjera ku përfshihet fshehja e pasurisë, mungesa e justifikimit ligjor të pasurisë që do të sjellë automatikisht largimin e çdo punonjësi nga uniformat blu. Zbulimi i lidhjeve apo kontakteve të konsideruara të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, do ta bëjë të pamundur vijimin e detyrës për një punonjës policie. Ata janë të detyruar t'i nënshtrohen testimit për varësinë ndaj drogës, alkoolit dhe lojërave të fatit.

Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit

Testime pritet të këtë edhe në karakterin psikologjik nëpërmjet makinës së të vërtetës. Refuzimi i kryerjes së testeve shtesë mund të jetë shkak për largimin nga detyra të punonjësit të policisë.

Por njëlloj si në rastin e gjyqtarëve dhe prokurorëve, edhe punonjësit e policisë që nuk dëshirojnë t'i nënshtrohen vetingut janë të lirë të japin dorëheqjen. Sipas draftit të hartuar, ata duhet të largohen jo më vonë se 30 ditë pas hyrjes në fuqi të ligjit. Në këtë rast të gjithë të dorëhequrit do të kenë mundësinë të trajtohen me pagë kalimtare. Por të gjithë ata punonjës policie që do të kalojnë fazën e parë të vetingut, nuk do ta mbyllin me kaq. Kjo, pasi në dispozitat kalimtare parashikohen kontrolle dhe vlerësime të tilla të ngjashme, që mund të bëhen në mënyrë periodike. Gjithsesi, projektligji mbetet ende në fazën e diskutimeve dhe tashmë po shqyrtohet nga institucionet e ndryshme.

Do kalojnë në "sitë" 5 dosje

Vetingu në organin e akuzës, hidhet shorti për 11 prokurorë

TIRANË - Në Prokurorinë e Përgjithshme u hodh shorti për rivlerësimin kalimtar të prokurorëve, mbështetur në ligjin Nr.84/2016 "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë" për procesin e vetingut. Shorti u hodh nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit për prokurorët e Prokurorisë së Përgjithshme dhe të drejtuesve të Prokurorive të Rretheve Gjyqësorë. Për secilin prej 11 prokurorëve në short, përzgjidhen 5 dosje nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit. Procedurën e hedhjes së shortit e mbikëqyri kryetari i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, znj. Genta Bungo. Nga hedhja e shortit u përzgjodhën për vijueshmërinë e procesit prokurorët: Arben Kraja, Adnand Xholi, Thoma Jano, Arqile Koça, Artur Selmani, Sokol Stojani, Anila Leka dhe Kosta Beluri. Komisionerët e pavarur të kualifikimit në prani dhe të kreut të KPK-s, Genta Bungo, në ambientet e Prokurorisë përzgjodhën me short 5 dosje nga aktiviteti i tri viteve të fundit të prokurorëve. Me 55 dosjet e 11 prokurorëve që kaluan në këtë short, KPK mbyll ciklin e përzgjedhjes së vetingut për prokurorët e Prokurorisë së Përgjithshme. Më parë me short janë përzgjedhur për t'u vetuar ish-kryeprokurori Adriatik Llalla, ish-drejtuesja e dekriminalizimit Rovena Gashi, prokurori Petrit Fusha dhe prokurori Ramadan Troci. Ndërkohë, dy prej prokurorëve, të cilët janë bërë pjesë e shortit të vetingut, kanë qenë pjesë edhe e garës për t'u bërë kryeprokuror, mes tyre Arqile Kocaj dhe Artur Selmani.

LISTA E PROKURORËVE QË IU NËNSHTRUAN SHORTIT

1. Arben Kraja
2. Adnand Xholi
3. Thoma Jano
4. Arqile Koça
5. Artur Selmani
6. Sokol Stojani
7. Anila Leka
8. Kosta Beluri
9. Adnan Kosova
10. Alfred Progonati
11. Alma Muça

bashkëpunimi gjerman
DEUTSCHE ZUSAMMENARBEIT
Implemented by giz

LAJMËRIM PËR TENDER KUALIFIKIMI PARAPRAK

1. Kushtet e përgjithshme

1.1 Kërkuesit : Bashkëpunimi Ndërkombëtar Gjerman (GIZ), Zyra në Tiranë
Adresa: Rr. Skënderbeg, Nr. 21/1

1.2 Profili : Bashkëpunimi Ndërkombëtar Gjerman (GIZ), Zyra në Tiranë që nga viti 1988 mbështet Shqipërinë në rrugën drejt Integrimit Europian dhe zhvillimit nëpërmjet projekteve që zbatohen në fushat: për Zhvillim Ekonomik, Reforma ligjore në ekonomi, Edukim dhe Kualifikim Profesional, Reforma në sektorin e ujësjellësit, dhe fusha të tjera.

1.3 Subjekti: GIZ fton Agjenci Udhëtimi të kualifikuara, anetare ne IATA të shprehin interes në sigurimin dhe menaxhimin e shërbimeve të udhëtimeve sipas kërkesave të Zyrës së administratës dhe të Projekteve të GIZ.
Profili i udhëtimeve të GIZ është kryesisht Tiranë - Gjermani - Tiranë, sipas nevojës dhe në vënde të tjera.
Të gjithë subjektet ligjore të interesuar në proçesin e aplikimit duhet të kërkojnë një formë aplikimi ne adresën; giz-albanien@giz.de

1.4 Data përfundimtare për pranimin e aplikimit të plotësuar në Anglisht është **26 Janar 2018.**
Dokumenti i plotësuar në mënyrë të saktë, duhet të dorëzohet në një zarf të mbyllur, të vulosur me mbishkrimin:
Aplikim për kualifikim paraprak "Menaxhim Shërbime Udhëtimi" adresuar tek
Bashkëpunimi Ndërkombëtar Gjerman (GIZ), Zyra në Tiranë,
Rr. Skënderbej, Nr. 21/1
Tiranë

Proçesi i kualifikimit do të fillojë pas datës së mbylljes së aplikimit.
Aplikimet do të vlerësohen dhe vetëm kandidatët e kualifikuar do të ftohen të marrin pjesë në tender.

unicef for every child
UNITED NATIONS CHILDREN'S FUND (UNICEF)
Albania Country office

REQUEST FOR PROPOSAL FOR SERVICES

Subject: Conduct an Assessment of Legal, institutional framework and human resources on Violence Against Children in Albania, with focus on Child Sexual Exploitation and Abuse in the virtual space.

The United Nations Children's Fund (UNICEF) is seeking to receive proposals from interested organizations/ companies who wish to be considered for the provision of the above-mentioned services/works.

Please consult UNICEF Albania website (**www.unicef.org/albania**) to download the detailed RFPS document and other related requirements.

The proposals will be evaluated and selected in accordance with established UNICEF procedures.

The offers must be delivered within the set deadline, in a sealed envelope which must be clearly marked: **"LRPS-2018-9137070 - Assessment of Legal, institutional framework and human resources on Violence Against Children in Albania"** to the address below:

United Nations Children's Fund (UNICEF)
Rr. "Skënderbej", ndërtesa e Agjencive të OKB-së, kati i tretë, Tiranë, Albania
Tel.: **+355 44548405**; Website: www.unicef.org/albania

Relevant Dates: All interested companies must submit their application, not later than **22 January 2018, 12:00 hrs**.

Procedura, ja se kur do t'u caktohet intervista

Vizat në SHBA, ambasada amerikane: Si të aplikoni saktë që herën e parë

Të gjithë ata që dëshi rojnë të aplikojnë për vizë në Shtetet e Bashkuara, tashmë mund të ndjekin procedurën saktë që herën e parë. Kjo bëhet me dije nga ambasada amerikane në Tiranë, e cila thekson se çdo të enjte kandidatët mund të drejtojnë pyetjet e tyre për çdo paqartësi në lidhje me hapat që duhen ndjekur. "Fatmirësisht, ne jemi ekspertë kur vjen puna tek aplikimi për vizë dhe u përgjigjëm saktë me herën e parë! Nëse zgjidhni të aplikoni për vizë, procedura është "një dhe vetëm një". Aplikoni në mënyrë të saktë",-citohet në njoftimin e publikuar në faqen zyrtare të ambasadës. Qëllimi i udhëtimit të aplikantit dhe të tjera fakte do të përcaktojnë llojin e vizës që atij i duhet sipas ligjit amerikan për emigrimin. Si aplikues për vizë, ai duhet të përcaktojë nëse i përmbush të gjitha kriteret e përcaktuara për të marrë kategorinë e vizës që kërkon. "Intervista do t'u caktohet në momentin që çështja juaj është aktuale sipas Buletinit të Vizave. Qendra Kombëtare e Vizave (NVC) fillon procedurën e mbledhjes së dokumentacionit të nevojshëm disa muaj përpara se çështja juaj të jetë aktuale, në mënyrë që ju të mos humbisni kohë me këtë procedurë dhe çështja juaj të jetë gati sapo ajo të jetë aktuale",-citojnë përfaqësuesit e ambasadës. Akti i Emigracionit dhe Kombësisë parashikon disa kategori të vizave jo-emigruese për një person që dëshiron të punojë përkohësisht në Shtetet e Bashkuara. Në faqen e ambasadës, gjithashtu, aplikantët kanë mundësinë të shqyrtojnë të gjitha llojet e vizave që janë në dispozicion, turistike apo të punësimit. Ndërkaq, në faqen zyrtare të ambasadës amerikane bëhet me dije se të gjithë ata që ndodhen në Shtetet e Bashkuara me vizë turistike duhet t'u përmbahen kushteve dhe të mos përpiqen të studiojnë apo punojnë në këtë vend. Për të shmangur në të ardhmen problemet me vizën apo me hyrjen në Shtetet e Bashkuara, qëllimi dhe koha e qëndrimit në Shtetet e Bashkuara duhet të jetë në përputhje me çfarë kandidati ka thënë në aplikimin për vizë.

Ambasada amerikane

SQARIMI/ Mjekët: Panik i kotë, virusi nuk mund të jetojë në një mjedis të thatë

Paracetamoli vdekjeprurës, Kontrolli i Barnave zbardh të vërtetën

Farmacistët: Nuk është i regjistruar në Shqipëri

Voltiza Duro

Në internet po qarkullojnë thash etheme se konsumimi i paracetamolit me mbishkrimin P/500 në paketim, mund të jetë fatal për jetën e njeriut. Ky lajmërim sa vjen e po bëhet më viral në Shqipëri, duke shkaktuar panik në radhët e qytetarëve, pasi sipas njoftimit ky lloj medikamenti përmban virusin "Machupo", me një shkallë të lartë vdekshmërie. Në një prononcim eksluziv për "Gazeta Shqiptare", një nga përfaqësueset e Agjencisë Kombëtare të Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore qetëson opinionin publik duke theksuar se paracetamoli P/500 nuk është i regjistruar dhe nuk qarkullon brenda territorit të Republikës së Shqipërisë. "Ky lajmërim që po përhapet me shpejtësi në rrjetet sociale e po bëhet viral çdo ditë e më shumë është vetëm një "fake news" apo lajm i rremë, si shumë lajmërime të tjera. Dua të qetësoj opinionin publik se ky lloj medikamenti nuk qarkullon në farmacitë shqiptare dhe se nuk përbën asnjë rrezik për jetët e njerëzve",-thekson përfaqësuesja e Agjencisë Kombëtare të Barnave. Ndërkaq, të pyetur nga "GSH" disa prej farmacistëve në kryeqytet mohojnë faktin e regjistrimit apo tregtimit të këtij lloj paracetamoli. Më tej mjekët thonë se sipas studimeve, nuk ekziston mundësia që virusi të jetojë në një ambient të thatë. "Paracetamoli është acetominofen dhe nuk ka pse të ketë virus brenda pasi është komplet inorganik. Virusi nuk mund të jetojë në kushte jo të përshtatshme. E gjithë kjo nuk ka kuptim, e bëhet vetëm për të hapur panik",-tregon një nga mjeket e pyetur nga "Gazeta Shqiptare".

LAJMËRIMI

Në rrjetet sociale po përhapet me shpejtësi lajmërimi se paracetamoli P/500 mbart virusin "Machupo" tejet të rrezikshëm për jetën. "Kini kujdes të mos merrni paracetamol që vjen me shkrim P/500. Është një paracetamol i ri, shumë i bardhë dhe me shkëlqim. Mjekët kështillojnë që ajo të përmbajë virusin "Machupo", që konsiderohet si një nga viruset më të rrezikshme në botë me një vdekshmëri të lartë",-thuhet në lajmërim. Ky i fundit, edhe pse nuk arrin të vërtetohet me prova të besueshme, po përhap frikë te qytetarët që vazhdojnë të shpërndajnë virtualisht njoftimin. Ndërkaq, vetë virusi Machupo është i njohur si një lloj virusi që përhapet nëpërmjet ajrit, ushqimit ose kontaktit të drejtpërdrejtë. Gjithashtu, mund të transmetohet edhe nga pështyma, urina ose feçeja e brejtësve të infektuar. Por ky njoftim është shfaqur edhe në Kosovë këto ditët e fundit, dhe në Malajzi rreth një vit më parë, por është hedhur poshtë si i rremë nga instancat përkatëse. Në fillim të 2017-ës, homologu i Indonezisë për Ushqimin dhe Barnat bëri me dije se e gjitha kjo është vetëm një mashtrim. Deri më tani, nuk ka pasur një raport të besueshëm që mbështet pretendimin e pranisë së virusit "Machupo" në medikamentin e paracetamolit apo edhe në barna të tjera. Më 8 shkurt 2017, zyrtarët e shëndetit publik në Malajzi, gjithashtu, përgënjeshtruan thashethemet, duke përsëritur se viruset zakonisht nuk mund të mbijetojnë në pilula. Mesa duket, situata e panikut po përsëritet sërish këtë herë në vendin tonë, ku Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore rrëzon çdo pretendim të njoftimeve virale dhe qetëson në këtë mënyrë opinionin publik.

AGJENCIA E BARNAVE: LAJM I RREMË

"Ky lajmërim që po përhapet me shpejtësi në rrjetet sociale është vetëm një lajm i rremë. Dua të qetësoj opinionin publik se ky lloj medikamenti nuk qarkullon në farmacitë shqiptare dhe se nuk përbën asnjë rrezik", - thekson përfaqësuesja e Agjencisë Kombëtare të Barnave.

MJEKJA: GJITHÇKA PËR TË HAPUR PANIK

"Paracetamoli është acetominofen dhe nuk ka pse të ketë virus brenda pasi është komplet inorganik. Virusi nuk mund të jetojë në kushte jo të përshtatshme. E gjithë kjo nuk ka kuptim, e bëhet vetëm për të hapur panik",-tregon një nga mjeket e pyetur nga "Gazeta Shqiptare".

SITUATA

Zyrtarët e shëndetit publik në Malajzi përgënjeshtruan thashethemet, duke përsëritur se viruset zakonisht nuk mund të mbijetojnë në pilula. Mesa duket, situata e panikut po përsëritet sërish këtë herë në vendin tonë, ku Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore rrëzon çdo pretendim të njoftimeve virale dhe qetëson në këtë mënyrë opinionin publik.

KINEASTI
HISTORIA

Flet 87-vjeçari, i cili nga majat e Kinostudios e TVSH-së përfundoi në burg politik

Dhimitër Lala: Porosia e Hrushovit për Enver Hoxhën

Kineasti: Çu En Lai më befasoi, si iu përgjigj Mehmet Shehut

Rezarta Delisula

Jeta e tij i përngjan një mali që ka bazë, por dhe majë. Ai e arriti kulmin e tij, sepse Arkiva e filmit të ish-Kinostudios mban qindra regjistrime të tij, dokumentarë e kino-zhurnale, ndeshje futbolli dhe reportazhe jashtë shtetit, histori të bujshme në vitet '50-'70. Por preku dhe bazën, kur nga operatori i parë i udhëheqjes u dënua për agjitacion e propagandë e vuajti dënimin 6 muaj në Spaç. Ky është Dhimitër Lala, 87-vjeçari që sot rron me pension minatori e askush nuk u kujtua për t'i dhënë një pension shtetëror të posaçëm këtij njeriu, që luftoi për çlirimin e vendit që në moshën 13-vjeçare, që ka një kontribut të jashtëzakonshëm në themelimin e kinematografisë shqiptare dhe së fundmi një njeriu që ka vuajtur në Spaç, dhunën e egër të regjimit komunist. Në këtë intervistë për "Gazeta Shqiptare", Dhimitër Lala rrëfen historinë e jetës së tij dhe detajet shumë interesante e të pathëna më parë për takimin e Enverit me Hrushovin dhe Mehmet Shehut me Çu En Lain.

Kur keni lindur?

Kam lindur në qytetin e Pogradecit më 2 tetor 1931. Fëmijërinë e shkollimin e kam kaluar në këtë qytet të bukur buzë liqenit. Edhe më vonë, kur ika nga Pogradeci, kthehesha vazhdimisht. Lashë aty nënën, babanë, dy vëllezër e dy motra.

Pse ikët nga Pogradeci?

Në fshat erdhi brigada e IV dhe unë u bashkova me to, dola partizan. Morëm rrugën për të çliruar veriun e vendit e më pas çliruam Tiranën.

Ju ishit fare i vogël në ato kohë, ishte e vështirë për ju?

Jo përkundrazi, në atë kohë u bë si modë që djem e vajza të vegjël iu bashkuan Lëvizjes Nacional Çlirimtare. Për aftësi në luftë mora "Medaljen e Trimërisë", "Medaljen e Çlirimit" dhe "Medaljen e Kujtimit". Pas lufte ndoqa shkollën Skënderbej e isha nga nxënësit e parë në shkollën ushtarake. Në vitin 1949 ndoqa studimet e larta për oficer dhe u diplomova. Punova pak vite në këtë zanat deri në nëntor 1953 e pastaj më kaluan te Kinostudio Shqipëria e Re.

Dhimitër Lala duke folur për "GSH"

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PRESIDENTI I REPUBLIKËS

I JEP

ZOTIT DHIMITËR LALA

Urdhrin "Naim Frashëri" i Artë

"Për kontribut të çmuar si një nga operatorët e parë në kinematografinë shqiptare, i cili dhënë autor realizues i shumë kronikave dhe filmave dokumentarë".

Tiranë, më 28.03.2012
Nr. Dekretit 7352

PRESIDENTI
BAMIR TOPI

Pse ju kaluan në Kinostudio?

Ushtria ka një gjë që po të jesh karrierist ecën, ndërsa unë kisha më shumë lidhje me artin e bëra luftë të madhe që u çmobilizova. Nuk kisha prirje për ushtarak, sepse duhej të ishe strikt për të qenë i tillë, duhej të ishe i disiplinuar.

Po çfarë detyre ju dhanë në Kinostudio?

Fillimisht më lanë përgjegjës të kinemave dhe shumë shpejt ndihmës operator. Artin e doja shumë, e ndjeja veten shumë mirë mes artistëve. Pata fat që të njihja e siguristë të më mësonte çdo gjë rreth kamerës Hamdi Ferhatin, operatorin e parë shqiptar. Veç tij një ndihmesë të madhe më dha dhe Mandi Koçi.

Kur e përdore kamerën për herë të parë?

Nuk e harroj ende atë moment kur gjatë inaugurimit të argjinaturës së Gjadrit në vitin 1956, Hamdi Ferhati më zgjati kamerën dhe më tha: Filmo! Po fluturoja nga gëzimi. Si asistent operator punova dhe në filmin e parë artistik shqiptar, filmin e Hysen Hakanit "Fëmijët e saj".

Kur kaluar te dokumentarët?

Në vitin 1958 kalova përfundimisht te kronika e dokumentarët.

Ju pëlqente zanati i ri?

Sigurisht shumë. I kam rënë kryq e tërthor Shqipërisë time e nuk kam lënë cep pa filmuar. Po kështu kam qenë prezent në shumë takime ndërkombëtare e kam filmuar dhjetëra personalitete të botës që vizituan Shqipërinë në vitet 50-60 nga Hrushovi te Çu En Lai si dhe shumë udhëtime jashtë shtetit për të bërë dokumentarë nga Kina në Irlandën e Veriut.

Na tregoni ndonjë detaj të udhëheqësit të asaj kohe, Enverit?

Ç'është e vërteta unë isha shumë i shpejtë në xhirim dhe nuk i lodhja udhëheqësit, jo drita, jo prisni pak, ndaj ata më kishin të preferuarin e tyre. Enver Hoxha më shihte me një sy shumë simpatik. Më kujtohet një herë kur kishim ndaluar në "Ujin e ftohtë" në Tepelenë për mëngjes. Ai ishte me Nexhmijen, bashkëshorten e tij. Unë isha duke xhiruar e ai më thirri; Dhimitër eja këtu, ulu ha me ne. Unë mbeta, e i thashë jo, faleminderit shumë, por kam ngrënë. Fati im në atë moment erdhi Shefqet Peçi ato u ngritën për ta takuar e ai u ul me ta, ndërsa unë ika. Por Enveri ishte i vëmendshëm. Ai thirri komandant Prodanin dhe i tha të merrte një letër dhe mbështolli të gjitha çfarë ishin mbi tryezë e m'i solli mua për të ngrënë.

Po me personalitetet e huaja,

Dhimitër Lala, partizani 14-vjeçar me dy partizane dalë në Pallatin e Brigadave, më 17 nëntor 1944

ndonjë detaj nga bisedat "sekrete" të tyre me Enver Hoxhën?

Kur erdhi Hrushovi unë isha i pari që pata kontakt se u ngjita deri te avioni. Kur udhëheqësi sovjetik zbriti shkallët e u takua me Enverin i tha në vesh; Sa të jem unë këtu mos e zër me gojë Titon... Ndërsa po ju tregoj dhe një moment interesant që më ka mbetur në mend. Kur isha në Kinë me Mehmet Shehun, unë si operator hyja 10 minuta para në sallën e takimit e bëja plane, kur dëgjoj Mehmetin që i thotë Çu En Lait: Neve ata që tradhtojnë marksizëm-leninizmin ia japin plumbin ballit... Ndërsa përgjigjja e udhëheqësit kinez më befasoi, ai ia ktheu; Koka nuk është lakër, e kjo nuk është mënyra e duhur. Merrini ata që janë kundra, çojini në një vilë në fshat jepini veprat e Maos dhe Enverit dhe ata të lexojnë, e ndryshojnë mendim.

Në vitin 1971 u transferuat në Televizionin Shqiptar, Pse?

Televizionin donin ta fuqizonin dhe mua, Endri Kekon e Kristaq Dhamon na kaluan për të dhënë përvojën tonë. Kristaqi me Endrin u kthyen ndërsa unë mbeta deri në vitin 1974. Do të kisha vijuar edhe më tej, sikur të mos më vinte lapsi i kuq i partisë, i cili në kuadër të arrestimeve në TVSH gjeti rastin të më shkarkojë nga

➔

Dhimitër Lala duke xhiruar dy udhëheqësit, Mehmet Shehu dhe Mao Ce Dun në Kinë, 1966

puna. Në prill 1975 më hoqën dhe nga partia, ndërsa më 12 tetor 1976 më arrestuan.

Pse ju akuzuan?

Fillimisht bëra 7 muaj hetuesi dhe më dënuan 6 vjet për agjitacion e propagandë, vite, të cilat i bëra të plota.

Po burgu si ishte për ju?

Situata ishte shumë e vështirë. Spaçi ka qenë kampi më i tmerrshëm pasi të burgosurit punonin në minierë 8 orë. Unë s'kisha ndihmë nga familja pasi 6 vjet nuk më erdhi njeri për të më parë e më duhej të punoja e të merrja ndonjë lekë për të blerë ndonjë gjë në dyqan.

Keni takuar ndonjë personalitet në Spaç?

Po kam pasur Maks Velon, Spartak Ngjelën, Fatos Lubonjën... Fatosi ka qenë trim i madh. Nuk pranonte të punonte në minierë e i thoshte; Unë jam i dënuar politik, pse duhet të punoj, ndërsa ata e rrihnin e fusnin në birucë, por ai prap nuk dorëzohej.

Ju jeni shprehur se në burg nuk kishte heronj, por spiunë e provokatorë, në fakt, si ishte situata?

Kur isha në kampin ordiner në Tiranë, shihja ca fytyra të verdha të strukur, e pyeta njërin; Çfarë kanë këta që rrinë kështu? E ai më shpjegoi që ose i dalin dëshmitar në gjyq ndonjërit ose i rekrutojnë për t'i lënë në qeli me të burgosur politikë për t'i spiunuar. Dhe mua më ndodhi. Kur më çuan në Spaç më lanë në birucë me një djalë të ri e unë sa shkova e përshëndeta e po i bëja muhabet kur mu kujtua po ajo fytyrë e verdhë e i thashë vetëm: Kujdes Dhimitër. E pyeta: Për çfarë ke rënë në burg? Ai më tha se e kishin burgosur pse kishte dëgjuar Radio Londrën. Aty e kapa që po gënjente se Radio e Amerikës po që dëgjohej, por Londra jo. Kur më thirrën për të shkuar te hetuesi, unë vesha këpucët dhe pashë dhe pozicionin ku i kishte vënë ai. Kur u ktheva pashë që ato kishin lëvizur, nuk ishin më në të njëjtin vend, pra e kishin thirrur dhe atë.

Je rikthyer ndonjëherë në Spaç?

Po kam shkuar pas viteve '90, me një fotograf për të bërë një ekspozitë.

Me kë bënit shoqëri?

Shoqëria duhej zgjedhur mirë aty, sepse 70 për qind ishin të rekrutuar nga operativët dhe spiunonin. Ne ishim nja 4 vetë nga Tirana që rrinim bashkë.

Po vitet pas burgut si ishin?

Kur u lirova nga burgu punova te uzina Dajti, punëtor ngarkim shkarkimi, 3 vjet prej aty në "Misto Mame" po punëtor ngarkim-shkarkimi deri sa në 1987 dola në pension.

I kërkuat ndihmë Enver hoxhës kur ju burgosën?

Jo, jo, jo...

Po sot si jetoni, jeni afro 87 vjeç?

Jetoj me pensionin tim. Unë marr pension minatori se punova në Spaç e më ka rënë 16 mijë lekë në muaj.

Si është një ditë e juaja?

Po rri në shtëpi me gruan shumicën e kohës. Ndonjëherë dal për kafe me ndonjë shok. Një djalë e kam në Zvicër, ndërsa tjetri më vdiq para tre vjetësh.

Spaçi

KANË THËNË PËR DHIMITËR LALA

YLLI PEPO
Dhimitër Lalën e kam njohur nga afër në vitin 1971, kur së bashku me tre kolegë të shquar erdhën në TVSH, i cili sapo hidhte hapat e parë drejt profesionalizmit. Ai ishte një profesionist. Më shumë se çdo fjalë flasin filmat që ruhen në arkiva e që përbëjnë një thesar të madh për breza të tërë.

ELVIRA DIAMANTI
Falë punës e kontributit të tij të çmuar, në Arkiv kemi pamje të rralla, të cilat kanë vlera të mëdha artistike, historike e dokumentare.

FLORI SLATINA
Dhimitër Lala është artist që ka krijuar vlera në kinematografinë shqiptare, që ka dhënë kontribute të pamohueshme e të çmuara.

ENDRI KEKO
Kam bashkëpunuar me të shumë herë dhe e çmoj për forcën dhe energjinë si askënd tjetër nga operatorët e kinokronikës, ndaj nuk hezitova ditët e para të shkurtit 1966 t'i propozoja të shkonim në një udhëtim të gjatë.

DRITËRO AGOLLI
"Vera sa më e vjetër të jetë, aq më e mirë është". Kjo thënie e lashtë, do të përshtatej edhe për kronikat e dokumentarët kinematografikë dhe televizive të operatorit të talentuar Dhimitër Lala, njërit nga themeluesit e kinematografisë shqiptare.

VLADIMIR MARKO
Dhimitër Lala është një personalitet në artin e magjishëm të kinematografisë dhe padyshim një nga pionierët e parë. Ai ka qenë mësuesi im i parë drejt fotografisë, më ka mësuar kamerën dhe lojën brilante të imazhit e të dritës.

BUJAR KAPEXHIU
Kronikat e filmat dokumentarë janë skeduar në Arkivin Shtetëror si dëshmitarë të një pune të madhe e të palodhur të këtij kineasti të talentuar. Ai meriton të kujtohet, të vlerësohet dhe të falënderohet për kontributin e tij të shquar në kinematografi.

PIRRO MILKANI
Më shumë se kushdo tjetër për Lalën, flasin ato mijëra metra filma kronikalë e dokumentarë që realizoi dora e tij.

MEVLAN SHANAJ
Njohja e gjatë me të më ka ngulitur në mendje se ky njeri është shembulli i pasionit për punën dhe, nëse do të doja të portretizoja një kineast punëtor, nuk do të kërkoja model tjetër.

Dekania e fakultetit: Tubimi i të rinjve i ndikuar politikisht, nuk ka penalizime

Studentët e Shkencave Mjekësore në protestë pas heqjes së sezonit

"Rrezikojmë të mbetemi pa diplomuar"

Studentët e Fakultetit të Shkencave Mjekësore Teknike protestuan dje me pretendimin se u është hequr padrejtësisht sezoni i provimeve të mbartura. Rreth 300 studentë të infermierisë, fizioterapisë, Mami, Teknikë Imazherie, Teknikë Laboratori, Logoped njëzëri kërkuan anulimin e vendimit të pazyrtarizuar të dekanatit dhe senatit të fakultetit dhe rikthimin e sezonit të provimeve në muajin prill, pasi në të kundërt shumicës së studentëve u digjet e drejta e hyrjes në diplomë për shkak të lëndëve të mbartura. Sipas studentëve penalizimi që po u bëhet pa paralajmërim ka kosto të lartë ekonomike, një vit shtyrje të diplomës si dhe 400 mijë lekë pagesë shtesë. "Kemi heshtur për shumë gjëra, por të paktën mos na shtypin e të na heqin mundësinë e diplomimit. I bie që ne të rrimë edhe një vit pa u diplomuar e të paguajmë tarifën e shkollës, e të detyrohemi të largohemi nga auditorët për të gjetur një punë për të paguar shkollën. Protestat do vazhdojnë",-u shpreh i revoltuar një nga studentët.

REAGIMET

Por ndërsa studentët prisnin një lajm të mirë nga dekanati ata janë përplasur me të zgjedhurit e tyre si negociator që pas takimit me dekanen u kanë kërkuar shokëve të shpërndahen me argumentin se bojkoti nuk i ndihmon zgjidhjes. Protestës i është bashkuar edhe deputetja e LSI, Florida Kërpaci që tha se protestonte si studente e Universitetit të Mjekësisë dhe jo nën siglën politike. "Z.Rama bën propagandë, bën show dhe do të na intimidojë me ato fjalimet e tij të gjata, por këtu është realiteti. Dhe realiteti është që ne nuk kemi frikë dhe do jemi deri në fund",-u shpreh deputetja e LSI-së në fjalën e saj. Vetë dekania e fakultetit Tatjana Cina, i ka qëndruar larg protestës, duke deklaruar nga zyra e saj se nuk ishte informuar për tubimin e studentëve për të cilin tha se është i ndikuar politikisht. "Sezon, studentët kanë 4 javë në shkurt, kanë një javë në prill, kanë në qershor. Në qershor është mbrojtja e diplomës për ata që kalojnë dhe kanë përsëri në shtator që hyjnë në provime sa të duan dhe kanë diplomën. Pra, studentët mund të regjistrohen dhe në master, mund të japin provimin e licencës pas shtatorit. Pra, nuk penalizohen në asnjë provim. Kjo është anarki, nuk mund të kërkohen të drejtat e studentëve me protesta. Jemi tërësisht të indinjuar me ardhjen e deputetëve të partive të ndryshme politike që mund t'i përdorin për interesat e tyre",-tha dekania. Pas më shumë se tri orësh protesta është shpërndarë pas lajmit se do të rinisë sërish kur pritet që dekanati të dalë me një vendim zyrtar për çështjen.

REAGIMI

"Kemi heshtur për shumë gjëra, por të paktën mos na shtypin e të na heqin mundësinë e diplomimit. I bie që ne të rrimë edhe një vit pa u diplomuar e të paguajmë tarifën e shkollës, e të detyrohemi të largohemi nga auditorët për të gjetur një punë për të paguar shkollën. Protestat do vazhdojnë".

Kurse anglishteje falas në universitetet publike

Ministrja Nikolla: Bursa studimi për maturantët ekselentë që zgjedhin mësuesinë

Të gjithë maturantët ekselentë që gjatë aplikimit në universitete do të zgjedhin një prej degëve të mësuesisë, do të përfitojnë bursa studimi. Kjo deklaratë është bërë nga ministrja e Arsimit, Sportit e Rinisë, Lindita Nikolla, e cila theksoi se nisma do të merret për të rritur interesin e të rinjve për këto programe. "Do të ndërmarrim të gjitha iniciativat e nevojshme për të mbështetur me bursa studimi ekselentët maturantë që zgjedhin të jenë mësues. Që këtë vit, kriteret për t'u pranuar në universitete për fakultetet e mësuesisë, do të jenë shumë më të forta dhe për sa i takon qeverisë ne po diskutojmë atë që ligji na njeh si detyrim për të parë se sa ne do të rrisim mesataren për të gjithë maturantët që kërkojnë të studiojnë mësuesi", - tha Nikolla në fjalën e saj. Më tej ajo shtoi se niveli pedagogjik aktual i mësuesve nuk është në lartësinë e duhur, e si pasojë po ndiqet kjo praktikë për të tërhequr vëmendjen e ekselentëve. Ky takim kishte në fokus ofrimin e praktikave të punës, si në administratën publike, ashtu edhe në sektorin privat, për të gjithë të rinjtë që përfundojnë studimet e larta e kanë nevojë për aftësim të mëtejshëm.

Ministrja e Arsimit, Sportit e Rinisë, Lindita Nikolla

KURSET FALAS

Ndërkaq, gjatë prezantimit të programit kombëtar të praktikave të punës, ministrja e Arsimit, Lindita Nikolla bëri me dije se të gjithë universitetet publike në vend do të ofrojnë kurse falas të gjuhës angleze. "Ky 6-mujor do të jetë 6-mujori që starton puna e përgatitjes edhe në një aftësi tjetër, që është aftësia e gjuhëve të huaja. Në të gjithë universitetet publike të vendit ne do të mundësojmë kurset e gjuhës angleze falas, jo vetëm për studentët e atij universiteti, por për të gjithë të rinjtë dhe të rejat në ato komunitete ku këto universitete operojnë",-u shpreh ministrja. Kështu, jo vetëm studentët, por edhe të rinjtë e komunitetit në zonën përreth që nuk janë pjesë e universitetit, mund të drejtohen në institucionet e arsimit të lartë e të ndjekin kurse të gjuhës angleze, pa qenë e nevojshme të paguajnë para. Sipas Nikollës, tregu i punës po pëson ndryshime të shumta në një kohë të shkurtër e si pasojë lind domosdoshmëria e përgatitjes sa më të mirë të të rinjve.

Universitetet, për 2 vite, 27 mijë studentë më pak

54 mijë të rinj për juridik e ekonomik

Të rinjtë shqiptarë preferojnë më shumë të studiojnë për ekonomik e juridik, deklaruar kjo nga Instituti i Statistikave. Sipas këtij të fundit, në vitin akademik 2015-2016, që rezultojnë edhe si të dhënat më të fundit, plot 53.760 të rinj, studionin në fakultetin Ekonomik, Juridik apo Shkenca Sociale. Si pasojë këto programe studimi të parapëlqyera nga studentët, janë edhe profilet që kanë konkurrencën më të lartë në tregun e punës në Shqipëri. INSTAT tregon se kërkesat për këto fakultete ngelet dominante, pavarësisht rënies që kanë pësuar nga viti 2013, kur patën arritur kulmin, me afro 68 mijë studentë. Profili i dytë më i kërkuar nga të rinjtë janë shkencat mjekësore, me afërsisht 15% të numrit të përgjithshëm të studentëve dhe ato inxhinierike me rreth 12%. Rënie të theksuar gjatë viteve të fundit ka pësuar

Studentë në arsimin e lartë sipas fushave të studimit
Student enrolled by field of study

Viti shkollor / akademik	2011-12	2012-13	2013-14	2014-15	2015-16
Fushat e studimit					
Shkencat e arsimit	12.797	13.349	15.426	13.654	11.236
Humanitare dhe Artet	9.400	21.219	20.801	17.568	17.095
Shkencat sociale, biznes dhe ligji	51.024	67.623	66.117	52.551	53.760
Shkencat e natyrës	11.585	15.566	15.133	20.033	14.630
Shkencat inxhinierike, përpunim & ndërtim	15.002	17.967	18.391	18.728	18.005
Bujqësia	11.159	9.987	9.039	10.171	8.383
Shëndetë dhe mirqenia	20.522	24.297	25.667	22.780	21.367
Shërbimet	5.147	2.321	3.345	5.022	2.250
Të panjohur	1.827	0	0	0	0
Gjithsej	158.963	172.561	173.819	160.527	140.746

Burimi i informacionit: Te dhenat administrative nga Ministria e Arsimit Sportit dhe Rinise

ndjekja e shkencave arsimore. Në vitin 2011, afro 21 % e studentëve ndiqnin shkollën për t'u bërë mësues; në vitin 2016 këto degë ndiqeshin nga më pak se 8% e totalit të studentëve. Ndërkaq, numri më i vogël i studentëve paraqitet në fushën e degëve që lidhen me shërbimet, ku në vitin akademik 2015-2016 ka pasur vetëm 2250 studentë të regjistruar. Pas kësaj vjen sektori i bujqësisë me 8383 studentë, e fusha e shkencave të arsimit me 11.236 mijë të rinj. Por edhe numri i studentëve të arsimit të lartë ka pësuar rënie, krahasuar me një vit më parë. Respektivisht, në vitin 2013-2014, studionin plot 173.819 të rinj, ndërsa në 2015-2016-ën, universitetet në vend kanë numëruar rreth 27 mijë studentë më pak.

Bajram Krasniqi qëlloi për hakmarrje se prindërit do e fejonin vajzën me një tjetër

Tentoi të vrasë minorenen se i refuzoi dashurinë, kapet 22-vjeçari

I riu i zuri pritë në qendër të fshatit, qëlloi me breshëri automatiku drejt 14-vjeçares

FEJESA

Bajram Krasniqi e ngacmonte prej kohësh bashkëfshatarën e tij, identiteti i të cilës nuk bëhet i ditur. Teksa ishte në pritje të një përgjigjeje pozitive nga minorenia, i riu ka marrë lajmin e 'hidhur', se ajo do të fejohej nga prindërit me një djalë tjetër.

Në inat e sipër, 22-vjeçari ka qëlluar në drejtim të saj me automatik në qendër të fshatit.

Arma që iu sekuestrua 22-vjeçarit

LUSHNJË

Një 22-vjeçar nga Divjaka ka përfunduar në pranga, pasi ka tentuar të vrasë një 14-vjeçare. Bëhet fjalë për të riun Bajram Krasniqi, i cili ka qëlluar me automatik drejt minorenes sapo ajo kishte mbaruar mësimin dhe po kthehej në banesën e saj. Fatmirësisht vajza nuk është lënduar, ndërsa agresori është kapur në flagrancë. Burime zyrtare nga policia e Lushnjës bënë me dije se ngjarja e rëndë ka ndodhur dy ditë më parë në fshatin Babunjë të Divjakës. Mësohet se ngjarja ka marrë shkas pas refuzimit të dashurisë nga ana e 14-vjeçares. Menjëherë pas sinjalizimit për të shtëna me armë zjarri, policia ka shkuar në vendngjarje dhe ka nisur hetimet. Sipas bluve ngjarja ka ndodhur për motive të dobëta dhe se në vendngjarje u gjetën dhe u sekuestruan në cilësinë e provës materiale 3 gëzhoja arme zjarri automatik model 56. Ndërsa, materialet i kaluan për hetime të mëtejshme Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lushnje për veprat penale: "Vrasje në rrethana të tjera cilësuese" e mbetur në tentativë dhe "Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve dhe municionit luftarak". Ndërkaq, "Gazeta Shqiptare" ka mundur të zbardhë detaje të reja në lidhje me këtë ngjarjeje. Mësohet se Bajram Krasniqi e ngacmonte prej kohësh bashkëfshatarën e tij, identiteti i të cilës nuk bëhet i ditur. Ndonëse ishte në pritje të një sinjali dhe një përgjigjeje pozitive nga minorenia, i riu mësohet të ketë marrë lajmin e 'hidhur', pasi prindërit e saj kishin vendosur ta fejonin atë me dikë tjetër. Në inat e sipër, 22-vjeçari, pasi ka siguruar një armë zjarri automatik, ka vendosur të marrë hak ndaj vajzës që dashuronte, pasi kjo e fundit refuzoi dashurinë e tij. Burime policore pohuan se i riu ka pritur që 14-vjeçarja të mbaronte shkollën dhe i ka zënë pritë në qendër të fshatit. Sapo e ka parë vajzën, Krasniqi ka qëlluar disa herë në drejtim të saj, por fatmirësisht plumbat nuk e kapën minorenen dhe asnjë banorë tjetër përreth. Tashmë pritet që Gjykata e Shkallës së Parë e Lushnjës të vendosë masën e sigurisë ndaj 22-vjeçarit.

Ngjarja, autori i dyshuar kosovari Ruzhdi Buzhala

Vrasja e dy motrave në Zvicër, familja Frroku në Lezhë hap dyert e mortit

I arrestuari, Ruzhdi Buzhala

Viktimat, Alma dhe Elda Frroku

LEZHË - Vrasja makabre e dy motrave nga Ishulli i Lezhës në Zvicër ka tronditur mbarë opinionin publik. Pas lajmit të kobshëm, familja Frroku ka hapur dyert e mortit, kurse disa pjesëtarë të kësaj familje kanë shkuar në Zvicër për të tërhequr trupat e pajetë. Familja e dy motrave, Alma dhe Elda Frroku në lagjen "Xhenjo" të Lezhës, që u vranë në Zvicër është në zi. Ndërkaq, mësohet se vëllai dhe disa pjesëtarë të familjes Frroku kanë shkuar në Zvicër për të tërhequr kufomat. Familjarët e viktimave nuk janë në dijeni të ndonjë konflikti që mund të ketë çuar në vrasjen e dy vajzave të tyre, përkatësisht 38 dhe 31 vjeçe. Ngjarja e rëndë ka shokuar banorët e Lezhës, të cilët u shprehën se familja Frroku është e mirë. Ndërkaq, fqinjë të kësaj familje u shprehën se ende nuk e besojnë atë që ka ndodhur. "E njoh prej vitesh familjen Frroku. Është familje e mirë dhe asnjëherë nuk kanë pasur probleme. Për vajzat flasin mirë, por rreziku vjen atëherë kur nuk e pret. U tronditëm kur dëgjuam lajmin për vrasjen e dy vajzave",-tha njëri prej tyre. Për familjarët e motrave Alma dhe Elda Frroku mbetet akoma më enigmatike fakti se dhëndri vrasës ka qëlluar për vdekje edhe kunatën, e cila ishte mysafire në shtëpinë e tyre. Asnjë prej familjarëve Frroku nuk pranon të japë ndonjë koment për krimin, por presin që drejtësia zvicerane të zbardhë këtë ngjarje tragjike për ta. Dy motrat u vranë në apartament në rrethana ende të paqarta. Ato u goditën me thikë nga bashkëshorti i 38-vjeçares Alma Frroku. Bëhet fjalë për 54-vjeçarin Ruzhdi Buzhala nga Kosova, i cili është arrestuar nga policia zvicerane. Çifti jetonte prej gati 20 vjetësh në Zvicër dhe nga martesa e tyre kishin 3 fëmijë. Ngjarja ndodhi në Hausen të Kantonit Aargau. Motra e Almës, kishte shkuar nga Franca në Zvicër për të kaluar festat e fundvitit, por gjeti vdekjen e dhunshme.

13-vjeçarja denoncon bashkëjetuesin për dhunë, policia lëshon urdhër-mbrojtje

LEZHË - Policia e Lezhës ka lëshuar urdhër-mbrojtje për një 13-vjeçare, e cila ka denoncuar bashkëjetuesin e saj 24-vjeçar për dhunë psikologjike. Në njoftimin zyrtar të policisë bëhet e të ditur se "me datë 09.10.2018 është plotësuar kërkesë padia për lëshimin e urdhrit të mbrojtjes të menjëhershëm për shtetasen A.G., banuese në Lezhë, pasi dyshohet se bashkëjetuesi E.G., vjeç 24, banues në Lezhë, ka ushtruar dhunë psikologjike ndaj saj". Të kontaktuar nga 'News24' në lidhje me këtë rast, policia e Lezhës bëri me dije se 24-vjeçari nuk është arrestuar, ndonëse marrëdhënia me të mitur dënohet me ligj. Ndërkaq, mësohet se e mitura ka deklaruar në polici se është e dashuruar me 24-vjeçarin dhe se ka bashkëjetuar me vullnetin e saj. Por e çuditshmja në këtë histori qëndron në faktin që sipas nenit 100, marrëdhënia seksuale ose homoseksuale me fëmijë të mitur, që nuk kanë arritur moshën katërmbëdhjetë vjeç ose me të miturën që nuk ka arritur pjekurinë seksuale, dënohet me burgim nga shtatë deri në pesëmbëdhjetë vjet, ndërsa rasti në fjalë është referuar si "masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare".

SHKURT

Vdes në burg i dënuari me 17 vjet heqje lirie për vrasje

KRUJË - Një 59-vjeçar ka humbur jetën në burgun e Krujës. Sipas policisë ngjarja ka ndodhur dy ditë më parë në reanimacionin e spitalit të burgut, ku ka ndërruar jetë shtetasi Fatmir Tomini.Mësohet se 59-vjeçari nga Tirana ishte i dënuar me 17 vite burg, për vrasje dhe vuante dënimin në burgun e Krujës. Mendohet se shkak i vdekjes së Tominit ka qenë gjendja shëndetësore e tij, pasi ai ka qenë i sëmurë me tumor. Megjithatë policia po punon për zbardhjen e plotë të ngjarjes. Materialet u referuan në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Tiranë, për vlerësim.

Prangoset i kërkuari për shfrytëzim prostitucioni

LEZHË - Danjel (Artan) Lleshi nga Kurbini është arrestuar nga policia e Lezhës, pasi ishte shpallur në kërkim ndërkombëtar nga Interpol Roma. Mësohet se autoritetet Gjyqësore Italiane kanë lëshuar ndaj 42-vjeçarit urdhër arrest për kryerjen e veprave penale: "Shfrytëzim prostitucioni", "Migracion i paligjshëm" dhe "Vjedhje". Materialet ndaj Lleshit i kaluan Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Kurbin për veprime të mëtejshme, ndërsa pritet ekstradimi i tij drejt vendit fqinj. Gjatë vitit që shkoi, blutë e Lezhës kanë arrestuar disa persona të shpallur në kërkim.

Vendosi eksploziv në fabrikën e mishit, arrestohet 52-vjeçari

KRUJË - Policia e Krujës ka zbardhur dhe dokumentuar një ngjarje të ndodhur më datë 11.11.2017, ku një 52-vjeçar ka tentuar të shkatërrojë me eksploziv një biznes. Dje blutë kanë vënë në pranga autorin e dyshuar të kësaj ngjarjeje, Ymer Hidrin. Sipas bluve, ky shtetas u kap pasi në nëntor të vitit që shkoi, në fshatin Qerekë të Krujës ka vendosur eksploziv në fabrikën e thertores së mishit në pronësi të shtetasit P.N. Mësohet se lënda plasëse nuk ka shpërthyer, ndërsa ngjarja ka marrë shkas për motive pronësie. Materialet i kaluan Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Krujë për veprime të mëtejshme për veprat penale" Shkatërrimi i pronës me eksploziv", e mbetur në tentativë dhe "Mbajta pa leje e lëndëve plasëse".

PËRVJETORI

VITI MBARËKOMBËTAR I GJERGJ KASTRIOTIT SKËNDERBEUT

I paarritshëm, i papërkufizueshëm dhe i pashfaqshëm sa ishte gjallë, Gjergj Kastrioti Skënderbeu, luftëtari, shtetari dhe arbërori urëlidhës mes dritëhijes mesjetare dhe humanizmit të ndriçuar europian, u tjetërsua 550 vjet më parë, prej një trupi vdektar, në një *imago mundi* të përveçëm, në një ikonë gjithëpërfshirëse gjalluese të arteve, mjeshtërive dhe urtësive, në një Yll të shëndritshëm mëngjesi diktues të drejtimit të duhur të ardhmërisë së Shqiptarëve.

Të bashkuar me të gjithë shqiptarët në Diasporë.

Z. Edi Rama
Kryeministër i Shqipërisë

dhe Komisioni shtetëror për organizimin e veprimtarive në kuadër të Vitit Mbarëkombëtar të Gjergj Kastriotit-Skënderbeut

kanë kënaqësinë e veçantë t'Ju ftojnë të merrni pjesë në çeljen e kremtimeve "Tre ditët e Yllit të Mëngjesit", me rastin e 550-vjetorit të kalimit në ameshim të Heroit Kombëtar, Gjergj Kastriotit Skënderbeut

Ditën e martë 16 janar 2018 dhe Ora 17.45 Në hollin e Pallatit të Kongreseve Ora 19.30 Në Pallatin e Brigadave

Pajisuni me ftesën dhe një kartë identiteti në hyrje
Konfirmoni pjesmarrjen tuaj pranë Protokollit të Kryeministrit protocolloffice@kryeministria.al or tel deri më 14 janar 2018
Kodi i veshjes: kostum i errët, veshje kombëtare, tailleur për Zonjat

Ftesa e shpërndarë nga Kryeministria


VITI MBARËKOMBËTAR I GJERGJ KASTRIOTIT-SKËNDERBEUT

Nuk duhen presiet pas europian (rr. 3)
më parë (rr. 4)
vdektar (rr. 4)

I paarritshëm, i papërkufizueshëm dhe i pashfaqshëm sa ishte gjallë, Gjergj Kastrioti-Skënderbeu, luftëtari, shtetari dhe arbërori urëlidhës mes dritëhijes mesjetare dhe humanizmit të ndriçuar europian, u tjetërsua 550 vjet më parë, prej një trupi vdektar, në një *imago mundi* të përveçëm, në një ikonë gjithëpërfshirëse gjalluese të arteve, mjeshtërive dhe urtësive, në një Yll të shëndritshëm mëngjesi diktues të drejtimit të duhur të ardhmërisë së Shqiptarëve.

vdekatar
te urtë
shndritshëm

Të bashkuar me të gjithë shqiptarët në Diasporë.

Gjergj Kastriotit-Skënderbeut

Shtetëror

Z. Edi Rama
Kryeministër i Shqipërisë

dhe Komisioni shtetëror për organizimin e veprimtarive në kuadër të Vitit Mbarëkombëtar të Gjergj Kastriotit-Skënderbeut

kanë kënaqësinë e veçantë t'Ju ftojnë të merrni pjesë në çeljen e kremtimeve
"Tre ditët e Yllit të Mëngjesit", me rastin e 550-vjetorit të kalimit
në ameshim të Heroit Kombëtar, Gjergj Kastriotit-Skënderbeut

*Tri...
am shim

me

Ditën e martë 16 janar 2018 dhe Ora 17.45 Në hollin e Pallatit të Kongreseve Ora 19.30 Në Pallatin e Brigadave

Pajisuni me ftesën dhe një kartë identiteti në hyrje
duhet pikë pjesëmarrjen
nr. tel.
Kodi i veshjes: kostum i errët, veshje kombëtare, tailleur për Zonjat

Ftesa e analizuar nga një gjuhëtar

FTESA PËR VITIN SKËNDERBEUT, ME GABIME

Gjuhëtari kryqëzon Ramën: Vaj hallit kur kryeministri nuk ka korrektor

Fatmira Nikolli

"Ka epitete jologjike, duhej konsultuar edhe me një historian"

Plasin kritikat për tekstin e ftesës, nga gabimet drejtshkrimore te formulimi

Shpërndarja masive e ftesës që kryeministri Edi Rama u ka dërguar dje disa personazheve të jetës publike për të marrë pjesë në çeljen e kremtimeve për Vitin e Skënderbeut, ka nxjerrë në pah edhe gabimet e saj. Pos përsëritjes së emrit të heroit katër herë, teksti i ftesës ka marrë kritika të ashpra për formulimin si edhe për gabimet e shumta drejtshkrimore të gjuhës shqipe. Nga shkronja 'ë' e vënë pa vend si tek fjala 'ameshim', te mbiemri i shndritshëm që është shkruar i "shëndrritshëm".

Keqardhjes për një dokument që del Kryeministria me gabime të tilla i shtohet edhe keqardhja për një ngjarje që ka përmasa të mëdha, për aq sa është shpallur vit festiv, duke u bërë edhe vendimi i parë i qeverisë "Rama 2".

Nga sa mësohet paraprakisht, do të ketë ekspozitë me piktura te Pallati i Kongreseve si dhe ekspozitë objektesh mesjetare pothuaj të njëkohshme me Skënderbeun. Janari ka qenë muaj i ngarkuar për institucionet e kulturës të përfshira në festime.

Kryeministri Edi Rama



FTESA

Po sjellim më poshtë tekstin e ftesës që kryeministri Edi Rama ka shpërndarë dje, ose që është shpërndarë në emër të tij dhe në emër të Komisionit Shtetëror.

LOGOJA- Viti Mbarëkombëtar i Gjergj Kastriotit Skënderbeut

I paarritshëm, i papërkufizueshëm dhe i pashfaqshëm sa ishte i gjallë, Gjergj Kastrioti Skënderbeu, luftëtari, shtetari dhe arbërori urëlidhës mes dritëhijes mesjetare dhe humanizmit të ndriçuar europian, u tjetërsua 550 vjet më parë, prej një trupi vdektar, në një *imago mundi* të përveçëm, në një ikonë gjithëpërfshirëse gjalluese të arteve, mjeshtërive dhe urtësive, në një Yll të shëndrritshëm mëngjesi diktues të drejtimit të duhur të ardhmërisë së Shqiptarëve.

Të bashkuar me të gjithë shqiptarët në Diasporë.

Z.Edi Rama

Kryeministër i Shqipërisë
dhe Komisioni Shtetëror për organizimin e veprimtarive në kuadër të Vitit Mbarëkombëtar të Gjergj Kastriotit Skënderbeut
Kanë kënaqësinë e veçantë t'Ju ftojnë të merrni pjesë në çeljen e kremtimeve "Tre ditët e Yllit të Mëngjesit", me rastin e 550-vjetorit të kalimit në ameshim të Heroit Kombëtar, Gjergj Kastriotit Skënderbeut
(Pajisuni me ftesën dhe një kartë identiteti në hyrje
Konfirmoni pjesmarrjen tuaj pranë Protokollit të Kryeministrit
Kodi i veshjes: kostum i errët, veshje kombëtare, tailleur për Zonjat)
Ditën e martë, 16 janar 2018 në orën 17:45 Në hollin e Pallatit të Kongreseve dhe ora 19:30 në Pallatin e Brigadave

ANALIZA E GJUHËTARIT

"Gazeta Shqiptare" i është drejtuar një gjuhëtari në zë, pedagog për vite të tëra pranë Fakultetit të Historisë dhe Filologjisë derisa ka dalë në pension. Profesori, mjaft aktiv në jetën publike, nuk ka dashur të dalë me emër, por ka pranuar të analizojë ftesën për të nxjerrë në pah gabimet, duke cituar herë-herë edhe rregullat e Drejtshkrimit të vitit 1972.

"Vërtet ka shumë gabime. Fjalët e shkruara gabim i kam shkruar si duhet me blu; presjet, pikat e vizat i kam shënuar në krye e në fund të ftesës ose dhe në tekst.

Ka epitete jologjike: i papërkufizueshëm dhe i pashfaqshëm (?!).

Ka karakterizime jo të duhura: në një ikonë gjalluese të arteve, mjeshtërive dhe urtësive.

Ne Skënderbeun e ndërojmë jo se u kthye në një ikonë a burim frymëzimi për artet etj., po se vepra dhe emri i tij i shërbyen bashkimit të shqiptarëve, duke shërbyer si tharm për formimin e kombit shqiptar", - tha dje një autoritet i gjuhës shqipe në kushtet e anonimatit.

Në vijim, ai shënon "është edhe kjo: të bashkuar me të gjithë shqiptarët në diasporë (po trojet etnike: Mali i Zi, Maqedoni, Greqi?)".

Sipas tij, ky tekst duhej konsultuar me një historian dhe pastaj duhej korrektuar. "Unë besoj se, po ta kishte shkruar me dorën e tij Edi, nuk do të kishte bërë kaq gabime. Vaj halli kur edhe në Kryeministri nuk ka një korrektor për të qenë!"

NGA KRITIKA NË BATUTË

Një shkrimtare nuk e kurseu ironinë. "Thua të dijë gjë kryeministri se ç'flitet 'shqip' në emër të tij? Mirë shkallëzimet e mbiemrave dhe miksimet kuptimore të mbivendosur panatyrshëm, por kjo fjala 'ameshim' e shkruajtur me 'ë'! O Skënderbeu ynë 'i pashfaqshëm'. 'Imago mundi të përveçëm'! Kush mund ta ketë formuluar, vallë? Qesh se nuk qaj dot", shkruante ajo.

Një studiues, thotë se fjala i "pashfaqshëm" nuk ka kuptim në këtë ftesë. "Pikërisht se ishte i shfaqshëm Gjergj Kastrioti-Skënderbeu i bëri ballë për 25 vjet fuqisë më të madhe ushtarake të botës në atë kohë". E gjen pa vend edhe fjalën "u tjetërsua", ashtu si edhe frazën "trupi vdekatar". Në fund, vëren: "gjithëpërfshirëse gjalluese" - ky togfjalësh të bën të të vijë keq, shumë keq për gjuhën shqipe, me iu dhimbtë gurit e drunit, i shkreti Dhaskal Todri...".

Sherret e largimet në 'Vetëvendosje', në 21 janar votohet brenda partisë

Përfundon afati, Albin Kurti i vetëm për kryetar

"Kosova do të ketë Kushtetutë të re, që mundëson bashkimin kombëtar"

Albin Kurti është zgjedhur kryetar i Lëvizjes 'Vetëvendosje', në takimin e parë të Këshillit të Përgjithshëm të subjektit opozitar të Kosovës. Menjëherë pas zgjedhjes si kryetar, Albin Kurti ka premtuar se ky subjekt do të bëjë që Kosova të bëhet me Kushtetutë të re, e cila do të mundësonte edhe bashkimin kombëtar. Mbledhja pritet të përfundojë me zgjedhjen edhe të nënkryetarëve të 'Vetëvendosjes'. Ish-lideri i 'Vetëvendosjes', Albin Kurti si duket nuk do të këtë përballë asnjë kundër kandidat për të ardhur përsëri në pozitën e kreut të kësaj partie, në kuadër të një procesi parazgjedhor të përcjellë me shumë polemika, kundërshtime e largime nga partia. Afati i paraqitjes së kandidaturave përfundoi në mesnatë, ndërsa nuk ka asnjë raportim për ndonjë kandidaturë tjetër që do ta rivalizonte Kurtin në këtë garë. Kurti, i cili është themelues i VV-së dhe ishte në krye të saj për dy mandate, në zgjedhjet e brendshme pritet të marrë për të tretën herë këtë post pas një 'pauze' trevjeçare, kur kryesimi i partisë iu dha Visar Ymerit, i dorëhequr nga ky post ditë më parë. Në dhjetor të vitit të kaluar, derisa Kurti gjendej në paraburgim, autorizoi deputetet Albulena Haxhiu dhe Fitore Pacolli që të mbledhin nënshkrimet për ta paraqitur kandidaturën e tij. Përveç Ymerit dhe aktivistëve të ndryshëm, dorëheqje të parevokueshme nga të gjitha funksionet në VV kanë dhënë deputetët: Aida Dërguti, Dardan Sejdiu, Faton Topalli, Shqipe Pantina dhe Driton Çaushi për shkak të pakënaqësive të brendshme me të cilat po përballet VV tash e disa javë. Po ashtu, dorëheqje ka dhënë edhe kryetari i komunës së Kamenicës, Qëndron Kastrati. Ndërkohë Adnan Rrustemi nga Lëvizja 'Vetëvendosje' ka treguar se votimi për zgjedhjen e kryetarit të partisë do të mbahet më 21 janar. Votimi do të bëhet sipas parimit një anëtar një votë dhe nga sot fushata për zgjedhjet e brendshme të VV-së është e hapur.

> Menjëherë pas zgjedhjes si kryetar, Albin Kurti ka premtuar se ky subjekt do të bëjë që Kosova të bëhet me Kushtetutë të re, e cila do të mundësonte edhe bashkimin kombëtar.

Lëvizja BESA nuk ka dorëzuar padi në Gjykatën Administrative

Dega e Shkupit: Kemi marrë avokatë për çështjen

Pavarësisht parala jmërimit, përfaqësues të Lëvizjes "Besa" edhe sot nuk kanë dorëzuar padi në Gjykatën Administrative lidhur me faktin se kush ka të drejtë në këtë lëvizje, pas shkarkimit të kryetarit Bilall Kasami nga këshilli qendror. Dega e Shkupit e Lëvizjes "Besa" njoftoi se kanë angazhuar avokatë për përgatitjen e lëndës. Ata shprehen optimistë se vendimi i Administratives do të jetë në favor ushtruesit të detyrës kryetar, Nexhbedin Kahremani. Deputeti Fadil Zendeli deklaroi se grupi parlamentar i "Besës" funksionon i bashkuar. "Mund vetëm të deklaroj se grupi parlamentar i Lëvizjes 'Besa' do të funksionojë unik, ashtu edhe siç ka vepruar deri më tani konform programit, statutit dhe politikave që i kemi ndjekur deri më tani, ndërsa çështjet dhe debatet që janë duke u zhvilluar brenda saj duhet të trajtohen brenda organeve përkatëse dhe në asnjë mënyrë nuk do të lejojmë që grupi parlamentar të involvohet në çështje të tyre. Ne do të vazhdojmë si unik dhe nuk ka asnjëfarë ndryshimi në këtë drejtim", - deklaroi Fadil Zendeli. Mbështetësit e ushtruesit të detyrës kryetar, Kahremanit thonë të kundërtën. Sipas tyre, grupi parlamentar i Besës nuk mund të funksionojë si unik derisa për shkarkimin e Kasamit kanë votuar të ndarë. Kongresi i Lëvizjes "Besa" është caktuar për më 24 shkurt.

> "Mund vetëm të deklaroj se grupi parlamentar i Lëvizjes 'Besa' do të funksionojë unik, ashtu edhe siç ka vepruar deri më tani konform programit, statutit dhe politikave që i kemi ndjekur deri më tani..."

Ndalohet anija me eksploziv në Greqi, një shqiptar mes të arrestuarve

Roja bregdetare greke konfiskoi një sasi eksplozivi në anijen e nisur nga Turqia drejt Omanit dhe që u ndalua ditë më parë në Kretë. Ndërkaq, konfirmohet çmontimi i një "bombe artizanale". 29 arkat e gjetura përmbanin detonatorë dhe material shpërthyes, duke përfshirë nitratin e amoniakut, që mund të përdoret për prodhimin e bombave. Mes marinarëve të arrestuar është një shqiptar.

ANULIMI

Gruevski dhe Boshkovski, shtyhet vendimi për azil në Greqi

Është anuluar në Selanik seanca ku duhej të vendoset lidhur me kërkesën e Goran Gruevskit dhe Nikola Boshkovskit që të marrin azil politik në Greqi. Shkak për këtë ka qenë se nuk kanë pasur përkthyes zyrtar në gjuhën maqedonase. Anulimi është bërë në kohë të papërcaktuar. Komisioni i Ministrisë së Brendshme greke është dashur ta dëgjojë dyshen e DSK-së, lidhur me kërkesën për azil në Greqi. Gjykata e Selanikut javën e kaluar vendosi që të dy të ekstradohen në vend, pasi u kapën me pasaporta të falsifikuara bullgare në përpjekje për t'u arratisur në Hungari. Ata për këtë vepër në Greqi do të gjykohen në muajin maj.

Opinioni i Ditës

Barazia gjinore dhe "paketa sociale" në funksion të saj

Nga Rovena Hoxha

(vijon nga faqja 1)

... femërore me shoqata e fondacione të pafundme që mbas viteve 90-të e në vazhdim në realitetin shqiptar.

Por, a i vijnë në ndihmë realisht qenies delikate njerëzore ato, gruas, njeriut që sakrifikon gjatë gjithë jetës duke kontribuar për të gjithë?

Në media madje, midis shumë "megalomanive të bujshme" për të ndihmuar ato, gratë, kohët e fundit flitet shpesh edhe për një paketë sociale, e cila aplikohet në disa vende të BE, ku ka shtet të mirëfilltë demokratik e standarde të jetës europiane si për meshkujt, ashtu edhe për femrat njëlloj. Ku, sipas të cilës pushteti vendor me një formë të moderuar të civilizimit familjar mbështet një çift të lidhur, i cili kërkon të ndërtojë familje duke u mbështetur mbi aftësitë dhe të ardhurat e ndërtuara në mënyrë të barabartë prej tyre, pa trashëguar ende asgjë nga nëna apo baballarët e vet. Kjo paketë sociale ofrohet nga pushteti vendor për t'i shërbyer si bazë ndihme jetese këtij çifti, i cili sapo nis jetën e vet. Pra, e thënë shkurt, vajza dhe djali duhet të lodhen për të mësuar, për t'u kualifikuar, për të punuar e siguruar të ardhmen e vet me forcat e tyre, por duke kontribuar në mënyrë të barabartë si mashkulli, ashtu edhe femra. E, kjo është formë e lartë e të shprehurit e barazisë gjinore mes çiftit, dhe askush nuk mendoj, se vendi ynë mund të realizojë një model të tillë të barazisë gjinore.

Por, të paktën, të respektohet ajo nga vetë këto gra, që janë në krye të qindra shoqatave të vetë grave, të ndihmojnë ato vetë konkretisht vajzat e gratë, të arsimojnë ato vetë sa më shumë vajza e gra në nevojë, të strehojnë ato vetë me stafin dhe me kapacitete e tyre kryesisht gra, të kthejnë në udhë të drejtë për të vazhduar jetën normalisht, ato që janë abuzuar nga prindërit, nga familja, nga bashkëshortët apo dhe nga tutorët e ndryshëm abuzive; nga eprorët e tyre, nga të afërmit e tyre, nga fëmijët e tyre, nga punëdhënësit e tyre, nga shteti dhe pse jo edhe nga feja.

Po, po nga feja! Si, do thoni ju? Në Shqipëri pas viteve 90-të njerëzit kanë vërshuar nëpër kisha e xhamia, gjë që u është ndaluar në regjimin e E.Hoxhës me ndërtimin e të ashtuquajturit "njeriu ri i realizmit socialist". Dhe kjo solli disi një ekuilibër social, siç ndodh kudo në botë. Por kush i menaxhon mbarëvajtjen e tyre, d.m.th. objektivat, ligjërat dhe kurrikulat e tyre? A keni vënë re para xhamive sa shumë njerëz shkojnë e falen, me mjekër ose jo, me shamia e tek tuk pa shami?!E këto të fundit presin të mbarojë lutja, e të dali ai-bashkëshorti, i fejuari, apo burri besimtar...Dhe si fillim, ato besojnë se ai nuk u kërkon të mbulohen me shami. Por, pas disa javësh, pak e nga pak "ai" lë mjekër, e pak nga pak rëndohet, mbyllet në vetvete me kuran në dorë, dhe nuk t'i hedh më sytë me respekt, derisa të kesh mbuluar kokën me shami...Ato besojnë, se askush nuk i detyron të mbajnë shami, por ata(meshkujt e tyre) nuk besojnë me tek ato dhe nuk i respektojnë më si dikur, sepse ato duhet të mbajnë shami. Me zë ose jo, kjo është dhunë, mbase dhunë verbale, dhe gratë duhet te bëjnë si i thonë ata...Kjo është barazia gjinore?! E për çfarë "pakete sociale" mund të flitet në Tiranën tonë? Ironike, e dhimbshme, e lënë në mëshirë të fatit dhe kjo "barazi gjinore".

Shoqëria njerëzore përgjatë historisë ka pasur prirjen që të shtypë të dobëtit, të frustrojë të marginalizuarit dhe të shfrytëzojë qeniet e brishta, siç janë dhe gratë, duke u mohuar dinjitetin e merituar. Në këtë kontekst shpesh ato, dekada më parë janë konsideruar si shërbëtore, si urdhër zbatuese apo si objekte-mjete të rëndomta te jetës, të cilat janë pronë e bashkëshortit të tyre. Kjo tashmë nuk mund të besohet dot, por raste ka boll në realitetin shqiptar, veçanërisht rural; pse jo dhe në zemër të Tiranës.

Barazia gjinore në vendin tonë gjen zbatim vetëm për detyrimet që kanë gratë, dhe aspak për të drejtat e tyre. Si p.sh. kur gratë dalin në pension, po aq sa burrat duhet të arrijnë moshën 67 vjeç. Duhet harruar këtu, sa patriarkale është familja shqiptare, ku gruaja punon e kontribuon në të për çdo gjë nga mëngjesi e gjer vonë në mbrëmje, kur pushon e rraskapitur ato pak orë gjumë. Gruaja shqiptare në familje punon pa pushim çdo punë, dhe këtë e bën pa asnjë shpërblim, veç kënaqësisë mëmësore. Dhe, akoma ka raste rëndom ku burri ha, pi e madje mban këmbët lart mbi tavolinë...e ndërsa ajo punon....Edhe kjo është "barazia" jone gjinore?!

Psikologjia detajon qartë se, personin me të cilin jeton mund ta njohësh shumë mirë, nëse ke një debat, një hall, a një konflikt familjar, të cilin ai duhet minimalisht të të mbështesë. Por, jo, sjellja e tij lexohet qartë dhunshëm, sidomos kur ai ndjehet i pazoti, dhe kur nuk ka të drejtë reagon duke bërtitur, sharë, përçmuar apo rënë me grusht tavolinës...

Dhe kjo marrëdhënie evoluon keq e me keq në kohë, sa më shumë modele të tillë të ketë jetuar ky mashkull nga origjina e vet familjare dhe shoqërore gjate rritjes.

BalkanWeb.com
AGJENCIA E LAJMEVE MË E KLIKUAR NË HAPËSIRËN SHQIPTARE.
LAJMET MË TË FUNDIT ME VIDEO DHE FOTO NGA VENDNGJARJA,
ANALIZA DHE TEMATIKA TË NDRYSHME, GJITHÇKA ME NJË KLIKIM.
MERRNI NE KOHE REALE
LAJMET E FUNDIT NE
APARATIN TUAJ
INSTALONI APLIKACIONIN E BALKANWEB NE
MOBILE DHE TABLET
KERKONI NE APPLE STORE DHE GOOGLE PLAY OSE
DUKE SKANUAR QR CODE APPLE DHE ANDROID

Opinioni i Ditës

Tregu i kapitalit politik dhe bursa e tulipanëve holandezë

Nga Valbona Mezini

(vijon nga faqja 1)

... u vu re, për trend do të njihte nevojën e pakushtëzuar për globalizëm. E ndërsa bota që nga ajo kohë vijon të bëhet edhe më globale, i tillë është kthyer edhe koncepti i të bërit politikë, biznes dhe para në Shqipëri. Tregu politik gjithmonë e më shumë po i ngjan atij ekonomik dhe pazgjidhshmërisht po lidhet me këtë të fundit me fije sa të ndershme aq edhe imorale, sa meritokrate aq edhe klienteliste, sa vizionare aq edhe mediokre. Pra, bursa politike me gjithë oshilacionet marramendëse të lëkundjeve në situatat e paqëndrueshme politike, kërkon rregulla dhe masa të forta për të garantuar stabilitet dhe efiçence rezultatesh, në të kundërt pasojat mund të ngjasojnë me bursën e tulipanëve, ku edhe siç në historinë ekonomike të bursave u kuptua, se të investosh në aksionet e tulipanëve rezultoi diçka e përkohshme dhe pa kurrfarë vlere në periudha afatgjata.

Do thoni ju çfarë lidhje ka kjo me Partinë Demokratike dhe tregun politik në Shqipëri. Duke iu referuar një shprehje sa të vjetër, aq edhe koherente angleze, "What comes around goes around", çfarë vjen vërdallë shkon vërdallë, nuk është aspak çudi se çfarë ka ndodh deri më tani brenda forcës sonë politike, do të na impaktojë pashmangshmërisht në të ardhmen.

Bursa politike sikurse ajo ekonomike nuk njeh mëshirë. Por me një ndryshim fondamental. E ndërsa ajo ekonomike çmon vlerën e asetit, ajo politike vlerën e aseteve nuk e njeh. Me kalimin e kohës aksionet e investuara nga çdo demokrat rriten ose ulen, përmirësohenc, ose përkeqësohen sipas oreksit të "pronarit".

A është e drejtë që një vlerësim i tillë të mos varet nga dëshira e gjithsecilit për të dhënë, bashkëpunuar dhe për t'u vlerësuar, por nga konjukturat e interesave momentale, të cilat jo rrallëherë ndrydhin dhe vrasin të vërtetat absolute.

E vërteta nuk është relative, ajo është një dhe e vetme, monopolin e së cilës nuk e posedon askush si trofe, por edhe ajo shkëlqen si drita e diellit nga rezultatet e një aksioni apo vizioni të munguar.

Investitorët e ndershëm të bursave politike duhet të luftojnë fort që entitet politike partitë, që organizohen mbi baza vullnetarizmi, të mos privatizohen sepse në të kundërt kjo do të ishte fundi i një demokracie të shëndetshme dhe fillimi i një fryme totalitare nga e cila Shqipëria jo pak humbi dhe u dëmtua për 5 dekada si në aspektin ekonomik, ashtu edhe atë social.

Partitë duan t'i kthejnë gjithmonë e më shumë si kompani në

pronësi të interesave familjare që ushqehen nga klane klienteliste, të cilat sapo vijnë në pushtet, shpërdorojnë resurset publike dhe pasurojnë oligarkitë. Në opozitë prirja është që partitë të funksionojnë si shoqëri jo fitimprurëse që iu shmangen taksave në pazare politike, të cilat gjatë kohës në opozitë i paguan anëtarësia, ndërsa gjatë kohës në pushtet i paguan haraçet populli. Sa më pak i informuar populli, i cili gjithaherët është i painformuar drejtë mbi çfarë ndodh brenda entiteteve, të cilat qëllimisht duan të operojnë të mbyllura, që në fakt do të duhej të ishin krejtësisht të hapura në vendimmarrjet e tyre, aq më shumë qeverisjet u shmangen përgjegjësive dhe korrupsioni lulëzon në vend të demokracisë.

Larg platformave të vërteta dhe aksioneve opozitare të mirat uara me vendimmarrje të organeve të larta të partisë, sot forca më e madhe opozitare rrezikon gjithmonë e tepër të katandiset anemike. Kjom pasi sot ka një lidership që të ngjason me një agjent të bursës së tulipanëve të pas Luftës së Dytë Botërore, ku mbi supe ka ndërmarrë risqe të një vendimmarrje absolute individuale, larg gjithëpërfshirjes dhe kohezionalitet, duke dëshmuar se kjo është pjesë normale e të bërit tregti, por jo parti.

Njësoj siç një agjent burse që investon në kohë të lirë me gjakftohtësi dhe sillet si një kalkulator racional, pa iu dashur frymë dhe moral, që një entitet politik opozitar do të duhej të kishte si domosdoshmëri ekzistencialiste, përballë katrahurës social-ekonomike, klientela e tij (agjentit të bursës së tulipanëve) dëshmon dita-ditës se është afruar të bëjnë të ardhura ekstra, pasi asgjë të re nuk paraqesin në aksionet e opozitarizmit parlamentar.

> Bursa politike sikurse ajo ekonomike nuk njeh mëshirë. Por me një ndryshim fondamental. E ndërsa ajo ekonomike çmon vlerën e asetit, ajo politike vlerën e aseteve nuk e njeh. Me kalimin e kohës aksionet e investuara nga çdo demokrat rriten ose ulen, përmirësohenc, ose përkeqësohen sipas oreksit të "pronarit".

Asnjë prej tyre nuk di të thotë sot se përballë një qeverisjeje antishqiptare dhe të dështuar, që çdo vit rënkon Shqipërinë si vendin ku më lirë të leverdis të vdesësh se të jetosh, ka një objektiv dhe strategji që me çdo kusht do t'i shkohet deri në fund për ta hedhur tek mbeturinat e së shkuarës gjithë paketën Rilindase.

Askush nuk di të thotë se cili është kursi i operacioneve opozitare për fitore dhe ndërtimin e një strukture meritokrate, ku respektohet mendimi ndryshe dhe promovohet statuti e vendimmarrja kolegjiale.

Ky realitet i partive politike në Shqipëri dëshmon se kanë një rrugëtim të gjatë, po aq të gjatë sa dhe vetë përmirësimi i tregjeve të kapitalit njerëzor. Por nëse bursa e tulipanëve rezultoi e përkohshme, më shpejt u përqendrua puna tek risitë e tjera dhe fondamentalisht u nda një herë e përgjithmonë epoka e industrializimit të ekonomisë drejt inovacionit, nga pamjaftueshmëria që ofronin asetet në vlerë më të vogël, sikurse tulipanët holandezë rezultuan.

HOROSKOPI

DASHI

Do të keni tensione të vogla në familje. Do të ngushëlloheni duke blerë disa gjëra të vogla, jo ndonjë gjë kushedi se çfarë, por thjesht libra të vjetër dhe gjërat kulturore për t'i koleksionuar. Do të bëni shumë shpenzime ushqimore sot, por duke u treguar të kujdesshëm për atë që blini.

DEMI

Është dita ideale për ata që kanë dëshirë të bëjnë punime në shtëpi, sepse keni me të vërtetë shumë punë për të bërë. Mjetet dhe materialet do të jenë të kushtueshme, por do t'ia vlejnë. Edhe në zyrë atmosfera është e qetë, të gjithë mendojnë për punën e tyre, pa ndërhyrë në atë të të tjerëve.

BINJAKET

Planifikimi i mirë është shpirti i punës, sidomos kur ju duhet të merreni me çështje praktike dhe për t'i përmbledhur, të mërzitshme. Vishuni me ngjyra portokalli për të rënë në sy dhe bëni mirë të shmangni të kuqen, nëse jeni të lodhur, bëheni agresiv.

GAFORJA

Ditë për t'u mbajtur mend, ku të gjithë do të jenë kundër njëri-tjetrit ju, partneri, fëmijët, kunetërit dhe prindërit. Dhe kështu do të ketë një mori hatërmbetjesh dhe bashkëbisedime ironike. Edhe një marrëveshje ndër aksionarë mund të prishet. Ju shkaktoni polemika, ndërsa të tjerët reagojnë keq.

LUANI

Në punë jeni të përkushtuar, por vullneti i personit që keni në krah ndërhyn për të ndryshuar gjerat, duke bërë që t'ju ndryshojë programin. Do të keni edhe zënka në çift, me grindje të lodhshme për të përcaktuar se kush do të imponojë vullnetin e vet.

VIRGJERESHA

Mjafton të mësoni të vëzhgoni, do të zbuloni se jeta çdo ditë mund t'ju dhurojë ato gjërat e vogla të bukura që mund të bëjnë të lumtur cilindo prej nesh. Bëni kujdes nga lodhja nervore, jeni shumë të ndjeshëm dhe përfshiheni shpejt në gjendjen emocionale të të tjerëve.

PESHORJA

Nuk do të mungojnë diskutimet me të afërmit dhe për rrjedhojë, sqarimet. Duhet të tejkaloni një këndvështrim shumë personal të çështjeve familjare. Të marrësh në konsideratë të mirat e të këqijat e veprimeve tuaja është më mira, por kjo nuk duhet të kthehet në një pengesë.

AKREPI

I keni idetë e qarta, doni një raport sentimental të qëndrueshëm dhe do të angazhoheni për ta realizuar. Do të arrini rezultatin e dëshiruar. Do t'ia dilni më në fund të bëni gjënë e duhur dhe në drejtimin e duhur. Suksesi është i garantuar.

SHIGJETARI

Do të angazhoheni ashtu siç dini vetëm ju për të arritur rezultate të mira, duke shfrytëzuar ndjeshmërinë, delikatesën dhe aftësitë për të kuptuar të tjerët. Me Mërkurin kundra, në fushën e dashurisë ndoshta nuk do t'ia dilni të shprehni plotësisht atë që jeni duke ndjerë.

BRICJAPI

Këshillohet të përballoni çështje të pazgjidhura në fushën e dashurisë. Duhet t'i shqyrtoni gjërat nga çdo këndvështrim, pa u fshehur pas iluzioneve. Nëse një epror ju kërkon të punoni përtej kompetencave, qëndroni të qetë dhe refuzoni.

UJORI

Pas ditësh të mbushura me angazhime, po vijnë momente më të qeta. Do të ndiheni në formë, të qetë dhe në dispozicion të personit që ju qëndron në krah. Do të keni mundësinë të kaloni në veprim, duke realizuar edhe gjëra që i konsideronit shumë të vështira.

PESHQIT

Nëse nuk jeni të sigurt për ndjenjat tuaja, mos hyni në lojë. Rrezikoni të krijoni ndonjë situatë të pakëndshme, për të cilën mund të pendoheni. Përpara se t'i futeni kokë e këmbë një ndërmarrjeje, do të ishte mirë të vlerësonit të mirat dhe të këqijat.

GARA PER FSHF
INTERVISTA

Do dorëzojë mandatin e deputetit nëse fiton zgjedhjet në FSHF

Fino kandidon dhe kërcënon: Nuk do votojë asnjë i jashtëligjshëm

Thumba rivalit: Nuk jam nga Tirana e tifoz me Vllazninë

Iftuar në emisionin "Rubrika Sportive" në RTSh, Bashkim Fino ka folur në lidhje me garën për kreun e presidentit të Federatës Shqiptare të Futbollit. Asambleja e Përgjithshme e FSHF-së që do të mbajë punimet më 7 shkurt, do të zgjedhë kreun e ri të institucionit të futbollit dhe anëtarët e Komitetit Ekzekutiv.

Si ndiheni në një studio sportive

Ndihem shumë rehat, shumë komod. Këtu është televizioni i të gjithëve, dhe është shtëpia ime. Në shtëpi ndihesh gjithmonë mirë. Ndihem mirë në çdo studio pa problem, qofshin politike apo sportive.

A do të kandidoni për president të FSHF?

Ka kohë që shumë dashamirës më kanë kërkuar të jem pjesë e sportit, duke parë përfshirjen time në sport. Kam folur dhe kam diskutuar pasi futbollin e kam pasion, sepse e njoh. Mendoj se është momenti të bëj një ndryshim në futbollin shqiptar, të krijojmë një imazh të ri për futbollin shqiptar. Falënderoj të gjithë dashamirësit e mi. Jam në një garë me mikun tim Duka, secili do jetë me platformat e tij. Mendoj se me platformën që kam paraqitur, koha është shumë e shkurtër.

Do thosha se duhen ndryshuar disa rregulla. Për të bërë një fushatë për president të FSHF-së, do duhej një asamble ku të zyrtarizoheshin kandidatët në një datë. Më pas, të paraqitej një datë tjetër ku të gjithë kandidatët të paraqisnin tek të 54 anëtarët e FSHF për të bërë fushatë. Do ishte diçka e këndshme në të mirë të futbollit. Fakti që bëhet në një mënyrë të tillë, i bie që të jetë avantazhi i presidentit aktual. Në këtë moment, unë nuk kam shumë favor krahasuar me të. Ai ka 16 vjet që drejton, dhe ka infrastrukturën dhe stafin, se sa një kundërshtar tjetër, qofsha ky edhe unë.

Kush janë klubet që të kanë propozuar?

Kam pasur shumë kërkesa, nga shumë klube. E kam lexuar me vëmendje statutin. Mjafton edhe një klub të të propozojë, dhe automatikisht je kandidat. Ndërkohë që kam pasur kërkesa nga shumë klube, por nuk dua të bëj fushatë tani. Dy apo tre klube më kanë propozuar. Lushnja, Flamurtari kanë depozituar, por më vonë mund të jetë edhe një klub tjetër.

Meqë janë disa klube që ju kanë propozuar, a jeni në fushatë para se të zyrtarizoni kandidimin?

Dihej që në fund të shkurtit, apo në fillim të marsit do kishte zgjedhje në FSHF. Në datën 6 janar, Komiteti Ekzekutiv vendosi që në datën 7 shkurt të mbahen zgjedhjet. Unë pata kohë të organizohem dhe të bëj organizimin tim.

Jeni një nga zyrtarët më të lartë të PS, jeni deputet. A është kjo një futje e politikës në futboll?

E kam dëgjuar këtë gjë, dhe nuk do doja të ktheja përgjigje. Unë jam një politikan i vjetër, dhe karrierën time e kam nisur. Kam mbaruar për financë. Kam qenë kryetar bashkie, kam qenë kryeministër. Kam një përvojë të madhe. Jam anëtar i parlamentit shqiptar, jam anëtar i Komisionit të Ligjeve. Nga pikëpamja ligjore, nuk më pengon askush të kandidoj. FSHF është një OJQ, jo fitimprurëse, dhe nuk ka asnjë pengesë. Nga pikëpamja politike, unë nuk jam askushi. Unë jam dikushi, që dua t'i shërbej futbollit. Nëse do më votëbesojnë në 7 shkurt, unë do i përkushtohem vetëm futbollit.

KANDIDIMI
Kam ardhur që të kandidoj me vendim drastik për federatën. Jam pro kufizimit të mandateve. Nuk jam që presidenti të jetë gjithë jetën. Ose kur do të ikë, ose kur të vdesë. Jam për kufizimin me dy mandate.

Do e jepnit dorëheqjen nga politika, nëse do ju kërkonte ligji?

Nëse do ishte me ligj, do respektoja ligjin, do jepja dorëheqjen nga politika dhe do kandidoja. Do të kandidoja dhe kush të fitonte sipas platformës, do të vazhdonte.

Si mund të organizoni kohën për fushatë të mirë?

Jemi të detyruar që të respektojmë "fair playn" që na vuri KE, qeveria e futbollit. Do të shfrytëzoj pikërisht këtë kohë për të bërë të gjithë takimet e mundshme, për një futboll të pastër që e kemi në platformën tonë. Do të takojmë të gjithë, plus duke bërë dalje të ndryshme në publik. Shikoj një lloj lufte. Jam i qetë dhe ndjehem shumë mirë në këtë garë. Kur ka dalë Duka, më erdhi vërtetë keq për sarkazmën që përdori për PS dhe emrin tim dhe duhet ta kursente. Kam qenë mbështetës i Kombëtares.

Nuk do të sulmoni?

Absolutisht. Nuk është ky qëllimi. Qëllimi është platforma ime se si dua t'i mbush mendjen anëtarëve të Asamblesë.

Sa nga anëtarët në Asamble janë klube që administrohen nga bashkitë. Shumë prej tyre i ka PS. Nuk do të ketë ndikim politik?

Larmia e bashkimeve është e ndryshme, nuk i ka PS. Shumë herë kryetarët e bashkive nuk janë të interesuar. Kanë ardhur shpesh të deleguarit. Unë do të mendoja që ata të pëlqejnë platformën tonë dhe të vendosin se me kë do të bëhen. Kjo ka të bëjë me një nga pikat në platformë. Jam i interesuar që të ndaj përfundimisht sponsorizon nga privatizimi. Ai që është sponsor, është sponsor. Bashkitë duhet të privatizohen sa më shpejt, të kenë minimumin e nevojshëm të aksioneve. Para vitit të ri, klubi Vllaznia po ndiqte vazhdimisht këshillin bashkiak. Kur do ta miratojë e sa lekë do të marrë. Bashkitë të kalojnë në rol të dytë dhe të vejnë në privatizim. Do të jetë diçka shumë e mirë, dhe do të shmangen në votimin për president.

Nëse nuk ka të interesuar…

Ligji i sportit duhet të ndikoje në këtë. Një bashkëpunim me të gjitha qeveritë, për ta bërë sportin sa më atraktiv. Nuk mund të ecim dot pa e bërë këtë.

Nuk është votë popullore…

Sa mirë që do të ishte

Përmendët 54?

Unë aq njoh. 54.

A keni kohë fizike për ta bërë takimin e të gjithëve?

Do të mundohem që të përdorim të gjitha format. Portalet, takimet, debati televiziv. E thashë që është në disfavor të kandidaturës sime dhe në favor të presidentit që është sot. Do të zbatojmë statutin. Unë personalisht jam dakord për të bërë zgjedhje në mars. Për mua, kam shumë pika që do të ndërhyjmë në statut. Para çdo asambleje zgjedhore, të shpallen kandidaturat dhe të shpallet koha për fushatë korrekte. Duhet ndryshuar në statut. Jemi të detyruar që të përshtatem me këto kushte që janë.

DEKLARATA
Në platformën time do të jetë transparenca. Të gjithë operatorët janë të lutur që të jenë prezent. Të bëhet e hapur dhe kush është më i miri të fitojë. Nuk mbështes asnjë televizion, se kush do të marrë të drejtat televizive. Është ekonomi tregu. Gjithçka super e hapur.

Sa e vështirë nga 0-10?

Shumë. Nga një në dhjetë, është dhjetë. Për shkak të kohës së shkurtër që është në dispozicion.

Çfarë dëshironi të ndryshoni?

E para, më duhet ta them që duhet të përmirësojmë imazhin. Në interes të publikut dhe futbollit shqiptar që sot e ka humbur. Në stadiumet tona është për të ardhur keq që ka shumë pak tifozë. vjen se ka humbur besimi. Duhet t'i rikthejmë besimin kampionatit për një lojë të ndershme. Ka shumë instrumente. Së pari, Federata duhet të jetë në ballë të punës me komisionet e Etikës dhe të arbitrave që kanë në dorë për ta bërë futbollin të pastër.

Nuk ka asnjë dosje që ka vajtur të prokurori. Ka ardhur koha që ta kthejmë në futboll të pastër që njerëzit të vijnë në stadium. Kush vjen kur e dinë që ajo ndeshje është e mbyllur dhe që nuk është rezultat që duhet ta japë fusha. Federata e organizon dhe përgjegjësinë e ka totalisht ajo për ta organizuar dhe për ta bërë sa më të pastër. Ka të bëjë edhe me infrastrukturën. Janë bërë shumë fusha. Sot federata i jep disa fusha. I jep klubit një fushë me 100 mijë euro.

Shumë mirë bën. Por problemi, më i madh nuk është stadiumi, por fusha stërvitore. Të gjithë klubet stërviten në fusha, jo në stadiume. Në platformën time, për fondet që jep UEFA, çdo ekip do të ketë një fushë stërvitore. Kjo, sepse është pjesa që rrit cilësinë në futboll. Të bëjnë stërvitje në kushte optimale. Por jo në fusha me bar sintetik. Fusha të jetë nga më të mirat.

Futbolli nuk është vetëm në dhjetë qytete. Të masivizohet. Asnjë fond nuk do të jetë i fshehur, do të jenë transparente. Në infrastrukturë dhe zhvillim, të bëhet me ndarjen e sponsorizimit nga privatizimi. Kam ndjekur zv.presidentin e FSHF-së që foli për Ligën Profesioniste. Jam dakord. Nuk e kuptoj me vetëm 10 ekipe, por më të gjerë. Të krijojmë ligën amatore.

Dy gjëra kryesore. Kam ardhur që të kandidoj me vendim drastik për federatën. Jam pro kufizimit të mandateve. Nuk jam që presidenti të jetë gjithë jetën. Ose kur do të ikë, ose kur të vdesë. Jam për kufizimin me dy mandate. Do ta propozojnë që mandatet e tij të jenë dy, jo më shumë, nëse votëbesohem. E kanë kërkuar edhe klube të tjera dhe nuk është pranuar. Unë e kam propozim konkret. Pas dy mandateve të vijë dikush tjetër. Në dy mandate marr garancinë që do të bëj 5 stadiume si arena e Elbasanit, me çdo qeveri. Në tetë vjet, kam mundësinë që të bëj 5 të tilla. Në Vlorë, në Korçë. Duhen bërë të tilla për të rritur gamën e fushave, për të rritur cilësinë.

Transparenca, federata bën edhe aktivitete tregtare si shitja e të drejtës televizive. Si do të jenë tenderët e shitjes së të drejtës televizive?

Kam ndjekur me shumë interes debatet. Të jeni të bindur që në platformën time do të jetë transparenca. Të gjithë operatorët janë të lutur që të jenë prezent. Të bëhet e hapur dhe kush është më i miri të fitojë. Nuk mbështes asnjë televizion, se kush do të marrë të drejtat televizive. Është ekonomi tregu. Gjithçka super e hapur.

Do rritet shuma që fitojnë klubet?

Patjetër. I takon specialistëve. Federata, është jofitimprurëse. Të gjitha të ardhurat do të jenë të destinuara për ekipet e futbollit shqiptar.

E dini që vetëm klubet e Superiores fitojnë nga kjo e drejtë…

Besoj se kjo do të ndryshojë për të mirë të futbollit, jo për të mirë të disa ekipeve.

Çfarë premtoni?

Nuk do të shkojë Duka apo Bashkimi në Europian. Është merita e djemve që shkuan. E stafit të trajnerëve dhe pastaj e drejtuesve. Është meritë. Jam kënaqur dhe e kam ndjekur Europianin bashkë me zotin Duka, një ndeshje.

Si ju duken që kanë nisur të futen në fushatë të lojtarëve të Kombëtares?

Lexova dy thënie të Agollit dhe të Lilës, më vjen keq që përdoren. Dikush tjetër i ka përdorur. Është fatkeqësi, sepse janë djem të shkëlqyer. Futbollistë shumë të mirë që e kanë meritar të jenë atje me gjakun dhe djersën e tyre. Nesër nuk dua që të thonë rroftë Bashkimi. Thuajuani. Nuk dua të përdoren as ata dhe as trajnerët e Kombëtares.

Liga Profesioniste…

Nuk duhet ta bëjë federata. Duhet të ndihmojë, të asistojë dhe të japë asistencë juridike. Liga është në të mirë të tyre pra të klubeve, në të mirë të futbollit dhe nuk do të kenë shumicën e problemeve që kanë pasur me federatën. E rëndësishme është që federata të mos imponojë. Duhet të rrijë në fund të tavolinës dhe jo në krye. Duhet ta bëjnë një orë e më parë. Shpëtojnë nga presidenti i federatës. Produkti i tyre nuk do të drejtohet më nga presidenti, por nga i përzgjedhuri i tyre. Do ndikoj me forcën time që të mblidhen. Të bëhet një Ligë Profesioniste e ekipeve të Superiores me Kategorinë e Parë. Është minus për këta që janë që s'e kanë bërë.

Kategoria Superiore?

Nuk e di që ta diskutojë presidenti. Nuk jap dot përgjigje. Janë specialistët që gjykojnë. Janë vetë presidentët.

Tifoz me ndonjë ekip?

Patjetër që jam. Me kë tjetër përveçse me Luftëtarin. Jam gjirokastrit. E kam ndjekur.

Presidenti Tavo ka bërë punë shumë të mirë. Më thonë që Abazaj është vlerë nga Korça. Shyqyr që do të na e lërë edhe gjashtë muaj.

Miqësia me Gaz Demin apo me Partizanin?

Nuk bëj hipokritin që të them që jam nga Tirana, dhe jam tifoz me Shkodrën.

Edhe pak me Lushnjën?

Natyrisht.

Shoqatat, prej të cilave tetë shoqata rajonale nuk janë regjistruar në gjykatë.

Jam njohur nga media, nga ajo që është bërë publike.

Hapat që do ndërmerrni?

Është minus i madh për KE dhe presidentin aktual, ia prish klimën kësaj fushate. Duhet të reagonin sa më shpejt dhe të kërkonin falje. Ta trajtonin edhe si çështje teknike. Kjo de legjitimon vetëm presidentin aktual. Pavarësisht se fitoi bindshëm herën e shkuar që nuk kishte kandidat apo para dy radhësh me dy kandidatë. Njollë e madhe. Sot kemi këto shoqata që nuk janë anëtare dhe kanë votuar. Njësoj sikur ju të dilni të bëni tregti pa u regjistruar në tatime.

Quheni kontrabandiste dhe futeni brenda. Keni bërë tetë rajone kur janë 12 qarqe dhe mbi të gjitha keni vendosur njerëz me konflikt interesi se punojnë në federatë dhe punonjës të Kombëtares. Është turp i madh. Të kërkojnë falje publike! Nuk duhet të afrohen në derën e Asamblesë së 7 shkurtit, sepse përballen me ligjin. Nëse e bëjnë do të venë në prokurori. Nuk kishte nevojë presidenti për këto vota. Vetë çështja për të cilën e kanë ngritur këtë sistem, bën një njollë të madhe me turp FSHF. Duhet dhënë dorëheqja dhe duhet të kërkonin falje.

Kam një studio ligjore që ta ndjekë. Kemi marrë dokumentacion të rregullt. Të tetë shoqatat nuk janë të regjistruara. Kanë pasur provokime që të regjistrohen këto ditë. Tetë shoqatat janë shoqata kriminale, në kuptimin e gjuhës juridike.

Do kërkoni përfaqësues tuajin në komisionin e verifikimit të mandateve?

Nuk është çështje. Janë anëtarë me mandat dy vjeçar të përzgjedhur në 2016 me 60 vota. Kur bëhesh deputet, ka Komision të Verifikimit të Mandateve. Duhen përzgjedhur 5 anëtarë për të përbërë komisionin e mandateve. Si mund të vijë Ylli Shehu të verifikojë mandatin e Gaz Demit.

Çfarë do të bëni?

Nuk do t'iu them që të mos i pranojnë. Nuk kam se çfarë t'ju kërkoj këtyre të pestëve, sepse nuk do të më dëgjojnë mua. Nuk mund të dalin mbi presidentin dhe sekretarin e Përgjithshëm. Do të përballen me prokurorinë dhe ligjin. Nuk kam dëshirë që të bëhen të njollosura zgjedhjet e kaluara për president dhe për anëtarët e Komitetit Ekzekutiv. Marrëdhëniet financiare dhe bilaterale, si janë zgjidhur.

Çfarë do të ndodhë?

Ata nuk do të votojnë.

S'mund t'i pengoni…

Po ju tregoj ligjin. Statuti i pengon që të votojnë. Anëtarët, përfaqësuesit e klubeve do të regjistrohen dhe do të votojnë, pra, delegati i Lushnjës me letër nga bashkia. Secili prej tyre, do të ketë dokumentin e gjykatës. Unë do të kem përfaqësuesit e mi në komision. Përfaqësuesi im s'mund ta lejojë që të votojë.

Punonjësit e administratës së FSHF-së. Çfarë do të ndodhë?

Po më pyesni edhe për trajnerin e Kombëtares. Mbase edhe ata mund të kenë kontratë. Në pikat e mia e kam edhe formimin e administratës. Do të shohim si është raporti i numrit me punën. Mund ta bëjnë më pak njerëz atë punë. Më duken shumë në pamje të parë. Ka të bëjë me organigramën dhe funksionimin e punës. Nëse ka punonjës me integritet të lartë dhe me personalitet, të mos kenë frikë. Nuk dua që të jetë administrata ime nesër në marionetë apo bajonetë.

Trajneri i Kombëtares, një mendim?

Panuçin e njoh si futbollist të madh të Interit, Milanit, Realit, Romës dhe shumë ekipe. Më ka impresionuar. Si tifoz i Interit, ka qenë edhe me ekipin tonë. Më ka impresionuar si ka ardhur, si po sillet. Me lojën më sulmuese. Natyrisht që do të respektojmë kontratat, por do të shohim edhe objektivat që ka që mund t'i realizojë dhe mund të mos i realizojë. I kam shumë qejf trajnerët e huaj.

Kreu i FSHF-së pohon: U futa në garë pas konsultimit me komunitetin

Duka: Kandidimi i Finos, nismë pozitive

Presidenti aktual i Federatës kërkon mandatin e pestë

Presidenti i Federatës Shqiptare të Futbollit, Armand Duka zyrtarizoi sot kandidaturën e tij për një mandat tjetër në krye të Federatës së Futbollit. Pasi shpalli kandidaturën, kreu i FSHF-së dha një intervistë për "Top Channel", të parën si kandidat zyrtar i kësaj gare. Ndonëse pohoi se vendimi nuk ishte aspak i lehtë, në këtë intervistë, Armand Duka sqaron se çfarë do të bëjë nëse fiton dhe u përgjigjet akuzave që i bëjnë kritikët.

President, si e morët vendimin për të rikandiduar në zgjedhjet e ardhshme dhe pse?

Ka qenë rezultat i një konsultimi me të gjithë komunitetin e futbollit. Kam pritur në njëfarë mënyre opinionet e tyre rreth kësaj çështjeje dhe kësaj teme, nëse duhet të vazhdoja për të drejtuar Federatën e Futbollit. Ka pasur shumë pikëpyetje, qoftë edhe në kokën time, duke pasur parasysh edhe opinionet negative rreth saj. Duke marrë më shumë kërkesa pozitive nga vetë aktorët e organizatës vendosa që bashkë me ta të vazhdojmë për suksese të tjera, për ta zhvilluar edhe më shumë futbollin, për të korrigjuar ato gjëra që ndoshta bashkë kemi bërë keq apo kanë shkuar keq, si dhe për të vendosur një tullë pozitive për futbollin shqiptar.

Kur thoni pikëpyetje, cilat janë ato më të spikaturat?

Realisht pikëpyetjet janë ato që çdo njeri, apo shumë njerëz i kanë në kokat e tyre. Shumë vite, një njeri tjetër ndoshta me energji të reja, le t'i jepet mundësia dikujt tjetër… Dhe nuk është se nuk i kam menduar edhe unë këto. Por duke parë që nuk është se ka alternativa, të cilat do ta çonin edhe më shumë përpara futbollin, nuk është se ka projekte - sipas meje, edhe më të mira, duke menduar raportet që kam krijuar me komunitetin për ta zhvilluar këtë organizatë janë pozitive dhe eksperienca që kemi krijuar bashkë mund ta ndihmojë futbollin shqiptar, më çoi në këtë vendim pozitiv.

Mendoni, gjithashtu, se nuk jeni ezauruar në idetë tuaja dhe në dëshirën për të bërë më shumë, si në aspektin sportiv, apo edhe atë infrastrukturor, ku përshtypja është se është arritur kulmi në këto vitet e fundit?

Janë bërë shumë gjëra dhe realisht ndryshimet e para duken edhe më lehtë. Ndryshimet e viteve të para në futbollin shqiptar konstatoheshin shumë lehtë, sepse ishim në një situatë pothuajse dramatike apo inekzistente, pa infrastrukturë, pa një organizatë të konsoliduar, pa klube konkurruese, pa një Kombëtare kompetitive. Ndërsa ndryshimet e tanishme janë ndryshime që, pasi ke arritur një stad goxha pozitiv, në të cilin unë e konsideroj futbollin shqiptar sot, është e vështirë që t'i dallosh. Megjithatë, duke pasur parasysh të gjithë eksperiencën dhe tërë këto punë që kemi bërë në këto vite, mendoj që do t'i japim përsëri disa ndryshime të dukshme futbollit shqiptar.

Gjatë kësaj periudhe, është një kohë relativisht e gjatë që drejtoni, ka shumë nga ata që ju mbështesin dhe shumë nga ata që kanë kritika. Shpesh ju kanë kritikuar më shumë sa iu përket dyshimeve të klubeve për trukime ndeshjesh, ndoshta edhe në arenën ndërkombëtare, apo herë pas here favorizimet ndaj Skënderbeut, Kukësit, apo skuadrave të ndryshme sa i përket titullit kampion.

Kjo është një garë publike, një lojë e dashur për të gjithë botën, madje më shumë në Shqipëri. Është pothuajse e vetmja lojë e ndjekur në Shqipëri. Por, siç e thashë, është një garë, ka emocione, ka shumë përplasje dhe patjetër që shpesh herë prodhon edhe konflikte. Shpesh herë cenon edhe interesa. Duke qenë në rolin e organizatorit, Federata Shqiptare e Futbollit patjetër që sulmohet, kundërshtohet shumë herë kur nuk realizon pritshmëritë e dikujt për garën. Ndoshta edhe për arsye subjektive apo objektive, për gjëra reale apo jo. Debate me anëtarët e Federatës së Futbollit, me anëtarët e familjes së futbollit janë të vazhdueshme, për arsye të vet natyrës që ka kjo garë, apo kompeticioni dhe kjo lojë. Por, në përgjithësi këto konflikte dhe kontradikta nuk kanë shkuar në antagonizëm dhe gjithsesi, përsëri zgjedhja ka qenë e njëjtë. Patjetër që sjell anëtarë të pakënaqur, nga të cilët prodhohen edhe alternativa të reja, që mund të sjellin edhe zhvillim. Por në përgjithësi, raportet me të gjithë anëtarët e komunitetit të futbollit kanë qenë pozitive.

Gjatë të gjithë kësaj periudhe ndoshta kulmi i reagimit ndaj ndeshjeve të trukuara ka qenë dënimi i Skënderbeut edhe nga Federata Shqiptare e Futbollit. Mendoni se është bërë një përmirësim në këtë aspekt, sepse gjatë të gjithë kohës ka qenë një lloj gangrene?

Jo vetëm, dyshimi apo vërtetimi për manipulim të rezultateve të lojës nuk është një gjë që ka lindur në Shqipëri, apo që të ketë lindur sot. Është diçka që ka ekzistuar, një fenomen jashtëzakonisht shumë negativ, të cilin të gjithë aktorët e lojës duhet të bëjnë maksimumin për ta eliminuar. Duke qenë pjesë e këtij komuniteti të futbollit, kemi edhe këtë fenomen që është e të gjithë botës. Sot i mëshohet më shumë idesë se është produkt i një lloj trukimi për efekte financiare, dikur mund të ketë qenë për motive të tjera. Uroj që në të ardhmen të eliminohet, por dyshoj që do të eliminohet 100%. Ajo që mund të bëjmë ne është maksimumi i kontributit tonë për ta minimizuar, apo për të shkuar deri tek eliminimi, gjë që mendoj se ne e kemi bërë. Në Shqipëri ka filluar të lulëzojë shumë rreth 5 vite më parë, është luftuar goxha nëpërmjet ndryshimit të skemave të lojës për të futur sa më shumë elementë të garës dhe për të mos lënë mundësinë e tolerimit, apo siç i thonë shqip të lënies së ndeshjes, sepse trukimi është një fjalë shumë më e madhe. Kemi marrë të gjitha masat, qoftë edhe me penalizimin e aktorëve që bëjnë lënien e ndeshjeve, por nuk kemi arritur ta eliminojmë. Jemi ende pjesë e saj dhe vazhdojmë që ta luftojmë për të shkuar drejt eliminimit.

Në prag të zgjedhjeve, sheh atë që mund të bësh më mirë, ndoshta edhe duke kthyer kokën nga ato gjëra që nuk janë bërë mirë. Si është ky raport për ju dhe çfarë do të mund të bënit më mirë në 4-vjeçarin e ardhshëm?

Shumë gjëra janë bërë, jam i ndërgjegjshëm dhe i përgjegjshëm për atë çfarë kam bërë gjatë të gjithë kësaj periudhe në Federatën e Futbollit. Jam munduar të bëj më të mirën time, me maksimumin e energjive të mia, me përkushtimin maksimal. Duke qenë një aktivitet kaq i madh, duke qenë jo vetëm kompetitiv, por edhe organizativ, patjetër që ka edhe gabime, ka gjëra që duhen korrigjuar, apo që janë korrigjuar. Mendoj që kemi bërë shumë gjëra mirë dhe futbolli ka ndryshuar. Ka ndryshuar infrastruktura e futbollit shqiptar, e cila ka qenë në kushte të papranueshme për garat kombëtare dhe ato ndërkombëtare. Kampionati shqiptar luhej në fusha fare të papërshtatshme, madje ka qenë edhe një kampionat me sistem grumbullimi, një gjë që pothuajse nuk ekziston në asnjë vend të Europës. Ka qenë i paorganizuar mirë, shpërblimet për futbollistët kanë qenë shumë më të ulëta, për arbitrat, gjithashtu. Të ardhurat e klubeve kanë qenë shumë më të vogla. Sot kemi hedhur një hap të mirë, kemi një përfaqësim shumë më të mirë ndërkombëtar, me ekipin kombëtar që arriti kulmin me pjesëmarrjen në Europianin e vitit 2016. Dhe jo vetëm me këtë, por me një ekip që mund të garojë kundër çdo ekipi në Europë dhe që pretendon për të shkuar edhe më lart. Realizuam një ëndërr që mendoja se nuk do të arrihej kurrë. Tashmë nuk pretendojmë më përsëritjen e kësaj ëndrre, por të shkojmë edhe më larg, të marrim pjesë në një kompeticion botëror. Të gjitha këto kanë ndryshuar dhe duhen konsoliduar, duhen bërë edhe më profesionale, në mënyrë që kjo lojë të jetë edhe më e bukur në Shqipëri.

Në këtë garë, pas shumë vitesh, një kandidat tjetër vjen nga politika. Kishte kohë që nuk ndodhte. Çfarë mendimi keni për këtë gjë dhe a i druheni ndërhyrjes së politikës në këtë aspekt?

Unë jam i prirur të mendoj gjithmonë pozitivisht dhe në këtë rast dua të mendoj pozitivisht. Besoj se nisma është një nismë private, e një individi të cilin unë e njoh, ashtu sikurse e njohin të gjithë, sepse është një personazh i jetës publike shqiptare. Një ish-kryeministër, deputet i Partisë Socialiste, madje edhe Sekretar Organizativ i saj. Gjithsesi unë do të doja ta shikoja jo si një nismë të Sekretarit Organizativ të PS-së, por si nismë e Bashkim Finos dhe disa shokëve të tij që e mbështesin. Duhet ta shoh dhe dua ta shoh kështu këtë garë deri në fund. E konsideroj si një nismë pozitive, një dëshirë e tij për të kontribuar dhe për të dhënë eksperiencën e tij për menaxhimin e një institucioni, atij më të rëndësishëm të sportit në Shqipëri.

Për momentin mendoni se nuk ka ndërhyrje rrymash politike në këto dy personazhe?

Unë nuk mund të parashikoj, por thashë atë që unë dëshiroj të mendoj. Unë dëshiroj të mendoj që do të jetë një garë sportive, një garë alternativash, një garë për të dhënë më të mirën për komunitetin e futbollit. Se çfarë do të ndodhë në ditët në vazhdim, duhet të presim e të shohim.

QEPA, magjia e antibiotikut natyral

Qepa është një barishte e bimë dyvjeçare, Alliaceae familjes (Formerly Liliaceae), dhe ka qenë prej kohësh. Gjerësisht kultivohet si perime. Ka shije dhe erë të fortë.

Qepa është barishtore, bimë shumëvjeçare me kokërr të vetme, lulëzon vitin e dytë. Ka një lartësi të bimëve rreth 60-100 cm, gjethet jeshile të së cilës janë cilindrike, (e cila e dallon këtë lloj nga prasi ose hudhra, të lashtat e tjera i përkasin edhe Allium gjini). Ajo ka një fryrje në bazën e saj. Mufatja është relativisht e madhe, sferike, nganjëherë më shumë ose më pak. Lule të vogla (4-5 mm i gjerë), të bardha ose të gjelbra, janë të grupuara në një çadër sferike, në pozicionin e terminalit që rrjedhin.

Duket se bulbat e qepëve dhe bimët e tjera të familjes kanë qenë përdorur si ushqim në antikitet. 5000 vjet p.e.s janë gjetur fosilet e qepëve, por nuk është e qartë nëse ata ishin rritur në të vërtetë në atë kohë. Dëshmi letrare dhe arkeologjike shpjegojnë se kultivimi mund të ketë filluar rreth dy mijë vjet më vonë, në Egjipt, me hudhrën dhe preshin. Duket se qepët ishin pjesë e dietës së punëtorëve që ndërtuan piramidat. Qepa shumohet shpejtë. Egjiptianët e lashtë e bënë atë një objekt adhurimi, duke i kombinuar format saj sferike dhe unaza e saj koncentrike. Përdorimi i qepëve në varrime është demonstruar nga mbetjet që u gjetën në varrin e Ramsesit II. Egjiptianët besonin se me aromën e fortë të qepëve do të dorëzohet fryma e vdekur.

Në Greqinë e lashtë, atletët hanin sasi të mëdha të qepës. Gladiatorët romakë mbështillnin trupin e tyre me qepë për të zhvilluar muskujt. Në Mesjetë qepa ishte si ushqim i rëndësishëm, kështu që ata u përdorën për të paguar qiratë dhe si dhurata.

Mjekët përshkruajnë qepën si bimë për lehtësimin dhimbjeve të kokës, për të trajtuar kundër kafshimit dhe helmit të gjarpërinjve dhe rënien e flokëve.

Qepa u dërgua në Amerike nga Christopher Columbus në udhëtimin e tij më 1493 në Haiti. Në shekullin e gjashtëmbëdhjetë, qepët janë përdorur edhe në trajtim për infertilitetin, jo vetëm tek gratë, por edhe në kafshët shtëpiake.

Qepa ka nevojë për një tokë të pasur dhe me lagështi, por jo përmbytje dhe ujë. Llojet e ndryshme të qepëve kërkojnë kushte të ndryshme klimatike dhe disa orë të diellit çdo ditë.

Qepa përmban një enzimë, e quajtur Synthase Faktori Lacrimal, e cila do të transformohet në acid, 1-molekulë propanethial propénylsulphénique-S-oksid, molekula e paqëndrueshme, përgjegjëse për acarimin në sy.

Aroma e qepës është kryesisht për shkak të alliinase, të përfshira aty, ndërsa efekti djegës është për shkak të një enzime tjetër.

PËRBËRJA

Përbërja mesatare 100g (Aprifel) Energji 34 kcal Ujit 89% Karbohidratet 7,1% Fat 0.2% Proteina 1,3% Fibër 2,1% Kalcium 25 mg 10 mg magnez 170 mg kalium Iron 0.3mg Vitamina C 7 mg Vitamina B1 0,06 mg 0,3 mg Vitamina B3 0,14 mg Vitamine B6 0,02 mg Vitamine B9 0,14 mg Vitamina E

Qepa shkrin acidin e urinës (përgjegjës për sëmundjet që ndikojnë te veshkat, nyjet ...) dhe luftën kundër infeksioneve.

Qepa e kuqe ndihmon për të parandaluar osteoporozën për shkak të përmbajtjes së lartë të quercetit, përbërës i familjes antioxidant e polyphenols, aktiviteti i të cilëve është më i lartë se ajo e isoflavones.

VETI TË TJERA TË QEPËS:

Heqja e hidropizis, e cila është një akumulim i parregullt e lëngjeve në trup, zakonisht në bark.

Kufizimi i infiltrimit të ujit në organet, të cilat mund të shkaktojnë ënjtje, efikasitet në traktin urinar dhe prostatës: tranzit të mirë, kufizimin e infeksioneve.

Këshillë: Për të hequr erën e qepëve nga duart tuaja, ju mund t'i fshini ato me lëng limoni. Për rregullimin e aromës së gojës, kur keni ngrënë qepë, përtypet pak majdanoz ose nenexhik.

Fjalëkryqi (1)



HORIZONTAL
1. Dillon aktor.
5. Një listë që zgjidhet nga regjisori
9. Sigla e tritolit.
12. Kapiteni që ndiqte balenën Moby Dick.
14. Është spektator i yni.
16. Fillojnë lejen
17. Një sinjal akustik.
19. Një parashtesë për... përtej.
20. Është partia e Sali Berishës.
23. Kanë organizatën Hamas.
24. Gëlojnë nga murgjit.
25. Në teori kur mungon ti.
27. Inicialet e Gide.
28. Inicialet e Asimov.
29. Nisen pa ne.
31. Kreshniku i volejbollit.
36. Kufijtë e tokës.
37. Mund të jenë autonome të tilla.
38. Britma e Arkimedit.
41. Fillojnë vetëm.
42. Bota jashtë ëndrrës.
44. Mund të jenë ushtarake.
46. Italia në Internet.
47. Gjysmë atomik.
49. Janë prova inteligjence
50. Një libër hartash.
51. Clapton i muzikës.

VERTIKAL
1. I famshëm ai i Trojës.
2. Një... bombë tenistike.
3. Fillojnë themelet.
4. Mund të jetë klasifikimi.
6. Një letër... kampioni.
7. Është pozicioni për gjumë.
8. Janë diktatorët despotikë.
9. Një kryeqytet afrikan.
10. Që mesfushor i famshëm i Ajax.
11. Ekstreme në tenis.
13. Është e dendur në xhungël.
15. Është brinjë në skuadër.
18. Është pako që dërgohet.
20. Brown i Kodi i Da Vinci-t.
21. Bëjnë taktika me taka.
22. Vetot pa kufij.
23. Persekutonin romakët.
24. Është gri ajo e trurit.
26. Një mund të jetë spiunzhi.
30. Janë vendet për nisje.
32. Me to bëjnë torta.
33. Janë katër në kitarë bas.
34. Institucione Urbane Rajonale.
35. Priten me lotë në sy.
39. Një rreth pa ekstreme.
40. Gjysmë kasate.
41. Është cilësia.
43. Ente Tregtare Lokale.
45. Një pjesë e territorit.
48. Në hyrje të oazit.

Fjalëkryqi (2)

HORIZONTAL
1. Jagger i Rolling Stones.
4. Zanore për kuaj.
6. Janë dhelpra.
11. Inicialet e Lendl ish tenist.
12. Kufizojnë rastet.
14. Mbyllen me epilog.
16. Është simbol ngadalësie, por jo breshkë.
18. Gjysmë njeriu.
20. Janë fruta ekzotikë.
21. Një minierë e vjetër.
23. Ata tanë ishin ilirë.
24. Masat pa kufij.
25. Një gëzim i madh.
26. Agjenci Ndërmjetëse Përmet
27. Është godinë në miniaturë
29. Film i Ridley Scott
31. Duken të gjata në pritje.
32. Njëzetmijë... në det në një libër të Jules Verne.
34. Është kreu i bandës.
36. Ndahen nga ortakët.
38. Është numri një.
41. Janë trupa qiellorë të tillë.
44. Kanë dhoma për t'u zënë.
46. Tri çupa në poker.
47. As unë, as ai.
48. Janë vitet.
49. Pak amatoriale.

VERTIKAL
1. Një legjendë.
2. Përfundojnë një stil.
3. Nuk e ulin kokën.
5. Këndohen në opera.
6. Janë tek në Somali
7. Është lloj papagalli.
8. Mbyllin komentin.
9. Është e parë për prodhim.
10. Kush ka do të pijë.
13. Janë binarë.
15. Rolet pa ret.
16. Vihen për të mbyllur të tilla.
17. Janë tek në mantel.
19. Salgari që krijoi Sandokan.
20. Një stinë e ngrohtë.
22. Janë pamje nga puna.
26. Një fjalë goxha.
27. Ato Ëilliams janë teniste
28. Ishin të parët tanë.
29. Janë edhe ato polare.
30. Fillojnë nazet.
33. Inicialet e Triolet.
36. Një bëhet me pozë.
37. Mbyllin punimet.
39. Ndodh në kufij.
40. Perignon i champagne-s.
42. Është iks ajo e sulmit.
43. Enti europian i hapësirës.
45. Fillojnë lehtë.



Gjeni ndryshimin



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave

SUDOK

7	1			6		2		
5	9					4	8	
3		6	5	4				
2					9		5	
	6	9	8		1	3	7	
	7		6					4
				8	5	9		1
	4	8					2	3
		3		1			6	7

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar

5	8	1	6	9	3	4	7	2
4	7	2	8	5	1	6	3	9
9	6	3	4	2	7	5	8	1
2	4	7	5	1	8	9	6	3
1	5	8	9	3	6	2	4	7
3	9	6	2	7	4	1	5	8
7	2	4	1	8	5	3	9	6
6	3	9	7	4	2	8	1	5
8	1	5	3	6	9	7	2	4

Argëtim filozofik

DA VINÇI

- Të presësh është e dhimshme. Edhe të harrosh është e dhimbshme. Por të mos dish se çfarë vendimi do të marrësh, kjo është një nga vuajtjet më të mëdha." **Paulo Coelho**

- Kurrë s'e bëj gabimin e të debatuarit me njerëz, për opinionet e të cilëve nuk kam respekt. **(Edward Gibbon)**

KRIPTOSKEME



KRIPTOSKEME

Përgjigja e numrit të djeshëm

K	O	D	I			A	D			P	A	L		
A	R	E	S		T		I	S	M		L	A		
N	A	D		H	E	R	E	T	I	K	E	T		
I	R		M	O	N	I	T	O	R	I				
B		K	A	P	I	T	A	L	I	S	T	E		
A		L	A	P	S	A	T		A		A	T		
L	E	A		E	T			L	M		T	I		
I		S		R	E	I	N	E		T	I	M		
	P	I	S			S	O	D	A		M	O		
S	E	K	R	E	T		L			G	O	L		
A	L	E		L	O	N	D	R	A		R	O		
T	E	T		A	B	D	E	R	A		E	G		

Thënie të mençura

- Nevoja e bën punën e guximit. **Xhorxh Eliot)**
- Guximi është një cilësi kaq e nevojshme për të zotëruar virtytin, sa që është gjithnjë i respektuar, bile edhe kur është i shoqëruar me ndonjë të metë. **(Samuel Xhonson)**
- Sokrati: Lumturia është dhunti e natyrshme, mjerimin e shkaktojnë mungesat artificiale.
- Të pamposhturit janë ata që tregohen të fortë, kur sulmohen në pikat e dobëta.
- Asgjë nuk është më e shtrenjtë, se sa ajo që blihet me lutje.. !

FJALEKRYQI (1)

T	O	K	A	T		L	U		F	R	A	N	Z	
A	R	E	S		F	I		M					A	
I	I	N		V	E	N	T	I	L	A	T	O	R	
L		E	P	E	R	D	I	T	S	H	M	E		
J		T	E	R	R	O	R	I	S	T	E	T		
A	S	A		M	A	R	A				R		S	
	H		L	O	R	E	N		M	A	R	A	T	
H	A	M	E	S	I			P	A	R	E	T	I	
U	R	I	T	H		S	U	R	R	A	T		N	
T	I	R	O	I	D	E	T		I	T		V	O	
I	F		N		I	T	A	K	A		S	A	R	
M		M	E	N	T	E		S	H	T	A	T	E	

FJALEKRYQI (2)

M	A	H	L	E	R		K	R		N	O	T	A	
I	N	E	S		A	K	O		D		T	E	N	
S	T	R		S		E	N	D	E	R	E		T	
T	E	A		P	E	N	D	I	M	I		A	I	
E	N		M	E	N	D	I	M	I		S		G	
R	A		A	C		E	T	E		V	E	L	O	
I	T	R		I		Z	A	N	A		K	I	N	
O		A	K	A			T	S		A	R	N	A	
Z	A	B	E	L		M		I		M	E	D		
E			M	E	G	A	T	O	N		T	O	R	
T	O	K	A		A	L		N		D	E	R	A	
	P	A	L	A	D	I	N	E		S	T	O	P	

PËRGJIGJET E FJALËKRYQEVE TË NUMRIT TË KALUAR

Argëtim filozofik

EKSKLUZIVE

"FAIR PLAY" nga Enkeleida Zeko
Z.Armand Duka live në "News 24"

FAIR PLAY

Të dielën në 14 janar, ora 22:00

news 24